



Mbrojtja

Viti i 89-të i botimit
Tetor 2021/ Nr. 10



Vizita në Gardën Kombëtare të New Jersey
Ministri i Mbrojtjes Peleshi:
SHBA, ky aleat strategjik i
pazëvendësueshëm i kombit shqiptar



Bashkëpunimi dypalësh SHBA-Shqipëri
Shqipëria, leva e mbajtjes
së orientimit të rajonit
drejt Perëndimit



Projektet e reja të AFA
Ministri Peleshi: Si do ta
modernizojmë FA-në sipas
modelit "West Point"



**Kryeministri Rama në Akademinë Ushtarake "West Point":
Bashkëpunim për binjakëzimin me FA-të shqiptare**

Përmbajtja

Numri 10

STËRVITJA "MNELA 21"

12 Ministri Peleshi: Ushtria jonë e denjë ta përfaqësojë vendin në misione ndërkombëtare

GJENERALMAJOR BAJRAM BEGAJ

14 FA të RSH kanë qenë dhe janë të angazhuara për të forcuar më tej bashkëpunimin rajonal në fushën e Mbrojtjes

TAKIMI I KOMITETIT USHTARAK TË NATO-s

17 Gjeneralmajor Begaj rikonfirmon vijimin e kontributeve të Shqipërisë në misionet, operacionet dhe aktivitetet e Aleancës

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I NATO-s

42 NATO e angazhuar për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare

ISH-USHTARAKU ZEQIR CAMA

47 Ushtarak, poet dhe personalitet i Labërisë

STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shef i Sektorit të Botimeve
& Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza GOLIKJA
Hajrie DEDAJ

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ

Redaktore/ korrektore:
Suela HODA



4 VIZITA

Rama në Akademinë Ushtarake "West Point": Bashkëpunim për binjakëzimin me FA-të shqiptare
Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama, në kuadër të sesionit të 76-të të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, i shoqëruar nga ambasadorja Yuri Kim dhe...

6 GARDËN KOMBËTARE TË NEW JERSEY

Ministri i Mbrojtjes Peleshi: SHBA, ky aleat strategjik i pazëvendësueshëm i kombit shqiptar
Me rastin e 20-vjetorit të marrëdhënieve të bashkëpunimit dypalësh me Gardën Kombëtare të New Jersey-it, SHBA, dhe Forcave të Armatosura...

11 BASHKËPUNIMI ME "WEST POINT"

Ministri Peleshi: Si do ta modernizojmë FA-në sipas modelit "West Point"
Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi, rrëfen planet për modernizimin e Forcave të Armatosura gjatë një interviste në për News24. Zbulon detaje për ndërtimin e kampusit të ri...

22 ARTI I DIPLOMACISË USHTARAKE

Toci: Diplomacia ushtarake, një nga prioritetet e FA-ve, në ushtritë e vendeve perëndimore
Shpesh roli i diplomacisë përkufizohet si element përbërës i mediave, departamentit të shtetit dhe shërbyeve të jashtme, por jo...

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

Mbrojtja



REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 89-të i botimit
Nr. 10/ 2021

© Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë
revistë nuk mund të riprodhohen
elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfitimi, pa
marrë autorizim nga botuesit e saj.

Botues:

Qendra e Kulturës, Medias,
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe
Botimeve të Mbrojtjes

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

Revista mund të gjendet në formatin elek-
tronik (pdf) në adresën:

[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/
publikime/revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)





ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E KOMBEVE TË BASHKUARA


Rama në Akademinë Ushtarake “West Point”: Bashkëpunim për binjakëzimin me FA-të shqiptare

Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama, në kuadër të sesionit të 76-të të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, i shoqëruar nga ambasadorja Yuri Kim dhe Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, kanë zhvilluar një vizitë në Akademinë

Ushtarake “West Point” në SHBA, ku kryeministri Rama u shpreh se kjo vizitë është në kuadër të bashkëpunimit të nisur për binjakëzimin me Akademinë e Forcave të Armatosura Shqiptare.

“Jemi shumë pranë një bashkëpunimi historik për brezat e rinj”, -theksoi ministri Peleshi në fjalën e

tij. West Point është një institucion i klasit botëror. Ky kampus është i hapur për studentët ndërkombëtarë. “West Point” është i njohur si një prej kolegjeve më të mira universitare të Shteteve të Bashkuara. Aty trajnohen dhe edukohen kadetët për të kryer në nivelet më të larta.



Kryeministri Rama takon dy djemtë shqiptarë në akademinë amerikane



Kryeministri në New York, shoqërohet nga ambasadorja Yuri Kim dhe Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi

“Do sjellin dijen e tyre në shërbim të atdheut”

Kryeministri Edi Rama vizitoi Akademinë Ushtarake “West Point” në Nju-Jork

“Kjo vizitë është në kuadër të bashkëpunimit të nisur për binjakëzimin me Akademinë e Forcave të Armatosura Shqiptare”, -theksoi Rama.

“Kënaqësi të ndjehesha më i shkurtri mes dy djemve shembullorë shqiptarë të Akademisë “West Point”, të cilët do të sjellin në shërbim të atdheut, dijen dhe kulturën ushtarake të fituar në këtë qendër të ekselencës amerikane”, -shkruan Rama.



Vizita në Gardën Kombëtare të New Jersey

Ministri i Mbrojtjes Peleshi: SHBA, ky aleat strategjik i pazëvendësueshëm i kombit shqiptar

Me rastin e 20-vjetorit të marrëdhënieve të bashkëpunimit dypalësh me Gardën Kombëtare të New Jersey-it, SHBA, dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i shoqëruar nga përfaqësues të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm, morën pjesë në ceremoninë e mbajtur për këtë qëllim, në Sea Girt, New Jersey.

Në fjalën e tij, zoti Peleshi vuri në dukje se marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë po aq që vjetra sa dhe vetë shteti ynë. Ai përmendi kontributin e pashlyer të presidentit amerikan, Woodrow Wilson, në Konferencën e Paqes në Paris në 1919, në lidhje me të drejtën e popujve për vetëvendosje kombëtare, duke shënuar kështu paprekshmërinë e Shqipërisë. "Si një mbështetës i pazëvendësueshëm i kombit tonë, Shtetet e Bashkuara iu gjendën pranë popullit të Kosovës, duke i dhënë fund brutalitetit, spastrimit etnik dhe duke hapur rrugën për t'u bërë një vend i pavarur", -u shpreh ministri Peleshi.

Duke përmendur 20-vjetorin e sulmit terrorist në Qendrën Botërore të Tregtisë, në New York, ministri i Mbrojtjes përsëriti edhe njëherë se vendi ynë gjendet gjithmonë i gatshëm të kontribuojë kundër çdo kërcënimi ndaj vlerave thelbësore të qytetërimit. "Ne jemi krenarë që kemi qenë në krah të SHBA-së në këto përpjekje, duke bashkëpunuar në misionet në Irak

dhe Afganistan kundër kërcënimeve të cilat ende rrezikojnë jetën e qytetarëve tanë. Duke pritur mbi 600 shtetas afganë, vendi ynë po

tregon një angazhim të vazhdueshëm në këtë drejtim", -tha ministri.

Ministri Peleshi, falënderoi në mënyrë të veçantë komandantin e



Gardës Kombëtare të New Jersey-it, gjeneral brigade Lisa J. Hou si dhe Departamentin Amerikan të Mbrojtjes, për ndihmën e jashtëzakonshme në modernizimin e Forcave të Armatosura Shqiptare.

Forcat e Armatosura dhe Ministria e Mbrojtjes po i kushtojnë një rëndësi të veçantë arsimimit dhe përmirësimit të institucioneve tona arsimore. Ndaj dhe ministri i Mbrojtjes shfrytëzoi rastin dhe kërkoi nga gjeneral Hou angazhimin personal, në mënyrë që të eksploroheh fushat e mbështetjes së mundshme në këtë drejtim. Zyrtarisht Shqipëria ka nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit Dypalësh me Departamentin Amerikan të Mbrojtjes dhe shtetin e New Jersey-it në vitin 2001, duke shënuar fillimin e Programit të Partneritetit Shtetëror New Jersey-Shqipëri.



Ministri Peleshi takon zëvendësshefin e Byrosë së Gardave Kombëtare të SHBA

Shqipëria, leva e mbajtjes së orientimit të rajonit drejt Perëndimit

Gjatë vizitës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi u takua me zëvendësshefin e Byrosë së Gardave Kombëtare të SHBA, gjeneralin me 3 yje Marc H. Sasseville. Z. Peleshi i shprehu gjeneralit Marc H. Sasseville gatishmërinë për të intensifikuar edhe më tej bashkëpunimin. Pas këtij takimi, ministri i Mbrojtjes u shpreh:

“Një takim entuziast me zëvendësshefin e Byrosë së Gardave Kombëtare të SHBA, gjeneralin me 3 yje Marc H.



Sasseville. Bashkëpunimi i deritanishëm në fushën e modernizimit, edukimit e trajnimit të ushtarakëve, pjesëmarrjes në misione të përbashkëta etj, do të intensifikohet edhe më tej. Projekti ambicioz i rimodelimit të Akademisë së Forcave të Armatosura, tashmë një objekt i rëndësishëm në axhendën e bashkëpunimit dypalësh SHBA-Shqipëri”.

Ministri Peleshi theksoi se mbështetur në partneritetin special strategjik me SHBA, Shqipëria do të mbetet leva e mbajtjes së orientimit të rajonit tonë nga Perëndimi.

Bashkëpunimi me akademinë ushtarake “West Point”

Ministri Peleshi: Si do ta modernizojmë FA-në sipas modelit “West Point”

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi, rrëfen planet për modernizimin e Forcave të Armatosura gjatë një interviste në për News24. Zbulon detaje për ndërtimin e kampusit të ri për kadetët shqiptarë sipas modelit të akademisë ushtarake amerikane “West Point”, ambicia e ministrit është që të kthehet në një pikë referimi për gjithë Ballkanin Perëndimor. Ministri i Mbrojtjes tregon se Studentët të cilët studiojnë jashtë dhe japin tashmë kontributin e tyre akademik në sistemin arsimor ushtarak por dhe personeli i Akademisë së Forcave të Armatosura, sipas Peleshit do të vlerësohen me shumë pikë në momentin e gradimit. Në vëmendje janë edhe shpërblimet financiare të oficerëve dhe nënoficerëve të Forcave të Armatosura.

Zoti Peleshi, u është besuar nga kryeministri sërish detyra e ministrit të Mbrojtjes? Si ndiheni pasi jeni sërish në krye të një prej institucioneve më të rëndësishme të sigurisë dhe mbrojtjes në vend.

Peleshi: Është e vërtetë, duhet ta pranoj që Ministria e Mbrojtjes krahas dy tre ministrive të tjera bën pjesë në paketën e ministrive klasike dhe shumë të rëndësishme për shtetin. Kjo më bën të ndihem jo thjesht i kënaqur dhe krenar, por mbi të gjitha të ndiej përgjegjësinë e kësaj detyre. Kjo karrige ka një përgjegjësi të dyfishtë, duke patur parasysh që Shqipëria është një

“Të ndërtosh një institucion arsimor duhen dekada mbase dhe shekuj. Akademia e West Point-it ka një histori mbi 200 vjeçare, fillon në vitin 1807 nuk është një model që implementohet për disa vite dhe më pas nuk implementohet më”.

vend i NATO-s, pra strukturat e sigurisë dhe mbrojtjes, Forcat tona të Armatosura, janë të parat që e kanë arritur tashmë integrimin në strukturat euroatlantike, në rastin tonë në NATO.

Ktheheni pas vizitës suaj në New York ku ishte i pranishëm dhe kryeministri Rama, çfarë përfiton Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) nga modeli West Point ?

Peleshi: Duhet ta them se jam shumë i kënaqur, që një nga projektet tona kryesore të këtij mandati sa i përket Ministrisë së Mbrojtjes që është Akademia e Forcave të

Armatosura kemi arritur ta sjellim në vëmendje të posaçme, të nivelit më të lartë të qeverisë që është kryeministri shqiptar. Kështu që jam i lumtur që realizuam një vizitë në West Point, e kemi në mendje dhe në referencë sa herë që mendojmë për projektin e ri të Akademisë së Forcave të Armatosura. Nga pala amerikane, vëmendja politike është sjellë në nivelin më të lartë të mundshëm. Dua të zbuloj, nuk është një sekret i madh, që në Samitin e NATO-s, kryeministri Rama ka patur një takim me sekretarin e Shtetit zotin Blinken dhe, Akademia e Forcave të



Armatosura, nevoja dhe vullneti ynë për të ndërtuar një partneritet me akademinë ushtarake West Point, është shprehur dhe është kërkuar dhe atje nga kryeministri i vendit.

Gjithashtu gjatë stërvitjes më të rëndësishme të 30 viteve të fundit, gjatë kësaj stërvitjeje ne patëm vizita tepër të rëndësishme historike, nga personalitetet më të larta ushtarake të NATO-s dhe kryesisht të ushtrisë amerikane në Evropë. Vetë komandanti Suprem i Aleancës, gjenerali me katër yje Tod Walters ishte këtu, si dhe zoti Xherard ishte në një takim të dytë me kryeministrin. Të gjitha këto takime i kemi shfrytëzuar për ta ngritur çështjen e Akademisë së Forcave të Armatosura dhe dëshirës sonë për të patur një model kampion të edukimit ushtarak të sigurisë dhe mbrojtjes në vendin tonë në nivelet më të larta. Dukej, gjatë vizitës sonë atje, se puna ishte bërë siç duhej, sepse ne gjetëm një derë të hapur në West Point, gjetëm një vullnet për bashkëpunim. Ka qenë një vizitë relativisht e gjatë që kryeministri dhe delegacioni shqiptar ka zhvilluar, por mbi të gjitha na kanë dhënë me vete bindjen se projekti për këtë bashkëpunim është i dyanshëm.

A keni ju një plan konkret për të ndjekur modelin West Point, që për hir të së vërtetës nuk është hera e parë që aplikohet në sistemin tonë arsimor ushtarak. Hera e parë që u aplikua ky model ishte vitin 2004. Çfarë ndryshon me këtë marrëveshje të re? Ka ndryshim me atë të 17 viteve më parë?

Peleshi: Të ndërtosh një institucion arsimor duhen dekada mbase dhe shekuj. Akademia e West Point-it ka një histori mbi 200 vjeçare, fillon në vitin 1807 nuk është një model që implementohet për disa vite dhe më pas nuk implementohet më. Është e vërtetë, në dijeninë time, që rreth vitit 2004 ka pasur disa shkëmbime dhe një tentativë për ta modeluar akademinë sipas atij modeli. Do të kemi mundësinë ta shpjegoj këtë model. Ne shqiptarët për fat të keq vuajmë nga konsistenca edhe nga persistenca, do të thotë duam t'i arrijmë gjerat shpejt. Asgjë nuk arrihet shpejt, aq më tepër investimet në

arsim, mund të prishen shpejt edhe për një vit dhe pasojat i paguan një gjeneratë apo dy gjenerata. E para që duam të bëjmë është t'i japim seriozitet dhe gjithë durimin këtij projekti. Nuk mendojmë që mund të bëhet sa hap e mbyll sytë! E rëndësishme është të kemi dhe e kemi një vizion të qartë, ta fillojmë duke e ditur se ku do të shkojmë për një vit, për 5 vjet, por dhe për 10 vjet. Pra të punojmë me një plan të gjatë sepse ambicia jonë është të kemi në Shqipëri një West Point që i shërben Ballkanit Perëndimor, pra një West Point rajonal. Kjo është shumë e bukur të thuhet dhe shumë e vështirë të realizohet, ndaj kërkon një plan afatgjatë, kërkon një plan që nuk realizohet dot as nga një ministër, as nga një qeveri, por duhet të grumbullojmë konsensus rreth këtij projekti dhe, ta marrtë drejt, për çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, të paktën për këto çështje politike duhet ta gjejë fjalën, t'i qëndrojmë ne dhe ata që do të vinë pas nesh këtij projekti për të patur një fillim dhe vazhdimësi të sigurt.

Përse përzgjidhet të aplikoni modelin e West Point, që për vetë amerikanët kjo akademi është një institucion i shenjtë, ku përzgjidhen më të mirët ndër më të mirët dhe nuk përzgjidhet atë anglez, apo gjerman, ose turk? Modele që ju i keni adoptuar më parë në sistemin arsimor ushtarak?

Peleshi: Aurora ka shumë modele, të cilat mund të ishin ndjekur, ka akademi shumë të mira edhe për SHBA; West Point nuk është akademia e vetme edhe shtetet e tjera kanë eksperiencë shumë të mirë, ne mund të zgjidhim secilën prej tyre, por duhet thënë që në fillim se SHBA për ne janë partneri strategjik special, kemi një marrëdhënie të veçantë me ta, në kuadër të NATO-s dhe në rrafshin bilateral. Kemi një partneritet që ka dhënë frutet e veta dhe jetësohet në shumë disiplina, por sidomos edhe në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes. Eksperiencat tona të bashkëpunimit janë të gjata. Shkaku kryesor se përse ne shkuam pikërisht në këtë periudhë në SHBA ishte krentimi i 20 - Vje-

torit të partneritetit me shtetin e New Jersey-it. Në kuadër të këtij partneriteti ne kemi një bashkëpunim me gardën kombëtare të New Jerseyt, kemi pasur shkëmbime dhe projekte të përbashkëta, pjesëmarrje të përbashkëta në misione. Gjatë vizitës sonë ne krenuam dhe 20 vjetorin e bashkëpunimit të shkëlqyer me ta. Pra kemi një marrëdhënie shumë të mirë, e dyta është pasi modeli i West Point-it, ne thelbin e vet ka formimin e karakterit. Ata edukojnë studentët e tyre si në shkencat ushtarake ashtu dhe në 13 profile të tjera kryesisht në shkencat inxhinierike. Ajo që është më e rëndësishmja dhe ajo që dëgjon më tepër në prezantimet për West Point-in është karakteri. Pse ne kemi nevojë t'i orientojmë institucionet tona të edukimit duke vendosur në fokus karakterin dhe aq më tepër në Forcat e Armatosura? Ne po dalim nga një 30 vjeçar tranzicioni të turbullt. Ndryshim nga një sistem në një sistem tjetër. Ndryshime dramatike politike, ndryshime radikale ekonomike, ka sjellë dhe deformimet morale të shoqërisë dhe në çorientimet e brezit të ri mbi të gjitha. Brezi që ka jetuar në këtë 30 vjeçar e ka pasur të vështirë të gjejë modelin e ri që duhet të ndiqet. Kë duhet të admirojnë: atë që ka bërë lek, apo atë që respekton ligjin, atë që punon për shtetin? Kjo duket si letërsi, por unë e quaj të domosdoshme. Bashkimin European ta gdhendim tek të rinjtë.

Më ka tërhequr shumë fokusi i West Point në formimin e karakterit. Nëse do të ishit me ne do të shikonit që në hyrje të West Point është një faqe muri ku shkruhet mos vidh, mos mashtro, mos gënje dhe mos i tolero të tjerët të bëjnë kështu. Një ndryshim tjetër mes modelit West Point dhe Akademisë sonë të Forcave të Armatosura është se deri tani ne kemi patur vetëm një degë, bachelor në shkencat ushtarake pra ne prodhojmë oficerë. Kemi traditë të mirë, është dege e denjë, por nga ana tjetër na mungon formimi në aftësimin në shkencat e tjera. Kjo do të thotë se shumë pozicione pune ne nuk i plotësojmë, na duhen inxhinierë



IT, inxhinierë mekanike, ndërtimi. Ata nuk i gjejmë dot në treg privat, jo më në Forcat e Armatosura. Do investojmë në shkencë ekzakte. Misioni i West Pointit formëson liderë jo vetëm për ushtrinë por edhe për shoqërinë; këto janë ato që na kanë tërhequr dhe intriguar. Besoj se i kemi të gjitha kushtet të rrezatimit të ndërtojmë një kontingjent të rinjsh me karakter.

Ju thatë se i keni kushtet, por çfarë mund të na thoni për kapacitetet logjistike që ju zotëroni. A janë ato të përshtatshme për t'u përshtatur me modelin West Point?

Peleshi: Kjo frymëmarrja ime e thellë ka lidhje me një fakt që këtu ku jemi ne sot, ku është Ministria e Mbrojtjes dhe institucione të tjera, ishte shkolla Skënderbej, shkolla e mesme dhe akademja. Akademia është tkurrur për 10 vite ishte inekzistente, pra u mbyll, jemi në vitin e dytë të saj. Gjatë viteve të errët, këtu është bërë qendra e shumë institucioneve të tjera, kapacitetet hoteliere, logjistika e nevojshme janë të kufizuara. Forcat e Armatosura kanë sot në mbarë territorin hapësira për të ndërtuar projektin e kampusit të akademisë. Për hir të së vërtetës ne kemi ndërtuar një projekt goxha ambicioz, i cili kënaq kërkesat për tani dhe për 10 vitet e ardhshme për kapacitete hoteliere,

pasi studentët tanë qëndrojnë këtu në kazerme, por edhe për kapacitetet e klasave dhe të mësimi. Shpresojmë se shumë shpejt do të jemi gati për të filluar nga ndërtimi derisa të përfundojë 1,5 ose 2 vite ne do të kemi mundësinë të kemi një kampus edhe nga pikëpamja e hapësirës dhe logjistikës.

Është një kritikë e vazhdueshme që e dëgjoj rëndom dhe që i adresohet liderit të Forcave të Armatosura dhe besoj shumëkush nga radhët e Forcave të Armatosura, ose tashmë që janë jashtë, do të donte që t'u pyesja: nuk kanë qenë të paktën ata oficerë të cilët kanë studiuar në akademitë më të mira ushtarake, por pas disa vitesh shërbim kanë zgjedhur që mos të jenë më pjesë e ushtrisë pasi dhe vlerësimi si financiar për gradat e ulëta, apo meritokracia nuk kanë qenë gjithmonë në krahun e tyre. Çfarë duhet të ndryshojë?

Peleshi: Të gjitha këto që thatë ju janë të vërteta, të gjitha duhet të ndryshojnë. Së pari masa e shpërblimit, duke filluar nga ushtari i thjeshtë deri tek gradat më të larta. Duhet ta pranojmë ka ardhur koha të shtrydhim të gjitha mundësitë tona për të siguruar një pagë dhe një shpërblim më dinjitoz. Këtë e ka thënë edhe publikisht kryeministri në një ceremoni të vlerësimit, që

ne bëmë para pak javësh me rastin e përfundimit të betejës me zjarret gjatë gushtit, ku u shpërndanë disa mirënjohje. Kryeministri tha se do të eksplorojmë rritje të shpërblimit për gjithë Forcat e Armatosura. Ne jemi rrethuar me vende me standarde më të larta se ne. Sfidë jonë është si ta bëjmë atraktiv vendin.

Të kthehemi tek Forcat e Armatosura: disa gjëra ne nuk i rregullojmë dot shpejt. Ne nuk arrijmë sot standardin e SHBA-së, Greqisë, Gjermanisë. Unë mendoj që me mundësinë që ne kemi, të paktën disa pozicione mund t'i bëjmë mjaftueshëmish atraktive, aq sa për një student që përfundon jashtë shkollën, të preferojë të vijë këtu, sesa të qëndrojnë atje. Në Forcat e Armatosura ky devijim nga marrëdhëniet kontraktuale është më i vogël se në fushat e tjera. Ne bëmë një llogaritje dhe në 10 vitet e fundit është rreth 7%. Është përqindja e studentëve apo kursantëve që janë trajnuar apo kanë studiuar jashtë dhe që nuk janë kthyer në vendin e tyre apo në Forcat e Armatosura. Një përqindje që mirë do ishte të ishte zero. Nga njëra ana ne do të forcojmë sanksionet për ata që thyejnë kontratat, por nga ana tjetër unë nuk besoj se është çështje sanksionesh më shumë sesa është çështje atraktiviteti. Mirë është që

në mos t'i mbajmë njerëzit me zor, pasi një forcë e armatosur që i mban me zor ushtarakët e vet, se kanë të lidhur një kontratë, nuk mund të jetë një forcë e motivuar. Ne duam që ata të jenë të motivuar të shërbejnë në ushtri, të jenë të motivuar që edhe brenda Forcave të Armatosura dikush që ka studiuar jashtë dhe që ka kapacitetin akademik të japë mësim, të kontribuojë për akademinë, pra të preferojë akademinë përpara forcave të tjera. Sot ka disa handikapë, që kanë lidhje me pikët, me kuotat, që duhen për t'u graduar. Në rast se je në akademi ti merr më pak pikë, në rast se ti punon në Forcën Tokësore si kolonel, ti ke më tepër pikë kur konkurren për gradën e radhës. Këto të gjitha do t'i rregullojmë. Ne do t'i barazojmë. Vullnetin tim e kam ndarë me shefin e Shtabit të Përgjithshëm; është që t'i vlerësojmë më tepër ata që marrin pjesë në akademi, meqenëse academia ka rëndësinë për të cilën folëm. Ato që po flisja nuk janë të kondicionuara nga ligji i karrierës, do të bëhen me rregulloret tona të brendshme.

Flasim për modernizimin e Forcave të Armatosura, kur do mbërrijnë helikopterët "Black Hawk", perse po vonon ardhja e tyre për të qenë pjesë e Forcës tonë Ajrore?

Peleshi: Dy helikopterë "Black Hawk" tashmë janë të kontraktuar, ne kemi hyrë në fazën e pagesave. Kërkojnë kohën e tyre; jo për shkakun tonë, jo për shkak të pagesave, apo burokracive tona, por natyrisht duhet një kohë të bëhen gati dhe të vijnë këtu. Do të vijnë nga fundi i vitit 2022, maksimumi vijnë në fillim të vitit 2023. Ky është plani dhe marrëveshja me palën amerikane. Ndërkohë nuk kam pse e fsheh, ne po shikojmë të gjitha mundësitë tona për që në kuadër të modernizimit të Forcave të Armatosura për ta shtuar flotën tonë. Duhet të pranoj diçka që në vite ne kemi dëshirën e mirë për të pasuruar dhe për të shtuar flotën tonë ajrore. Kemi helikopterë të markave të ndryshme por tani na kanë sjellë në vështirësi për shkak të kostove të mirëmbajtjes. Mirëmbajtja është një problem jo vetëm për ne, por edhe për vende

shumë të zhvilluara. Nuk është kollaj të gjesh formulën për ta zgjidhur siç duhet mirëmbajtjen. Kemi nevojë të shkojmë drejt unifikimit dhe të shkojmë drejt sa më pak markave qoftë në Forcën Ajrore, apo Detare. Vizioni ynë është që tek helikopterët "Black Hawk" në rast se presim dy brenda mundësive tona buxhetore ta shtojmë flotën me helikopterë "Black Hawk" dhe, për helikopterët e tjerë të gjejmë një formulë mirëmbajtje. Unë personalisht do të jem shumë i lumtur që të arrijmë të ndërtojmë brenda Forcave të Armatosura kapacitete "in house" brenda nesh, për të bërë një pjesë të mirë të punimeve për mirëmbajtjen këtu, ta delegojmë prokurimin dhe mirëmbajtjen tek agjencitë e specializuara të NATO-s. Kështu kemi vepruar me helikopterin "Cougar" i cili përfundoi orët e fluturimit dhe ka nevojë për servis. Nuk bëmë procedura prokurimi vetë, por ia deleguam Agjencisë të Prokurimit të NATO-s që quhet NSPA, helikopteri është akoma aty, nga pikëpamja e procedurave ishte shumë shpejt. NATO ka kontrata të gatshme ne nuk kemi nevojë të futemi për tendera dhe për procedura blerjeje për sa kohë që ne kemi një partner të besueshëm me kontrata të gatshme dhe që prokuron për një sasi të madhe merr çmime më të mira, ka transparence, kjo është rruga. Ne nuk kemi planin apo mundësinë për të blerë avionë luftarakë, por duhet thënë se vende si ne me mundësi jo shumë të mëdha financiare ju vjen tani në ndihmë teknologjia. Teknologjia zëvendëson shumë nevoja dhe procese që në të shkuarën kërkonin makineri dhe shumë buxhet. Këto i zëvendëson me alternativa më ekonomike.

Me dronë ushtarakë?

Peleshi: Po me dronë ushtarakë, ne së fundmi kemi marrë 6 dronë ushtarakë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, jemi në fazën e trajnimit për pak muaj dronët do të jenë në veprim. Ne jemi në paqe dhe urojmë që të kemi gjithmonë paqe në rajonin tonë dhe në botë. Por Forcat e Armatosura nuk kanë funksione vetëm në kohë luftë por kanë funksione edhe në mbrojtje të

civilëve, të qytetarëve në reagim ndaj emergjencave civile, ju na keni parë ushtria ka qenë në frontin e parë, ishim tek zjarret. Dronët na duhen për monitorim për vëzhgim, në vend të përdorim helikopterët tani kemi mundësi të përdorim dronët.

Ne do te kemi ta tani së shpejti bazën ajrore taktike të NATO-s, në Kuçovë ku gjatë gjithë vitit do të shikoni të parkuar, apo do shikoni të nisen dhe të ulen avionë luftarakë të NATO-s, për shkak se në këtë bazë po investohet nga NATO në shumën rreth 50 milionë euro, 10% të shumës po e investojmë ne pra nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes. Fillojnë punimet pas pak muajsh NATO ka bërë gjithë prokurimet, pra pas pak muajsh fillon punë për ndërtimin e Bazës Ajrore Taktike të NATO-s në Kuçovë, ku vazhdimisht do të ketë prezencë të avionëve luftarakë të NATO-s.

Mund të na zbuloni detaje në lidhje me kapacitetet e bazës ajrore taktike të NATO-s në Kuçovë?

Peleshi: Aty do te ketë kapacitete për parkimin e 16 avionëve luftarakë të NATO-s. Forca njerëzore do te jetë shqiptare do të kemi ekspertizën e NATO-s menaxhimi do të jetë nga ana jonë

Në fund te kësaj interviste çfarë do donit të ndryshonte në Forcat e Armatosura dhe të mbante vulën tuaj?

Peleshi: Në rast se projekti i AFA do të merrte jetë gjatë kohës që unë jam ministër, kjo do të jetë një kënaqësi shumë e madhe për mua dhe një kujtim që do ta merrja me vete pasi është një investim afatgjatë. Çdo investim në edukim për 30 vite jep rezultatet e veta; është një farë që e mbjell sot dhe për dekada pastaj jep rezultate. Në fushën e modernizimit ka ardhur koha të ndërtojmë industrinë ushtarake, të marrim përsipër nuk ka pse të ketë limite, ne sot jemi vend i hapur, kemi qindra kapacitete njerëzore të shkolluar jashtë, nga e kaluara kemi teknikë, që kanë punuar në këtë industri, në rast se organizohen mund të na hapin mundësi të reja.

Intervistoi Aurora Golemi:



Forca Tokësore zhvillon stërvitjen “Mnëla 21”

Ministri Peleshi: Ushtria jonë e denjë ta përfaqësojë vendin në misione ndërkombëtare

S tërvitjes së përvitshme të Batalionit I të Këmbësorisë (b1k) në Vaun e Dejës, sivjet iu bashkuan edhe dy batalione të tjera të Forcës Tokësore, ai i Mbështetjes me Luftim dhe Batalioni III i Këmbësorisë (b3k). Për më shumë se një javë, batalionet përveç aftësive për t'u zhvendosur larg venddislokimit

të përhershëm, testuan në terren edhe veprimet kompaktësuese në nivel skuadre, toge, kompanie dhe batalioni. Në përfundimin e stërvitjes “Mnëla 21” mori pjesë edhe ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i cili shoqërohej nga kryetari i bashkisë së Vaut të Dejës Mark Babani, zëvendës shefja e Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor Manushaqe Shehu dhe

komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji. Ministri Peleshi dhe ushtarakët e lartë panë nga afër jo vetëm veprimet luftarake të ushtarëve në fushë-betejë, por edhe koordinimin e operacioneve nga shtabi i batalionit.

Ministri Peleshi vlerësoi rëndësinë e “Mnëla 21” si pjesë e kalendarit të stërvitjeve ushtarake të NATO



në misione në kuadrin e NATO, BE, Kombeve të Bashkuara dhe organizimave të tjera ndërkombëtare.” - u shpreh ministri Peleshi. Më tej, zoti Peleshi falënderoi efektivet edhe për angazhimin e tyre gjatë situatës së zjarreve dhe i njoftoi ata për vendimin e qeverisë për t'i shpërblyer financiarisht. “Një pjesë dërmuese nga ju morën pjesë dhe në përballimin e emergjencave civile, siç ndodhi dhe me emergjencën e zjarreve të gushtit. Për shkak të kushteve natyrore ne kemi emergjencë në verë dhe në dimër. Pa Forcat e Armatosura do të jetë e pamundur të përballojmë situatën të tilla. Ndaj dhe shumë i merituar është vlerësimi që kryeministri i Shqipërisë i ka bërë Forcës



Stërvitja “Mnela 21” shërbeu për të testuar dhe përmirësuar më tej aftësitë e batalionit të I të këmbësorisë si një repart i aftë për të realizuar operacione luftarake mbrojtëse.

“Kjo është një stërvitje që figuron në kalendarin e NATO dhe që meriton që të ketë një standard të denjë për këtë Aleancë”

dhe vuri në dukje modernizimin vit pas viti të reparteve me armatime dhe pajisje, duke i bërë më të përgatitura forcat tona për të marrë pjesë në misione ndërkombëtare. “Kjo është një stërvitje e NATO, një stërvitje që figuron në kalendarin e NATO dhe që meriton që të ketë një standard të denjë për këtë Aleancë. Nga stërvitja në stërvitje ne kemi rritje edhe të pajimeve edhe të logjistikës e të kushteve, por mbi të gjitha edhe të përgatitjes suaj, të ushtara-

këve tanë, nga ushtari i thjeshtë deri tek shtabi. Kjo nuk është stërvitja e parë dhe as e fundit, por kjo stërvitje ka sjellë risi dhe një nivel më të lartë edhe për shkak se stërvitja “Defender 21” dhe të gjitha pjesëmarrjet tona në misionet ndërkombëtare na kanë rritur besimin se ushtria jonë e një vendi të vogël mund të jetë e denjë ta përfaqësojë vendin në misione ndërkombëtare, natyrisht të kryejë misione operacionale, luftarake, brenda dhe jashtë vendit

Tokësore. Padyshim, nuk është më pak i rëndësishëm shpërblimi material që të gjithë pjesëmarrësit në këto emergjencë, mbi 2000 efektive do të marrin, siç është vendosur në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të para pak javëve.” - nënvizoi ministri Peleshi.

Stërvitja “Mnela 21” shërbeu për të testuar dhe përmirësuar më tej aftësitë e batalionit të I të këmbësorisë si një repart i aftë për të realizuar operacione luftarake mbrojtëse.



Shshp të FA në Konferencën e Shefave të Shtabit të vendeve të Kartës së Adriatikut (A-5, US - Adriatic Charter)

Gjeneralmajor Bajram Begaj: FA të RSH kanë qenë dhe janë të angazhuara për të forcuar më tej bashkëpunimin rajonal në fushën e Mbrojtjes

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj mori pjesë në Konferencën e 24-të të Kartës së Adriatikut A-5. Kroacia ishte vendi mikpritës dhe së bashku me Komandën Amerikane në Evropë drejtuan këtë konferencë. Përveç vendeve anëtare të A-5 (Shqipëria, Bosnje - Hercegovina, Kroacia, Maqedonia dhe Mali i Zi), morën pjesë edhe Sllovenia dhe Kosova me statusin e vëzhguesit, si dhe gardat kombëtare partnere me vendet anëtare të vëzhguese të A5.

Shtetet e Bashkuara përfaqësoheshin në konferencë me gjenerallejtënant Micheal L. Howard, zëvendëskomandant i Komandës Amerikane në Evropë (USEUCOM). Ndërsa nga Garda Kombëtare e New Jersey-it, që është partnere me Shqipërinë, u përfaqësua nga komandanti gjeneral brigade Lisa J. Hou.

Në fjalën e tij, gjeneralmajor Begaj, përshëndeti të pranishmit duke vlerësuar maksimalisht bashkëpunimin e shkëlqyer rajonal në fushën e Mbrojtjes. Ai theksoi se, Forcat e Armatosura të RSH kanë qenë dhe janë të angazhuara për të forcuar më tej këtë bashkëpunim, si dhe për të luajtur një rol konstruktiv në rajon,



Shtetet e Bashkuara përfaqësoheshin në konferencë me gjenerallejtënant Micheal L. Howard, zëvendëskomandant i Komandës Amerikane në Evropë (USEUCOM). Ndërsa nga Garda Kombëtare e New Jersey-it, që është partnere me Shqipërinë, u përfaqësua nga komandanti gjeneral brigade Lisa J. Hou.

pasi adresimi i sfidave të sigurisë, prosperitetit ekonomik dhe stabilitetit politik, është i mundur vetëm duke punuar dhe bashkëpunuar së bashku.

Ndërveprueshmëria ishte edhe fokusi kryesor i konferencës, ndaj u vlerësua bashkëpunimi rajonal nëpërmjet stërvitjeve të përbashkëta dhe pjesëmarrjes në misione. Lidhur me përbashkimin e pandemisë COVID-19, gjeneralmajor Begaj u shpreh se, kjo "luftë" kërkon zgjidhje gjithëpërfshirëse, ndërveprim dhe bashkëpunim midis agjencive ndërqeveritare dhe vendeve. Njëkohësisht, gjeneralmajor Begaj ri përsëriti për të pranishmit një nga angazhimet më të mëdha në kuadër të A-5, e cila është ambicia për të kontribuar së bashku në misionin e NATO-s në Irak. Gjeneralmajor Begaj, theksoi rëndësinë e "dyer të hapura" sidomos në anëtarësimin e

Kosovës në këtë iniciativë.

Gjatë kësaj konference, gjeneralmajor Begaj pati takime dypalëshe me gjenerallejtënant Howard, zëvendëskomandant i USEUCOM, takim me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Kroacisë, admiral Robert Hranj, si dhe komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama. Në këto takime u bisedua rreth çështjeve me interes të përbashkët në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes si dhe për forcimin e bashkëpunimit dypalësh ndërmjet vendeve respektive.

Gjatë qëndrimit në Kroaci, gjeneralmajor Begaj mori pjesë edhe në panairin dhe Konferencën Ushtarake ASDA, organizuar nga Ministria e Mbrojtjes e Kroacisë.

Konferenca u mbyll me nënshkrimin e Deklaratës së Përbashkët nga shefat e Shtabeve të A-5.

Gjeneralmajor prof. asoc. Begaj: Programi i Partneritetit s'është vetëm një angazhim ushtarak

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj priti në një takim të veçantë Komandantin e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, gjeneral brigade Lisa J. Hou.

Takimi ndërmjet gjeneralmajor Begaj dhe gjeneral brigade Lisa J. Hou u fokusua në marrëdhëniet dypalëshe si dhe në bashkëpunimin në fushën ushtarake.

Gjeneralmajor Begaj, pasi i ka uruar mirëseardhjen gjeneralë brigade Lisa J. Hou, u shpreh ndër të tjera se: "Programi i Partneritetit nuk është vetëm një angazhim ushtarak në mbështetje vetëm të qëlli-

“Përbërësi ushtarak i këtij programi është absolutisht një “histori suksesi” dhe ky bashkëpunim do të thellohet edhe më tej

meve të sigurisë dhe mbrojtjes, por ky program përfshin gjithashtu edhe fusha të tjera të shoqërisë si ato ekonomike dhe sociale. Përbërësi ushtarak i këtij programi është absolutisht një “histori suksesi” dhe ky bashkëpunim do të thellohet edhe më tej.

Të dy bashkëbiseduesit eviden-

tuan ecurinë e projekteve të përbashkëta të bashkëpunimit ushtarak në fushën e stërvitjes, arsimit, zhvillimit të trupës së Nënoficerëve, modernizimit në fushën e zbulimit, projekti helikopterëve Black Hawk, mbrojtjes kibernetike si dhe mbështetjes logjistike.

Nga ana e saj, gjeneral brigade Lisa J. Hou pasi vlerësoi maksimalisht bashkëpunimin ushtarak dypalësh, E siguroi shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH prof. asoc. Bajram Begaj se do të vazhdojnë mbështetjen e FARSH, duke rritur nivelin e asistencës në fusha të tilla si, stërvitjet e përbashkëta, trajnimit të personelit pilot, asistencë për njësitë kibernetike si edhe të mirëmbajtjes së teknikës luftarake.

Kjo vizitë zyrtare e Komandantit të Gardës Kombëtare të New Jersey-it përkon edhe me 20 vjetorin e Programit të Partneritetit të bashkëpunimit në fushën ushtarake, ndërmjet dy vendeve tona. Programi i Partneritetit ndërmjet Gardës Kombëtare të New Jersey-it dhe vendit tonë, u konkretizua fillimisht në vitin 2001. Ajo është një marrëdhënie afatgjatë, me fokus kryesor fushën e bashkëpunimit civilo-ushtarak kryesisht me mbështetjen e FARSH, më qëllim transformimin e saj si një forcë më e stërvitur, më e trajnuar dhe më e ndërveprueshme me forcat Aleate.



Konferenca e Ministrove të Mbrojtjes të vendeve të Ballkanit

Ministri Peleshi: Hartimi i një Programi për Sigurinë Rajonale, do të forconte ndjeshëm bashkëpunimin dhe efikasitetin gjatë krizave në rajon

Konferenca formati “Graz” ka për qëllim zbatimin e Strategjisë së BE-së për Ballkanin Perëndimor në drejtim të qëndrueshmërisë, stabilizimit të rajonit dhe pro-anëtarësimit në Politikën e Përbashkëta të Sigurisë dhe Mbrojtjes (CSDP)

Me iniciativë të Ministrisë së Mbrojtjes së Austrisë u zhvillua në Krens të Austrisë Konferenca e Ministrove të Mbrojtjes të vendeve të Ballkanit Perëndimor, format “Graz”. Me ftesë të palës austriake, në takim morën pjesë ministrat e Mbrojtjes dhe përfaqësues të nivelit të lartë të Austrisë, Shqipërisë, Bosnje-Hercegovinës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë. Delegacioni shqiptar kryesohej nga ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi. Konferenca ka për qëllim zbatimin e Strategjisë së BE-së për Ballkanin Perëndimor në drejtim të qëndrueshmërisë, stabilizimit të rajonit dhe pre-anëtarësimit në Politikën e Përbashkëta të Sigurisë dhe Mbrojtjes (CSDP). Pjesëmarrësit u njohën mbi inovacionet më të fundit të CSDP nga përfaqësues të nivelit të lartë të Komisionit Evropian.

Gjatë takimit u shkëmbyen mendime mbi politikën e Mbrojtjes, për të promovuar bashkëpunimin rajonal në formën e programeve dhe aktiviteteve, me qëllim rritjen e ndërveprimit rajonal për Operacionet e Mbështetjes së Paqes (PSO) të drejtuara nga BE, operacionet ndërkufitare të menaxhimit të fatkeqësive natyrore dhe transmetimin e vlerave ushtarake/kulturore të Evropës Perëndimore, për të promovuar rritjen e stabilitetit dhe besimit reciprok në rajon. Ministri i Mbrojtjes, zoti Niko Peleshi, ndër të tjera vuri në dukje rëndësinë që ka për çdo iniciativë rajonale “Politika e Dyerve të Hapura” për të

gjitha vendet e rajonit. Përfshirja e Kosovës dhe të gjitha shteteve të Ballkanit Perëndimor mbetet parimi themelor ku mbështet zhvillimi rajonal në të gjitha fushat. Në fjalën e tij të rastit, ministri Peleshi falënderoi vendet pjesëmarrëse që pruan këmbënguljen e Shqipërisë për aplikimin e Politikës së Dyerve të Hapura, çka i jep mundësi çdo shteti të bëhet pjesë e kësaj konference. Emergjencat gjatë viteve të fundit kanë shfaqur solidaritetin e vendeve mes njëri-tjetrit, por ende ka vend për përmirësim. Hartimi i një Programi për Sigurinë Rajonale, do të forconte ndjeshëm bashkëpunimin dhe efikasitetin gjatë krizave në rajon, theksoi ministri Peleshi.

Në përfundim të takimit u nënshkrua Deklarata e Përbashkët me të cilën synohet rritja e bashkëpunimit rajonal në fushat e “Dialogut Strategjik” dhe “Ndërtimit të Kapaciteteve”. Gjithashtu u dakord se të gjitha vendet pjesëmarrëse mbeten të angazhuara për një “Politikë të Dyerve të Hapura”, duke mirëpritur çdo vend i cili ndan të njëjtat parime dhe kontribuon në sigurinë rajonale. Gjatë kësaj konference, ministri Peleshi zhvilloi takime të shkurtra informale me homologët e tij nga Austria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Bosnje-Hercegovina dhe Serbia. Gjatë këtyre ndërveprimeve informale, z. Peleshi nënvizoi qëndrimin konstruktiv të Shqipërisë në rajon për sa i përket proceseve integruese dhe gatishmërinë për të vijuar bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes, si dhe shqyrtuar mundësi të reja në të ardhmen.



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj i shoqëruar nga përfaqësuesi ushtarak i Republikës së Shqipërisë në NATO gjeneralmajor Nazmi Cahani, mori pjesë në Konferencën e radhës të Komitetit Ushtarak të NATO-s, të zhvilluar në Athinë, Greqi. Konferenca u drejtua nga kryetari i MCC admiral Rob Bauer, mbështetur nga komandanti Suprem i Forcave Aleate në Evropë (SACEUR), gjeneral Tod D. Wolters dhe komandanti Suprem i Aleancës për Transformimin (SACT), gjeneral André Lanata. Gjatë takimit u diskutua mbi misionet, operacionet dhe aktivitetet e Aleancës, konceptet strategjike të Mbrojtjes së hapësirës euroatlantike, si dhe sfidat në përballjen me rreziqet dhe kërcënimet e ardhshme.

Një fokus i veçantë iu kushtua çështjeve lidhur me statusin aktual dhe planet e ardhshme që do të zhvillohen në kuadër të përshtatjes strategjike të Aleancës, si dhe implementimit të konceptit të shkurajimit dhe mbrojtjes së zonës euroatlantike. Shefat e shtabeve adresuan më tej sfidat më të mundshme që do të përballet Aleanca gjatë dekadave në vazhdim, duke përcaktuar udhëzime për përballimin e këtyre sfidave me fokus iniciativën NATO-2030. Duke ripërsëritur kohezionin në qëndrimin e tyre të gjithë shefat e shtabeve që morën fjalën konfirmuan mbështetjen për misionet dhe operacionet dhe qasjen e pandryshueshme në lidhje me vendimmarrjen e ardhshme të përbashkët. Gjeneralmajor Begaj rikonfirmoi vijimin e kontributeve të Shqipërisë në misionet, operacionet dhe aktivitetet e Aleancës. Në veçanti vlerësoi misionin e NATO-s në Kosovë si suksesin më të madh të NATO-s, që prej krijimit të saj. Njëkohësisht, gjeneralmajor Begaj zhvilloi edhe një takim pune me shefin e Shtabit kanadez gjeneralin W.D. Eyre, ku nga ana e tij u vlerësua kontributi i vazhdueshëm i Shqipërisë si pjesë e grup-batalionit kanadez të Prezencës së Përparuar (eFP), në Letoni.

Në fund të sesioneve të konferencës, shefat e shtabeve të Aleancës vijuan me procedurën e votimit të Drejtorit të Përgjithshëm

Gjeneralmajor Begaj rikonfirmon vijimin e kontributeve të Shqipërisë në misionet, operacionet dhe aktivitetet e Aleancës



të Shtabit Ushtarak Ndërkombëtar (DGIMS), bazuar në kandidaturat e propozuara nga vendet anëtare. Gjenerallejtënant Janusz Adamczak, nga Polonia, u zgjodh për të shërbyer si DGIMS, për një mandat tre vjeçar. Komiteti Ushtarak i NATO-s mblid-

het tre herë në vit, në nivel shefash shtabi, për të diskutuar mbi misionet dhe operacionet e NATO-s, si dhe për t'i ofruar Këshillit të Atlantikut të Veriut, këshilla ushtarake mbi një sërë sfidash që kërcënojnë sigurinë globale.

Nis Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes 2021-2022

Shembulli më i mirë për ta reformuar dhe ndërkombëtarizuar AFA sipas modelit West Point

Në Akademinë e FA-së nisi programi më i lartë i piramidës së arsimit ushtarak, Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Pjesëmarrës në të do të jenë ushtarakë të lartë përfaqësues nga vende si: Shqipëria, Gjermania, Italia, Bullgaria, Gjeorgjia, Greqia dhe Republika e Kosovës .

Ky kurs i cili prej vitesh ka ofruar cilësi të lartë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, vazhdon të jetë shembull në ambicien e tij për të reformuar dhe ndërkombëtarizuar AFA-në sipas modelit West Point, për ta shndërruar në qendrën e edukimit ushtarak në rajon.



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj, në një takim kortezie ambasadorin e Japonisë, të akredituar në vendin tonë, sh. t. z. Mitsuyuki Takada. Gjatë takimit të dy bashkëbiseduesit diskutuan për qasjen e përbashkët që kanë të dy vendet ndaj sfidave të sigurisë duke qenë partnerë në kuadër të aleancave me vlera demokratike perëndimore, si dhe ndanë të njëjtat mendime lidhur me kërcënimet dhe rreziqet e reja me të cilat përballen vendet dhe rolin që duhet të kenë Forcat e Armatosura për përballimin e tyre. SHSHPFA, gjeneralmajor Begaj e falenderoi ambasadorin Takada për përpjekjet e tij në forcimin e lidhjeve midis dy vendeve, si dhe vlerësoi kontributin e Japonisë me projekte rindërtimi në operacionet e drejtuara nga aleanca e NATO, veçanërisht në Afganistan. Ambasadori i Japonisë vlerësoi rolin e Shqipërisë në sigurinë e rajonit dhe më gjërë, duke nënvizuar mundësitë

Përfundoi stërvitja “Suber Junction” në Hohenfels, Gjerman



e bashkëpunimit në të ardhmen. Në përfundim të takimit gjeneralmajor Begaj pasi i uroi ambasadorit Takada suksese në detyrën e tij, e siguroi atë mbi gatishmërinë e FARSH për të eksploruar mundësitë e bashkëpunimit dy-palësh në fushën e

mbrojtjes, kryesisht në përballimin e emergjencave civile. Z. Takada mori detyrën e ambasadorit të Japonisë në Shqipëri në muajin nëntor 2020 dhe është ambasadori i dytë pas hapjes së Ambasadës së Japonisë në janar 2017.

OPERACIONI

Efektivët e EOD kanë realizuar me sukses një tester operacion për pastrimin e Gjirit të Vlorës, nga municionet e mbetura ndër vite.

Ky operacion u krye në bashkëpunim me Qendrën e Zhytjes së Forces Detare në mbështetje të anijes së Marinës Kombëtare Franceze CMT Lyre dhe kryerjen e veprimeve të përbashkëta për kërkimin, gjetjen dhe heqjen e municioneve në det pranë gjirit të qytetit të Vlorës. Kontrolli është ushtruar më së shumti pranë zonës së Ujit të Ftohtë në Vlorë ku janë gjetur dhe zbuluar 73 municione të llojeve predhë mortajë 80 mm, predhë artilerie të kalibrave 50mm, 60 mm 70 mm, 75 mm dhe 100 mm në sasi të ndryshme në total 73 copë. Ekipi EOD pasi mori në dorëzimin municioneve e gjetura ka bërë transportimin e sigurt të tyre në drejtim të depos së municioneve të Batalionit të Xhenios ku do të administrohen deri në asgjësimin përfundimtar.

EOD kontribuon në pastrimin dhe sigurinë e bregdetit të Vlorës nga municionet e mbetura ndër vite



Akademia e Forcave të Armatosura

Ministri Peleshi dhe kryebashkiaku Veliaj iu japin kartat e studentit të rinjve të AFA

“Kemi patur rreth 1000 aplikime për rreth 60 vende të bachelori këtë vit. Kemi një risi në akademi, përveç diplomës në shkenca ushtarake: duke nisur nga ky vit do të kemi edhe dy diploma të reja; Teknologji Informacioni në fushën e Mbrojtjes dhe Navigacion dhe Komandim Detar në fushën e Mbrojtjes”.

Të rinjtë e Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA) do të përfitojnë nga lehtësitë që ofron karta e studentit. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi së bashku me kryetarin e Bashkisë së Tiranës Erion Veliaj shpërndanë këto karta për studentët që nisin vitin akademik në këtë akademi, ku, për herë të parë, siç theksoi edhe ministri i Mbrojtjes shtohen edhe dy degë të reja bachelor. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi ndërsa shprehu mirënjohjen për vëmendjen e Bashkisë së Tiranës ndaj të rinjve që kanë zgjedhur të bëhen pjesë e Akademisë së Forcave të Armatosura vuri në dukje se në vitin e dytë të kësaj akademie interesi i të rinjve ka qenë i jashtëzakonshëm.

“Kemi patur rreth 1000 aplikime për rreth 60 vende të bachelori këtë vit. Kemi një risi në akademi, përveç diplomës në shkenca ushtarake: duke nisur nga ky vit do të kemi edhe dy diploma të reja; Teknologji Informacioni në fushën e Mbrojtjes dhe Navigacion dhe Komandim Detar

në fushën e Mbrojtjes. Pra, jemi duke u zgjeruar, jemi duke u transformuar, sipas një modeli kampion që është West Point”, u shpreh ministri Peleshi.

Përmes kartës së studentit, Bashkia e Tiranës ofron sot 1450 shërbime të ndryshme që u krijojnë lehtësi dhe oportunitete falas, ose me çmim të reduktuar mijëra të rinjve në kryeqytet, ndaj ministri Peleshi theksoi se: “Forcat e Armatosura kërkojnë prestigj. Ndaj vizita juaj këtu dhe përfshirja e këtyre të rinjve këtu në komunitetin e madh të të rinjve të Tiranës që gëlon është një lloj prestigji që u japim këtyre të rinjve, një lloj krenarie, por edhe një lloj shërbimi që u bëjmë këtyre të rinjve, sepse ata janë model. Bëjnë një punë të përkushtuar, jo të lehtë, me shumë sakrificë. Vetëm në fundjavë kanë kohë të lirë dhe natyrisht që u vlejnjë shumë shërbimet e Kartës së Studentit, sepse transporti publik dhe frekuentimi i institucioneve kulturore, qoftë edhe atyre private u shërben. Këta janë studentët e vetëm në Shqipëri për të cilët shteti paguan, akomodimi është falas, ushqimi është falas, dhe veç tyre kanë edhe një pagesë për shërbimet ditore, por gjithsesi karta është investimi edhe simbolik, edhe real”.

Kreu i Bashkisë tha se deri më tani kartën e kanë aksesuar 70% e studentëve, ndërsa ftoi që edhe studentët që ende nuk e kanë marrë ta sigurojnë atë në mënyrë që të përfitojnë nga shërbimet publike dhe private që mbulon, duke shtuar se ndihet i lumtur që Akademia e Forcave të Armatosura po transformohet sipas standardeve të West Point Army: “Si dikush që është rritur nga dy prindër ushtarakë e di që është një ndër vendet elitë dhe ishte muzikë për veshët e mi, kur dëgjoj nga Niko që edhe ai edhe kryeministri do vazhdojnë të thellojnë raportin me West Point”, - deklaroi Veliaj.



Ekipi i Gardës Kombëtare të New Jersey-it në Komandën e Forcës Ajrore, Rinas dhe Bazën Ajrore të Kuçovës

Kolonel Cenolli falënderoi Komandën e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, për mbështetjen e Forcës Ajrore Shqiptare me ekspertizë, mbështetje logjistike dhe trajnimin e pilotëve, të cilët do drejtojnë helikopterët “Black Hawk”, si projekt i modernizimit për të ardhmen i Forcave të Armatosura Shqiptare.

Më 17 shtator 2021, në vendin tonë mbërriti delegacioni i Gardës Kombëtare të New Jersey-it, i kryesuar nga kolonel Eric Guttormsen, i cili zhvilloi një vizitë në Komandën e Forcës Ajrore në Rinas. Delegacioni amerikan u prit nga shefi i Shtabit të Forcës Ajrore, kolonel Arben Cenolli, i cili informoi palën amerikane mbi Forcat Ajrore shqiptare dhe zhvillimet e saj për të ardhmen.

Kolonel Cenolli falënderoi Komandën e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, për mbështetjen e Forcës Ajrore Shqiptare me ekspertizë, mbështetje logjistike dhe trajnimin e pilotëve, të cilët do drejtojnë helikopterët “Black Hawk”, si projekt i modernizimit për të ardhmen i Forcave të Armatosura Shqiptare.

Koloneli Guttormsen falënderoi kolonel Cenollin për pritjen dhe shprehu jo vetëm gatishmërinë por edhe vullnetin e mirë të

dy palëve për vijimin e këtij bashkëpunimi.

Ekipi amerikan organizoi për ushtarakët e Forcës Ajrore shqiptare një vizitë në bordin e avionit KC-135, më të cilin ekipi amerikan ka ardhur në vendin tonë.

Sot, ekipi i Gardës Kombëtare të New Jersey-it, zhvilloi vizitë në Bazën Ajrore Kuçovë, ku u prit nga zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Ylli Pulaj, i cili vlerësoi vizitën dhe bashkëpunimin.

Komandanti i Bazës Ajrore Kuçovë njohu ekipin amerikan me historikun dhe zhvillimet e Bazës. Më pas, ekipi amerikan u njoh me disa nga objektet e rëndësishme të Bazës Ajrore në Kuçovë. Kolonel Guttormsen falënderoi zëvendëskomandantin e Forcës Ajrore për mikpritjen dhe njohjen nga afër të Bazës së Kuçovës, e cila së afërmi do të jetë një bazë e rëndësishme mbështetëse e NATO-s.

Në mbyllje të vizitës, Komanda e Forcës Ajrore organizoi për ekipin amerikan një vizitë në muzetë e kalanë e qytetit të Beratit.



Zv./ministrja e Mbrojtjes Dallëndyshe Bici nderon kujtimin e të rënëve në luftë

Më 16 shtator 1942, në fshatin Pezë të Tiranës, u mbajt Konferenca e Pezës, që përbën një ngjarje mjaft të rëndësishme e të madhe për popullin shqiptar në Luftën Nacionalçlirimtare.

Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues të forcave antifashiste shqiptare me synim formimin e një fronti të përbashkët lufte kundër okupatorit, duke marrë edhe disa vendime të rëndësishme, një ndër të cilat ishte edhe krijimi i një Shqipërie të lirë, të pavarur e demokratike pas luftës.

Në 79 – vjetorin e saj, duke vlerësuar domethënien dhe rëndësinë e kësaj ngjarje në vazhdimësinë e historisë së Shqipërisë u mbajt një ceremoni përkujtimore, me pjesë-



marrjen edhe të përfaqësuesve të pushtetit qendror dhe atij lokal. Në nder të të rënëve dhe gjithë atyre që bënë të mundur bashkimin e shqiptarëve në luftë kundër pushtuesve u vunë kurora me lule. Në emër të Ministrisë së Mbro-

jtjes, vendosi kurora me lule zëvendësministrja e Mbrojtjes, Dallëndyshe Bici dhe zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse Përparim Gega.

Të pranishmit bënë homazhe në Varrezat e Dëshmorëve.

Gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj në ceremoninë për arritjen e Kapaciteteve të Plota Operacionale (FOC), të Komandës së JSEC

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj mori pjesë në ceremoninë për arritjen e Kapaciteteve të Plota Operacionale, të Komandës së Bashkuar të NATO-s për Mbështetjen (JSEC – Joint Support and Enabling Command), të zhvilluar në Ulm, Gjermani.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast morën pjesë përfaqësues të niveleve më të larta të komandave strategjike të NATO-s, ministri i Mbrojtjes i Gjermanisë, komandanti suprem i Forcave Aleate në Evropë (SACEUR), drejtori përgjithshëm i Stafit Ushtarak Ndërkombëtar (DGIMS), kryetari i Bashkisë së Ulm, si dhe shefat e Shtabeve të Përgjithshëm të vendeve të Aleancës.



Komandanti i JSEC, gjeneralletenant Jürgen Knappe, nëpërmjet kësaj ceremonie synoi promovimin e kësaj strukture të re të NATO-s, rolin e rëndësishëm që ajo do të marrë në operacionet e Aleancës për sigurimin e mbështetjes dhe përforcimin e forcave. Njëkohësisht, aktiviteti synonte edhe vendosjen e komunikimit me vendet e Aleancës si dhe ato partnere për integrimin e mëtejshëm të përpjekjeve dhe aktiviteteve në funksion të operacioneve të Aleancës.

Gjatë këtij aktiviteti, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj shprehu gatishmërinë se bashkëveprimi dhe koordinimi në të ardhmen me Komandën e JSEC do të jetë shumë i ngushtë, kjo pasi çdo dislokim i kontributeve të FARSH jashtë territorit të vendit si dhe forcave të NATO-s brenda zonës së përgjegjësisë së SACEUR do të koordinohet nga kjo strukturë. JSEC është një strukturë e re brenda NATO-s dhe ka një rol të rëndësishëm për sigurimin e dislokimit, lëvizjes së trupave dhe mbështetjes së operacioneve. Gjermania është vend lider në këtë strukturë, në të cilën marrin pjesë personel nga 22 vende të NATO-s, ndërkohë që Shqipëria kontribuon me një oficer në drejtorinë e planifikimit.

Toci: Diplomacia ushtarake, një nga prioritetet e FA-ve, në ushtritë e vendeve perëndimore

Intervistë me Kolonel (R), Dr. Çlirim TOCI, MSC, MA (Lektor, Departamenti i Liderimit dhe Menaxhimit, Kolegji i Vendeve të Balltikut, Tartu, Estoni)

INTERVISTOI
ANJEZA MUSOLLARI

Shpesh roli i diplomacisë përkufizohet si element përbërës i medive, departamentit të shtetit dhe shërbimeve të jashtme, por jo pak herë diplomacia është përcaktuar si "instrument i fuqisë kombëtare" (Reed Fendrick), ndërsa diplomati si njeri i nderuar, dërguar jashtë vendit, "për të gënjer për vendin e tij".

Nisur nga sa më sipër, diplomacia ushtarake si do të përkufizohet?

Me ndryshimet në mjedisin e sigurisë dhe kërcënimet e reja, të ndërthurura në shumë raste me problemet financiare, globalizimin dhe kohën ku ne jetojmë, e bëjnë të domosdoshëm ndërtimin e aleancave dhe bashkëpunimin, të cilat janë baza për një diplomaci ushtarake moderne. Sot bota prezantohet nga një numër i madh aleancash, si NATO, BE, OSBE-ja etj. Aleancat mundësojnë bashkëpunim në të gjitha fushat, atë politike, zhvillimin e teknologjisë, hartimin e politikave dhe strategjive të cilat do të mbështesin institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, në ndërtimin e kapaciteteve, forcimin

e bashkëpunimit dhe besimit midis aleatëve dhe partnerëve. Këtu, diplomacia ushtarake kontribuon në rritjen e rëndësisë së "fuqisë së butë" të diplomacisë ushtarake në prodhimin e më shumë vëmendje, në drejtim të rolit dhe ndikimit të faktorit ushtarak, mbrojtjen e vendit dhe mbarëvajtjen me NATO-n, në bashkëpunim me partnerët dhe aktorët në botë. Shkurt, diplomacia ushtarake mund të përkufizohet si aktivitet i zhvilluar nga Ministria e Mbrojtjes (MM) dhe Forcat e Armatosura (FA) dhe institucionet shtetërore, të cilat kanë si qëllim zbatimin e

interesave kombëtare në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Çfarë është diplomacia në kontekstin e saj të parë?

Diplomacia konkrete nuk është diplomacia publike, për ne nuk është një term i ri. Historikisht, ajo është njohur dhe ka qenë e pranishme në marrëdhëniet midis administratave përkatëse dhe komponentit ushtarak në shtete dhe mbretëri të ndryshme të globit. Institucioni i diplomacisë sipas Mosly dhe Adcock në lashtësi, bazohej plotësisht mbi shkëmbimet gojore dhe kontakteve midis individëve dhe organizatave qeverisëse të kohës.



Për shembull në Greqinë e lashtë individët dërgoheshin në të gjithë Greqinë për të mbështetur procesin e komunikimit. Gjatë kësaj kohe janë identifikuar dy forma të diplomacisë së zhvilluar nga Athinasit: kerykes (lajmëtarë) dhe presbeis (negociatorë). Për ta ilustruar, Athinasit dhe Spartanët (ose Sparta në Peleponez) i deklaruan luftë njëri-tjetrit në Shekullin e 431 p.e.s. Tuqididi në librin e tij "Historia e Luftës në Peleponez" deklaronte se, nga ky moment komunikimi midis dy qytet-shteteve, zhvillohej nëpërmjet lajmëtarëve (kerkykes). Në situata të tilla lufte ose konflikti, tregon rëndësinë dhe rolin e komunikimit ose mbajtjes së kanaleve hapur midis forcave në konflikt. Në atë kohë lajmëtarët përbëheshin nga ushtarakë të gradave të ndryshme, të cilat zhvillonin elementë të asaj që ne sot e quajmë diplomaci ushtarake.

Sot diplomacia ushtarake luan një rol të rëndësishëm në ndryshimin dhe zbatimin e politikave të sigurisë të vendit. Ajo është instrumenti kryesor i politikës së jashtme dhe zë një vend të rëndësishëm në administratën shtetërore në fushën e bashkëpunimit. Sipas ish-sekretarit të mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar (1997-1999) dhe ish-sekretarit të përgjithshëm të NATO-s (1999-2004) Lordit Xhorxh Robertson (George Robertson), diplomacia ushtarake është përkufizuar, "si çarmatosja e mendjes".

Si lindi diplomacia ushtarake?

Diplomacia ushtarake ose siç njihet ndryshe diplomacia e mbrojtjes është relativisht një term i ri, i cili ka lindur pas luftës së ftohtë. Ky koncept ose term, është përdorur për të ndihmuar Perëndimin të adresonte dhe adresojë sfidat dhe rreziqet në mjedisin e ri të sigurisë, të pas viteve 90-të. Si term, diplomacia ushtarake është përdorur së pari nga Mbretëria e Bashkuar dhe më pas nga SHBA-të dhe vende të tjera perëndimore.

Cili është misioni i diplomacisë ushtarake?

Sipas Ministrisë të Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar, misioni i diplomacisë ushtarake është: "Di-

plomacia ushtarake i ndihmon FA-të dhe institucionet e mbrojtjes, të jenë në gjendje të organizojnë një numër aktivitete, me qëllim largimin e frikës, ndërtimin dhe forcimin e besimit, si dhe asistimin në zhvillimet demokratike të forcave të armatosura. Këto forma vepërimesi, mundësojnë në përfitimin dhe afrimin e kontributeve tepër të rëndësishme të FA-ve në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve".

Cilat janë objektivat e diplomacisë ushtarake?

Diplomacia ushtarake është një nga prioritetet e FA-ve, në ushtritë e vendeve perëndimore. Misioni i diplomacisë ushtarake, sipas MM të Mbretërisë së Bashkuar (2001), bazohet në tre detyra/objektiva specifike: 1. reduktimi i rreziqeve; 2. ndërtimi i besimit dhe 3. ndihma/bashkëpunimi në zhvillimin e FA-ve në shoqëritë demokratike. Në shumë raste diplomacia ushtarake zhvillohet dhe zbatohet në bashkëpunim të ngushtë me institucionet të cilat janë përgjegjëse për politikën e jashtme. Diplomacia ushtarake është pjesë e diplomacisë kombëtare. Si e tillë ajo duhet të veprojë.

Ku konsiston ndihma e diplomacisë ushtarake tek forcat e armatosura dhe institucionet e mbrojtjes?

Diplomacia ushtarake ka lindur si nevojë e domosdoshme në forcimin e FA-ve në arritjen e objektivave kombëtare në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Ky term përfshin një gamë të gjerë aktivitete në mbështetje të misionit të FA-ve, si: shkëmbime të personelit ushtarak; vizita të ndërsjella të anijeve luftarake; dhe zhvillimi i përgatitjeve dhe stërvitjeve të përbashkëta. Të gjitha këto zhvillohen dhe zbatohen nën ombrellën e diplomacisë ushtarake. Megjithatë, përdorimi i këtij termi është fleksibel, i përdorur në arenën ndërkombëtare nga shtetet si SHBA-ja, Kina, Franca, dhe Mbretëria e Bashkuar në prezantimin e fuqisë ushtarake, me qëllim zvogëlimin e rreziqeve. Për të arritur objektivat, vendet përdorin diplomacinë ushtarake, si element kryesor në doktrinën e tyre ushtarake dhe strategjinë

kombëtare. Diplomacia ushtarake është e pranishme në politikën e jashtme, sigurinë kombëtare dhe politikën globale.

A është diplomacia arti i negociatave?

Diplomacia ushtarake përkruhet si praktikë në zhvillimin e negociatave, e cila kërkon përdorimin e mjeteve, metodave dhe instrumenteve të cilët nuk krijojnë ambient armiqësor. Ky koncept në të shumtën e rasteve përdoret nën zbatimin e ligjeve ndërkombëtare. Detyra kryesore e diplomacisë ushtarake është të krijojë mjedis miqësor bashkëpunimi midis vendeve.

Për shembull, strategu Kinez Sun Tzu, këtu e 2,500 vjet përpara, do të argumentonte se komandantët/ushtarakët e lartë janë të aftë të arrijnë objektivin me të gjitha mjetet e influencës/ndikimit, përfshirë mjetet e "dhunës" dhe "dialogut". Ndërsa autori Indian Sacharn do ta përkufizonte diplomacinë ushtarake, art ose praktikë të drejtimit në marrëdhëniet ndërkombëtare. Arti dhe praktika e diplomacisë ushtarake, të përcaktuara nga Sacharn, do ta bazonin rolin e saj në parandalimin e konflikteve në dy aspekte: 1. roli i diplomacisë parandaluese (Preventiv Diplomacy), dhe 2. roli i diplomacisë shtrënguese (Coercive Diplomacy).

Komponenti ushtarak nëpërmjet diplomacisë parandaluese, ka si qëllim arritjen e një klime konfidenciale të rëndësishme në përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet dy ose më shumë vendeve. Ekspertët dhe analistët në fushën e sigurisë, këtë rol/objekt të diplomacisë parandaluese e kanë quajtur "diplomacia ushtarake e kohës së paqes". "Termi diplomaci dhe përdorimi i forcës janë dy opsione të kundërta, si pjesë përbërëse e spektrit të vendimmarrjes politike, njëri element është përdorur në atë rast kur elementi tjetër ka dështuar, por është e rëndësishme se të dyja duhet të mbështesin njëra tjetrën (S.Sacharn)".

Diplomacia shtrënguese mund të përdoret kur të gjitha komponentët e diplomacisë parandaluese janë konsumuar. Ky moment

përcakton vijën ndarëse imagjinare ndërmjet diplomacisë dhe luftës. Suksesi i diplomacisë shtrënguese lidhet me tregimin/prezantimin e aftësive ushtarake në vend të përdorimit të tyre (S. Sacharn). Fuqia dhe potenciali ushtarak përbën thelbin e diplomacisë shtrënguese. Për shembull, studiuesit Alexander George dhe Thomas Schellin – japin vlerësime të balancuara në të cilat diplomacia shtrënguese ka gjasa të triumfojë ose dështojë. Ata theksojnë rëndësinë e kuptimit të plotë të "shkopit" në marrëveshjet diplomatike me kundërshtarët në rifuqimin e apelit të "karotës" si shtysë pozitive, në vend të përdorimit të forcës.

Pse negociatat prodhojnë zgjidhje më të qëndrueshme dhe afatgjatë?

Vende të ndryshme në përfundim janë përfshirë në aktivitete dhe programe në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Vendet e zhvilluara inkurajojnë demokracinë e reja të bashkëpunojnë me vendet fqinjë dhe ish-armiqte, me qëllim integrimin në strukturat Euro-Atlantike. Ajo u mundëson vendeve me demokraci në zhvillim të kuptojnë dhe besojnë njëri-tjetrin. Akademikë dhe ushtarakë të ndryshëm kanë dalë në konkluzionin, se diplomacia ushtarake është elementi me efektiv në parandalimin e konflikteve dhe krijimin e rezultateve afatgjata dhe të qëndrueshme.

Një nga kërcënimet më domuese në fushën e sigurisë, në shekullin e XXI, ka qenë dhe mbetet lufta kundër terrorizmit ndërkombëtar. Kjo është quajtur ose etiketuar nga SHBA-të si lufta e gjatë (Long War). Gjatë këtyre viteve, vendet perëndimore duke përfshirë dhe SHBA-të kanë aplikuar diplomacinë ushtarake, në bashkëpunimi me vende dhe aktorë të ndryshëm. Pa as më të voglin dyshim, diplomacia ushtarake rrit në mënyrë të ndjeshme kapacitetet diplomatike dhe sigurisë të një vendi, duke mundësuar lidhjen ndërmjet institucionit të mbrojtjes dhe institucionit të punëve të jashtme. Kjo lidhje siguron në mënyrë të qëndrueshme dhe ka efekte afatgjatë në adresimin e



rreziqeve dhe krijimin e stabilitetit në vende dhe rajone të caktuara. Për vendet e vogla si ne, është e rëndësishme të kuptojmë rolin e diplomacisë ushtarake dhe si ajo vepron në praktikë, në adresimin e rreziqeve si: lufta kundër terrorizmit (COIN) dhe roli i FA-ve gjatë operacioneve paqeruajtëse (peace support; peace making & peace building), në rajonit dhe më gjerë.

Si është zhvilluar diplomacia ushtarake pas viteve 90'?

Pas luftës së ftohtë, balancat në botë ndryshuan dhe hapën rrugën organizatave ndërkombëtare mbi zbatimin e ligjit ndërkombëtar. Gjatë kësaj periudhe doli në pah rëndësia e rregullave demokratike në fushën e sigurisë dhe nevojën e institucioneve të ndërtuara mbi parimet demokratike.

Gjatë luftës së ftohtë, e rëndësishme ishte se me cilën anë ishit, me Lindjen apo me Perëndimin. Vendet nuk i kushtonin rëndësi ekzistencës të institucioneve të sigurisë. Në fund të luftës së ftohtë, koncepti për sigurinë filloi të ndryshojë. Shtetet filluan të ndryshonin idenë për konceptin e sigurisë. Përgjegjësia dhe përcaktimi i sektorit të sigurisë kishte ndryshuar, në përcaktimin e rolit të politikës së jashtme dhe sigurisë. Tani vëmendja ishte përqendruar tek njeriu/individ. Liritë dhe të drejtat e njeriut u bënë pika e nisjes e politikës së jashtme dhe sigurisë. Vendet filluan të mendonin për paqen, zhvillimet

ekonomike, politiken, rindërtimin e shoqërive dhe integrimin në strukturat Euro-Atlantike. Kjo intensifikoi bashkëpunimin midis Perëndimit dhe Lindjes. Ky bashkëpunim u përqendrua në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes njohur si (military to military cooperation/programmes). Këtu filloi të përdorej diplomacia ushtarake. Ajo është konsideruar nga Muniruzzaman, si element tepër i rëndësishëm dhe i fuqishëm në shtet-formim.

Pas viteve 1990, vendet filluan të mendonin dhe ndryshonin konceptin për sigurinë. Shtetet, në vend të konfrontimit, panë të arsyeshme të bisedojnë dhe bashkëpunojnë. Diplomacia ushtarake ishte elementi, ndoshta më i spikatur dhe me i kohës në përmirësimin e marrëdhëniet në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes midis ish-armiqve. Gjatë kësaj periudhe diplomacia ushtarake vuri theksin në kontributin që FA-të mund të japin, në rritjen e sigurisë dhe pjesëmarrjen në operacionet paqeruajtëse. NATO për të rritur bashkëpunimin midis vendeve perëndimore dhe vendeve ish-komuniste të lindjes, krijoi iniciativën e partneritetit për paqen (PfP-1994). Kjo iniciativë shërbeu për të afruar dhe standardizuar kapacitetet dhe metodat e trajnimit dhe mësimdhënies me ish-vendet e traktatit të Varshavës (Warsaw).

Këtu dëshiroj të paraqes disa nga fushat ose aktivitetet e diplo-

macisë ushtarake, të cilat spikasin pas viteve 1990:

- Krijimi i planeve dy e shumëpalësh në fushën e mbrojtjes me vende të ndryshme; emërimi i atashëve ushtarake ose të mbrojtjes;
- Përgatitja e marrëveshjeve dhe përgatitjen e personelit ushtarak dhe civil në fushën e mbrojtjes në vendet aleate dhe partnere;
- Mundësimi i asistencës teknike, ushtarake, arsimore dhe në rastet e emergjencave natyrore vendeve në nevojë.

Për shembull, Shqipëria (pas vitit 1990) ka përfituar shumë në fushën e trajnimit, edukimit, ndërtimeve të kapaciteteve ushtarake. Këtu vlen të përmendet programi IMET (SHBA), trajnimet dhe përfitimin e asistencës ushtarake nga Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Italia, Turqia, Greqia etj.

Për ta mbyllur, Peter Leahy (2014) në shkrimin e tij "Military Diplomacy" thotë se diplomacia ushtarake nuk ndodh sa hap e mbyll sytë. Ajo mund të mos zbatohet siç është planifikuar. Ajo kërkon një investim të gjerë, serioz, merr kohën e duhur dhe mund të mos jetë efektive në çdo rast. Një shembull domethënës është investimi afatgjatë në marrëdhëniet midis vendeve dhe individëve. Marrëdhëniet duhet të zhvillohen në të gjitha nivelet e drejtimit dhe komandimit në FA. Ky është investim i rëndësishëm për të ardhmen, sigurinë, rritjen e besimit reciprok, midis atyre vendeve dhe individëve të cilët ndajnë vlera dhe ide të njëjta për sigurinë dhe politikën e jashtme.

A është diplomacia ushtarake mjet për parandalimin e konflikteve?

Zgjidhja e konflikteve konsiderohet nga studiues dhe analistë të ndryshëm, si ndërthurja midis njerëzimit dhe adresimit të rreziqeve në nivele botërore. Ky shqetësim është i pranishëm në të dyja, FA-të dhe instrumentet diplomatikë të politikës së jashtme. Kjo lidhje ka qenë gjithmonë e pranishme, diplomatët janë angazhuar gjithmonë për të arritur marrëveshje midis palëve dhe dhënien fund të luftës, ndërsa komandantët/ushtarakët duhet të presin deri në aktivizimin e elementëve të

diplomacisë ushtarake.

FA-të në të shumtën e rasteve kanë praktikë zbatimin e "diplomacisë parandaluese". Ky term është reflektuar qartazi në Kapitullin e 9-të të dokumentit të Kombeve të Bashkuara (the United Nations Charter), por gjatë luftës së ftohtë nuk është përdorur. Pas viteve 90-të, më ndryshimin e natyrës së luftës, duke parë zhvillimin e konflikteve midis shteteve, grupeve etnike dhe fetare, ky koncept del në pah, me qëllim parandalimin e konflikteve. Roli parandalues i diplomacisë është përmendur për herë të parë nga politikani Egjiptian Boutros Boutros-Ghali (1992), në dokumentin e quajtur "Agenda for Peace/Programi i Paqes". Ai e përcaktoi "diplomacinë parandaluese si veprim në parandalimin e mosmarrëveshjeve midis palëve".

Nga koha e mbarimit të luftës së ftohtë, praktikat e diplomacisë ushtarake kanë marrë vëmendje të madhe, në parandalimin e konflikteve. Sot, mjedisi i sigurisë është shumë dinamik dhe i paparashikueshëm. Vendet me demokraci të zhvilluar dhe ato në zhvillim, duhet t'i kushtojnë rëndësi bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes, me qëllim (rai-son e'eter) adresimin e rreziqeve dhe mbrojtjen e integritetit territorial. Strategjet e mendimit ushtarak Frederick the Great (Mbreti i Prusisë ... 1740-1786) dhe Carl von Clausewitz kanë theksuar rëndësinë dhe rolin e ushtarakëve dhe përshtatjen e diplomacisë ushtarake, si moment integruar i saj në shërbim të arsenalit të fuqisë kombëtare. Clausewitz ka shkruar më tej mbi diplomacinë ushtarake, duke theksuar nevojën për udhëheqës/liderë me uniformë, të cilët duhet të jenë ushtarakë dhe burra shteti.

Si kanë qenë bashkëpunimet ushtarake NATO-Rusi dhe SHBA-Kinë?

Bashkëpunimi NATO – Rusi

Diplomacia ushtarake është përdorur nga vendet perëndimore, pas vitit 1990, në ndërtimin e marrëdhënieve me ish-vendet komuniste, duke përfshirë dhe Federatën Ruse. Ky bashkëpunim, me Rusinë ka filluar në

vitin 1970, me nënshkrimin e marrëveshjes në Ndërtimin e një Mjedisi Sigurie Konfidencial dhe të Sigurt (CSBMs), duke intensifikuar bashkëpunimin gjatë kohës së Z. Gorbaçovit në vitin 1980.

Federata Ruse u bë anëtare e programit për partneritet për paqen (PfP ... 1994-95) dhe pjesë e krijimit të Marrëdhënieve NATO – Rusi në fushën e bashkëpunimit dhe sigurisë (1997). Pas samitit të NATO-s në Romë (2002), u krijua këshilli NATO – Rusi. Rusia ka marrë pjesë në programe stërvitore, arsimore dhe trajnime të organizuara nga NATO dhe vendet anëtare. Ajo ka qenë pjesë e operacioneve paqeruajtëse të drejtuara nga OKB dhe NATO në Bosnje-Hercegovinë (SFOR .. 1995-2003) dhe në Kosovë (KFOR ... 1999-2004). NATO ka dhënë një mbështetje të çmuar në tërheqjen e trupave ruse nga Europa Lindore dhe Azia Qendrore, si dhe trajnimin dhe ri-integrimin e oficerëve të liruar. Këtu nuk duhet harruar dhe ndihma e NATO-s dhënë Rusisë në sigurimin dhe reduktimin e armëve nukleare, kimike dhe bërthamore nëpërmjet programeve në kuadër të aleancës, programeve dypalëshe si programi i bashkëpunimit dhe asistencës me SHBA-të (US Nunn – Lugar).

Megjithatë bashkëpunimi midis NATO-s dhe Rusisë ka njohur ngritje dhe zbritje. Për shembull, gjatë sulmeve ajrore të NATO në Kosovë (1999), udhëheqja Ruse i ndërpreu të gjitha bashkëpunimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë m NATO-n. Rusia në shumë raste ka kërcënuar NATO-n dhe vendet Perëndimore me kthimin e të ashtuquajturës "Lufta e Ftohtë". Konflikti midis NATO/Perëndimit dhe Rusisë arriti kulmin në vitin 2008, gjatë konfliktit Gjeorgji dhe Rusi, aneksimi i gadishullit të Krimesë/Ukrainë (2014) dhe konflikti në rajonin Donbass, në lindje të Ukrainës (2014- ...). Aktualisht marrëdhëniet midis NATO-s dhe Rusisë janë në nivelin më të ulët që nga rënia e murit të Berlinit (1989).

Bashkëpunimi SHBA – Kinë

Gjatë dy dekadave të fundit,

Kina ka shkaktuar debate në lidhje me zhvillimet ekonomike, politike dhe ushtarake. Kina ka filluar të konsiderohet një nga vendet me zhvillimin më të madh ekonomik që ka njohur ndonjëherë bota. Zhvillimet ekonomike dhe politike nuk kanë lënë jashtë vëmendjes dhe zhvillimet në fushën ushtarake. Ndryshimet e vrullshme në fushën ekonomike, politike dhe ushtarake i "detyruan" në një farë mënyre SHBA-të të përcaktonin në politikat e tyre bashkëpunimin dhe ndërtimin e marrëdhënieve me Kinën. Ky bashkëpunim ka filluar me vizitën, në vitin 1970, të presidentit Amerikan Richard Nixon dhe Henry Kissinger. Njohjen e Kinës nga SHBA-të në vitin 1979, duke vazhduar me një numër vizitash të titullarëve të dy shteteve në vendet përkatëse, deri në ditët tona.

Le të ndalemi tek bashkëpunimi në fushën ushtarake. Marrëdhëniet në fushën politike dhe të mbrojtjes, midis SHBA-ve dhe Kinës kanë reflektuar tensione. Mosmarrëveshjet midis dy vendeve janë përqendruar në dy aspekte: 1. Respektimi i të drejtave të njeriut. 2. Çështja e Taivanit. Por le të shikojmë dhe konstatojmë marrëdhëniet midis dy vendeve që nga viti 1990, ato janë: 1. Diskutime në nivele të larta politike, duke përfshirë titullarët e vendeve, ministrat e jashtëm dhe të mbrojtjes; 2. Shkëmbime vizitash në nivele të lartë ushtarake; 3. Shkëmbime të vizitave të personelit në fushën e arsimit/edukimit ushtarak; 4. Miratimi në vitin 1998, i marrëveshjes për konsultimet ushtarake detare; 4. Vizita reciproke të anijeve luftarake; 5. Ndihma në fushën e zbatimit të të drejtave të njeriut dhe fatkeqësive natyrore; 6. Nënshkrimi i marrëveshjeve për vëzhgimin e stërvitjeve dhe shkatërrimin e armëve bërthamore etj.

Cilat janë prioritetet strategjike të diplomacisë ushtarake?

Diplomacia ushtarake zbatohet për të arritur dhe ndikuar në dy drejtime: Objektivat e përcaktuar nga strategjia e sigurisë kombëtare dhe objektivat e politikës së jashtme. Këto janë bazat që përcaktojnë prioritetin strategjik të rolit dhe rëndësisë të diploma-

cisë ushtarake.

Së pari dhe mbi të gjitha, duhet të kuptojnë të gjithë aktorët politik dhe ushtarak, se diplomacia ushtarake nuk zëvendëson politikën e jashtme dhe të sigurisë kombëtare, por është pjesë mbështetëse në zbatimin e objektivave kombëtare. Ajo punon/luan si ndërtuese e besimit dhe zhvillimit të lidhjeve të ngushta me aktorë dhe vende të ndryshme.

Sy dyti, ndihmon në rritjen e dijeve në fushën e mbrojtjes, sigurisë, teknologjisë dhe kuptimin e koncepteve mbi zhvillimin e luftës (concepts of warfare), nëpërmjet trajnimeve dhe studimeve brenda dhe jashtë vendit.

Së treti, trajnimi dhe përgatitja teorike dhe pjesëmarrja në stërvitjet e përbashkëta është një element i rëndësishëm i diplomacisë ushtarake. Të gjitha këto objektiva të diplomacisë ushtarake ndihmojnë vendin në arritjen e objektivave dypalëshe dhe shumëpalëshe.

Cilët janë aktorët e diplomacisë ushtarake në procesin e integritetit?

Në proceset integruese të FA-ve janë përfshirë një numër aktorësh dhe institucionesh të ndryshme. Niveli i përfshirjes së aktorëve në fushën dhe aktivitetin e diplomacisë ushtarake ndahet në tre grupe: 1. Aktorë të përfshirë në nivelin strategjik; 2. Nivelin operacional 3. Aktorët e përfshirë në nivelin taktik.

1. Diplomacia ushtarake në nivelin strategjik të lartë, përfshin udhëheqjen civile dhe ushtarake të shtetit dhe Ministrisë së Mbrojtjes. Ky nivel ndiqet nga shtabi i përgjithshëm, atashetë ushtarakë, përfaqësuesit në komandat e NATO-s (NATO HQ, SHAPE, ACT).

2. Nivelin operacional përfshin komandat e forcave dhe llojeve të armëve, përfaqësuesit në komandat operacionale si JFC Naples, JFC Brunson, Land Component (Turqi), Air Component (Gjermani), Maritime Component (UK/MB) etj.

3. Nivelin taktik i diplomacisë ushtarake përfshin ushtarakët të cilët shërbejnë në nivel Brigade, batalioni, misione paqeruajtëse

(p.sh. KFOR, Op. Althea BiH, Iraqi Training Mission etj).

Si pasqyrohet Diplomacia ushtarake në kushtet e reja të sigurisë dhe mbrojtjes?

Diplomacia ushtarake në mjeshterinë e ri të sigurisë është përfshirë në rritjen e besimit dhe bashkëpunimit midis aktorëve të ndryshëm. Ky bashkëpunim bazohet në fushën e mbrojtjes, sigurisë, arsimit, trajnimit, stërvitjes, teknologjisë, standardeve, legjisllacionit, shkëmbimit të ideve dhe përvojave etj.

Mund të përmendni disa nga bashkëpunimet dhe kontributet e FA-së gjatë Partneritetit me NATO-n?

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kanë një përvojë të gjatë bashkëpunimi me NATO-n. Ka disa momente të cilat duhen përmendur në këtë bashkëpunim si Anëtarësimi i Shqipërisë në programin e partneritetit për paqen (PfP) nënshkruar në vitin 1994; Pjesëmarrja në Planin e Veprimit për Anëtarësim (MAP) dhe Procesi i Planifikimit dhe Rishikimit të Partneritetit (PARP) 1999;

Pjesëmarrja në Programin e Objektivave Individuale të Partneritetit (IPP). Objektivat e parë të partneritetit midis Shqipërisë dhe NATO-s u miratuan me 25 Janar 1995.

Cili është kontributi i FA-së në operacionet Paqeruajtëse (PSO)?

Forcat e armatosura të Republikës së Shqipërisë kanë marrë pjesë në një numër misionesh paqeruajtëse. Disa nga operacionet, ku FA-të kanë marrë pjesë janë:

1. Misionin në Bosnje-Hercegovinë (BiH) (1994 – UN/NATO/EU "Misioni Althea");

2. Irak "2003-2011 Operation Iraqi Freedom – US Lead operation";

3. Afganistan "2001-2014 International Security Assistance Forces (ISAF), NATO Mission"; 4. Afganistan, 2015-2021 "NATO-led mission Rolute Support Mission (RSM)"; 5. Misioni në kuadër të BE-së dhe OKB-së në Çad dhe Republikën e Afrikës Qendrore, (2007) TCHAD/RCA dhe (2008) MINURCAT etj.

Hatixhe Çollaku, komandatja e parë e Inteligjencës së Gardës Kombëtare të “New Jersey” në Shqipëri

Togerja Hatixhe Çollaku u largua nga Shqipëria me familjen, drejt Shteteve të Bashkuara, kur ishte vetëm shtatë vjeç. Tani, ajo kthehet në Shqipëri si komandantja e parë në Kompaninë e Inteligjencës të Gardës Kombëtare të New Jersey-it, së bashku me kolegët e saj, për të trajnuar Forcat e Armatosura Shqiptare mbi përdorimin e sistemeve ajrore pa pilot PUMA, dhuruar nga Shtetet e Bashkuara. Kur u largua nga Shqipëria, vështirë të mendonte rikthimin në vendlindjen e saj, për më tepër si ushtarake. E graduara Togere e Parë, Hatixhe Çollaku është Komandante e Kompanisë së Inteligjencës të Gardës Kombëtare të Nju Xhersit. “Jam larguar nga Shqipëria në moshën 7-vjeç. Arsimin, nga klasa e parë deri në universitet, e kam kryer komplet në Amerikë”, -thotë ajo. Togere e Parë Çollaku ndodhet në Shqipëri me mision trajnimit e Forcave të Armatosura për përdorimin e dronëve të dhuruar nga Shtetet e Bashkuara. “Kam ardhur për një mision: të mësojmë përdorimin e “UAV”-ve për ushtrinë shqiptare. “UAV” është një dron për misione taktike, civile, në situata emergjencash dhe humanitare”, -tregon Togere Çollaku. Hatixheja thekson se, duke kërkuar mundësi për rritje në karrierën e saj, me takime dhe biseda me njerëz të ushtrisë, mësoi që kërkohej një oficer inteligjence për Shqipërinë. “Kur e morën vesh që jo vetëm jam oficer, por flas edhe shqip, u gëzuan shumë dhe thanë: “me siguri do të jesh ti pjesë e këtij misioni”. Kur erdha ka qenë shumë eksperiencë e bukur të shoh, jo vetëm rreshterët, por edhe oficerët që mundohen të marrin trajnim nga ushtria amerikane për të avancuar kapacitetet e tyre”. Hatixhe Çollaku thotë se ka dashur kurdoherë të kthehej në Shqipëri



me mision, prandaj hyri në Gardën e Nju Xhersit, duke qenë Komandantja e parë femër e Kompanisë së Inteligjencës. “Ngaqë jam rritur në Amerikë, ndihem të dyja”, por jam shumë krenare që jam shqiptare! T’ua tregoj historinë e Shqipërisë, si është kultura shqiptare, si janë njerëzit, çfarë do të presësh kur të arrish në Shqipëri”, -shprehet ajo. Hatixhe Çollaku vjen nga një familje e lidhur me ushtrinë, pasi babai i saj ka qenë major i logjistikës në ushtrinë e Shqipërisë. Jam larguar nga Shqipëria në moshën 7-vjeç. Para shumë

vitesh kam pasur hallën që jetonte përballë shkollës ku bëheshin stërvitje dhe thosha gjithmonë: a do jemi unë ndonjëherë në anën e kundërt. Kam parë shumë sakrifica që kanë bërë prindërit e mi kur kemi ikur në Amerikë, dhe duke parë ato sakrifica dhe duke pasur atë ndjenjën që të jem si prindërit e mi, të fortë dhe të mundohem të arrij sa më shumë jam futur në ushtrinë amerikane. Jam shumë krenare që jam shqiptare dhe gjej mundësinë që t’ua tregoj në Amerikë historinë e Shqipërisë”, -tregon Çollaku.



“Bashkëpunimi midis trupave amerikane dhe shqiptare do të vijojë edhe përtej stërvitjes së zhvilluar këtë vit ‘Defender 21’”

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj priti në një takim zëvendëskomandantin e Forcave Tokësore të SHBA-së për Evropën dhe Afrikën (USAREUR-AF), gjeneralmajor Joseph F. Jarrard,

Gjeneralmajor Begaj në fjalën e rastit theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ushtarak që ekziston midis Shqipërisë dhe SHBA-së, duke vlerësuar kontributin e vazhdueshëm që ushtria amerikane ka dhënë dhe vazhdon të japë në rritjen e aftësive operacionale të FARSH.

Njëkohësisht, një falënderim të veçantë gjeneralmajor Begaj adresoi për Zyrën e Bashkëpunimit të SHBA-së në fushën e Mbrojtjes të atashuar në Shqipëri, duke vlerësuar punën dhe kontributin e vazhdueshëm që ata vijnë të japin në këtë drejtim.

Gjeneralmajor Jarrard nga ana e tij, pasi vlerësoi angazhimin maksimalisht dhe performancën e treguar nga FARSH në të gjitha kontributet ndër vite, si pjesë e misionit ISAF dhe më vonë Rolute Support, në Afganistan, theksoi se SHBA-të qëndrojnë pranë aleatëve dhe partnerëve të tyre siç kanë qëndruar edhe pranë Shqipërisë, me synim ndërtimin e marrëdhënieve të forta dhe promovimit të ndërveprimit ushtarak dhe ngritjen e kapaciteteve.

Në fund, ai siguroi gjeneralmajorin Begaj se bashkëpunimi midis trupave amerikanë dhe shqiptarë do të vijojë edhe përtej stërvitjes së zhvilluar këtë vit “Defender 21”, e fokusuar në fushat e trajnimit dhe shkëmbimit të eksperiencës.

Gjatë këtij takimi, nga ana e komandantit të Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA), gjeneral brigade Albert Mullai, u mbajt një briefing informues me tematikë rolin që ka AFA në arsimimin, trajnimin dhe edukimin e personelit të FARSH, njëkohësisht edhe mbi vizionin e ardhshëm të AFA-së. Ushtria Amerikane për Evropën



dhe Afrikën siguron forca tokësore të gatshme për të penguar, dhe nëse është e nevojshme, për të mposhtur çdo agresion nga kundërshtarë të mundshëm në Evropë dhe Afrikë. Për ta arritur këtë, USAREUR-AF vendos kushtet e nevojshme dhe

është e përgatitur të shërbejë si Shtab i Forcave të Përbashkëta, për të luftuar në të gjithë spektrin e plotë të operacioneve ushtarake, nga reagimi ndaj emergjencave apo krizave, dhe deri në luftime në shkallë të gjerë.

Zëvendëskomandanti i Ushtrisë Amerikane për Evropën dhe Afrikën, vizitë zyrtare Forcën Tokësore

Gjeneralmajor Joseph Jarrard: Bashkëpunimi ka për synim rritjen e aftësive dhe gatishmërisë operacionale të Forcës Tokësore

Komandanti i Forcës Tokësore, Gjeneral Brigade Arben Kingji priti në takim zyrtar zëvendëskomandantin e Ushtrisë Amerikane për Evropën dhe Afrikën, gjeneralmajorin Joseph Jarrard. Në takimin e zhvilluar, komandanti i Forcës Tokësore shprehu falënderimet për ndihmën dhe asistencën amerikane në zhvillimin e trajnimeve të përbashkëta mbi pajisjet e reja të marra dhe stërvitjeve me njësitë e kësaj force.

Eksperiencën e përfituar nga ky bashkëpunim ka ndihmuar në rritjen e ndërprueshmërisë së efektivëve tanë gjatë zhvillimit të stërvitjeve dhe misioneve të përbashkëta, duke përfituar ekspertizën më të mirë të trupave ushtarake amerikane. Gjeneralmajor Jarrard vlerësoi angazhimin dhe performancën e treguar nga Forca Tokësore gjatë stërvitjes “Defender Europe – 21”, e cila kishte peshën më të madhe të angazhimit me trupa dhe mjete, si dhe theksoi që bashkëpunimi ka për synim rritjen e aftësive dhe gatishmërisë operacionale të Forcës Tokësore.

Forca Tokësore në bashkëpunim me USAREUR-AF, për vitin 2022 do të zhvillojë disa stërvitje të rëndësishme si: “Swift Response”, “Saber Junction”, “Laufer”, në kuadër të stërvitjes “Defender Europe”, si dhe stërvitjet e tjera të përvitshme si JCET, KFOR etj. Nga pala shqiptare, në takim morën pjesë komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Arben Kingji, shefi i Shtabit në Forcën Tokësore kolonel Ilirjan Dauti, komandanti i ROS kolonel Arben Zani, komandanti i b2k nënkolonel Dritan Muka. Takimi u mbyll me shkëmbim dhuratash dhe një foto të përbashkët.

Përkujtohen viktimat e sulmeve të 11 Shtatorit

Peleshi: Lufta nuk ka mbaruar, terrorizmi mbetet armik i pabesë

“Lufta jonë e përbashkët ende nuk ka mbaruar! Do të donim që me ikjen tonë të linim pas një Afganistan të qetë e demokratik, ku jeta, liria dhe dinjiteti i popullsisë civile të mbrohej dhe garantohej. Terrorizmi mbetet një armik i egër dhe i pabesë”.

Gati 3000 viktimat e shkaktuara nga sulmet terroriste të 11 Shtatorit u përkujtuan në një ceremoni në Ambasadën e SHBA-së në Tiranë. Në këtë ceremoni solemne morën pjesë edhe ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Bajram Begaj. Në emër të qeverisë shqiptare, ministri Peleshi kujtoi viktimat e pafajshme të atyre sulmeve dhe theksoi rëndësinë e bashkëpunimit mes aleatëve për të luftuar terrorizmin. Ministri Peleshi përmendi me krenari kontributin e Shqipërisë në këtë luftë me në krye SHBA-të dhe falënderoi gratë dhe burrat që shërbyen me kurajë në Afganistan dhe Irak. “Në këto 20 vite, së bashku, të udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, marshuam në zemër të terrorit për të mbrojtur vlerat thelbësore të lirisë dhe dinjitetit njerëzor. Unë besoj se edhe Shqipëria

i mbajti mbi shpatulla me dinjitet këto 20 vite luftime të përbashkët.

Dua të shpreh mirënjohje dhe nderim të thellë për të gjithë ata burra dhe gra, ushtarakë profesionistë, që nderuan vendin e tyre në misionet më të rrezikshme në Irak dhe Afganistan”.

Duke iu referuar ngjarjeve të fundit në Afganistan, ministri Peleshi theksoi rëndësinë e vijimit të bashkëpunimit mes aleatëve për të fituar një luftë që ende s’ka përfunduar dhe siguroi SHBA-të se Shqipëria do të jetë krah aleatëve për çdo vendim që do të merret për të parandaluar sulme të tjera të tmerrshme. “Lufta jonë e përbashkët ende nuk ka mbaruar! Do të donim që me ikjen tonë të linim pas një Afganistan të qetë e demokratik, ku jeta, liria dhe dinjiteti i popullsisë civile të mbrohej dhe garantohej. Terrorizmi mbetet një armik i egër dhe i pabesë. Detyra jonë është të mbetemi të bashkuar, të ndajmë informacionin, të ndërveprojmë në çdo qelizë për të shmangur rreziqet që vijnë nga befasia. Ne mirëpresim me bujari këdo që na kërkon ndihmë dhe strehë. Civilët e pafajshëm të Afganistanit janë në besën tonë, sa kohë që atyre u duhet mbrojtje. Siguroj SHBA-të dhe vendet e tjera aleate se, në çdo kohë, në çdo vendim që merret për të garantuar jetën dhe lirinë e qytetarëve tanë, ne do të jemi gati e përkrah tyre për të parandaluar një tjetër 11 shtator.” - u shpreh ministri Peleshi.

Në fjalën e tij, zëvendës ambasadori i SHBA-së, Demian Smith, veç viktimave amerikanë, kujtoi dhe ata me origjinë nga Shqipëria. Në sulmet e 11 Shtatorit të vitit 2001 në SHBA mbetën të vdekur 2977 qytetarë të pafajshëm dhe u plagosën më shumë se 6000 të tjerë.



Më 13 shtator 2011, anija "Oriku" u ul për herë të parë në ujë. Pas kompletimit të anijes me pajisjet dhe materialet e nevojshme të përfundimit të punimeve dhe testimit në lundrim, anija "Oriku" u mor në dorëzim, duke u bërë anija më e re e Forcës Detare, më 24 shkurt 2012. Anija "Oriku" ishte e para anije që mori pjesë në operacionin e NATO-s "Sea Guardian", duke shërbyer për 18 muaj në detin Egje. Roli i efektiveve dhe anijes shqiptare në këtë operacion ishte raportimi i emigrantëve në zonën operacionale dhe ndërhyrja duke ofruar ndihmë në rastet kur kishte rrezik për jetën. Anija "Oriku" ka marrë pjesë në shumë stërvitje të përbashkëta me vendet anëtare të

Anija "Oriku" feston 10-Vjetorin e daljes në det



NATO-s, jashtë ujërave territoriale të Shqipërisë. Nga data 05 maj deri më 09 qershor 2021 anija "Oriku" mori pjesë në stërvitjen e madhe

shumëkombëshe "Defender Europe 21". Në këto 10 vite, anija "Oriku" ka përshkruar 55,000 milje detare dhe ka kryer 9,535 orë motorike.

ISS-24/ Konferenca kryesore e fuqisë detare

Simpoziumi Ndërkombëtar i Fuqisë Detare (ISS-24) është konferenca kryesore e fuqisë detare në botë dhe ngjarja më e rëndësishme e US CNO (chief of naval operations). I organizuar nga Kolegji i Luftës Detare të SHBA-së, Newport, Rhode Island, ai është mbajtur dy herë në vit që nga viti 1969 dhe është forumi i vetëm në botë që mbledh së bashku krerët e Flotave Detare botërore në një vend të vetëm. Qëllimi i ISS është të avancojë bashkëpunimin detar në nivele rajonale dhe globale duke bashkuar udhëheqësit kryesorë detarë dhe akademikë të botës për të shkëmbyer e hapur ide për diskutim dhe rishikim nga kolegët. Kjo konferencë lejon Marinën e Shteteve të Bashkuara të angazhohet dhe të komunikojë me kombet me të cilët nuk ka pasur mundësi. Pjesëmarrës nga Forca Detare ishte komandanti i Forcës Detare gjeneral brigade Ilir Xhebeuxia i shoqëruar nga koordinatori me QNOD, kapiten i rangut të II Gjovalin Ndoj. Gjatë këtij simpoziumi, komandanti i Forcës Detare zhvilloi takime bilaterale në interes të bashkëpunimit me komandantët e Forcave Detare turke, rumune dhe holandeze. Gjatë zhvillimit të tij u

Komandanti i Forcës Detare merr pjesë në Simpoziumin Ndërkombëtar të Fuqive Detare



trajtuan tema si: Siguria detare sipas rendit të bazuar në rregulla; Kombet mbledhen për të përcaktuar rregulla bazuar mbi kuadrin e ligjit ndërkombëtar detar, rregullave, normave dhe standardeve; Fuqia detare në epokën e informacionit; Ndikimi i rritjes së informacionit global dhe komunikimit në të menduarit tradicional për rolin e fuqisë detare; Peshkim ilegal, i pa raportuar dhe i parregulluar (IUU). Peshkimi ilegal, i pa raportuar dhe i

parregulluar jo vetëm që kërcënon ekosistemet e oqeanit dhe peshkimin e qëndrueshëm, por gjithashtu kërcënon sigurinë ekonomike të kombeve në të gjithë globin. Pjesëmarrja në Simpoziumin Ndërkombëtar të Fuqive Detare është një aktivitet tejet i rëndësishëm për Forcën Detare, pasi niveli i lartë i përfaqësimit dhe çështjet që trajtohen aty kanë lidhje të drejtpërdrejtë me bashkëpunimin mbi sigurinë detare.

Kurioziteti i njerëzve për të eksploruar planetin ku jetojmë ka bërë të mundur që njeriu vazhdimisht të punojë për zbulimin e gjithçkaje që e rrethon.

Ideja për të udhëtuar nën ujërat e deteve, oqeaneve, vetë eksplorimi nënujor i ka magjepsur njerëzit për mijëra vite. Misteri i botës ujore, jeta që gëlonte në të, gjithmonë do ta grishnin mendjen e njeriut, kështu, u ndien nevoja për një mjet lundrues nënujor. U hodhën hapat e parë derisa u krijua mjeti i veçantë për lundrim nënujor, që u quajtën nëndetëse. Nëndetësja e parë, me emrin "American Turtle" (Breshka Amerikane, për shkak të formës së saj) u ndërtua në vitin 1775 nga inxhinieri David Bushnell, dhe hyri në përdorim një vit më pas, gjatë Luftës së Pavarësisë Amerikane. Në vitin 1800 amerikani Robert Fulton ndërtoi në Francë "Nautilus-in", të gjatë 6 metra e të gjerë 1,80 metra, që mund të mbante 8 persona. "Nautilus" mund të lundronte si në sipërfaqe, po ashtu edhe të zhytej nën ujë për 8 orë. Dizajni i Fulton prezantoi elementë që mund të gjenden në nëndetëset moderne, një sistem të dyfishtë shtytjeje dhe një sistem ajri të ngjeshur që i lejoi ekuipazhit disa orë udhëtim nënujor. Kjo nëndetëse kishte bërë një numër provash zhytjesh të suksesshme, duke arritur një thellësi prej 25 metrash. Megjithëse bëri një numër sulmesh ndaj anijeve të Marinës Mbretërore, ata gjithmonë mund ta shihnin Nautilusin që vinte dhe e shmangën me lehtësi atë. Këtu është dhe fillimi i një mjeti lundrues nënujor që do ta shoqëronte njerëzimin deri në ditët tona. Me kalimin e viteve shtetet që e panë të arsyeshme, si një mjet për forcimin e flotës detare, investuan në krijimin e tyre. Nëndetëset u bënë për herë të parë një faktor kryesor në luftën detare gjatë Luftës së Parë Botërore (1914-1918), kur Gjermania i shfrytëzoi për të shkatërruar anijet tregtare. Në sulme të tilla nëndetëset përdorën armën e tyre kryesore, një raketë nënujore e njohur si silur. Nëndetëset luajtën një rol të ngjashëm në një shkallë më të madhe në Luftën e Dytë Botërore (1939-1945), si në Atlantik (nga Gjermania) ashtu edhe në Paqësor (nga Shtetet e Bashkuara). Në vitet 1960 nëndetësja me energji bërthamore, e aftë të qëndronte nën

63-vite nga krijimi i Brigadës së Nëndetëseve në FD

Fillesa e nëndetëseve të para në botë

ujë për muaj në të njëjtën kohë dhe të gjuante raketa bërthamore me rreze të gjatë pa dalë në sipërfaqe, u bë një platformë e rëndësishme strategjike e armëve. Nëndetësja e sulmit bërthamor është bërë gjithashtu një element kyç i luftës detare. Nëndetëset e mëdha u ndërtuan për t'u përdorur për veprime goditëse në komunikacionet e largëta oqeanike të armikut në bashkëveprim me grupet e anijeve luftarake ose dhe në mënyrë au-

4 nëndetëset e para mbërritën në Flotën Detare Shqiptare dhe pajisja më pas, në fillim të vitit 1960, me 8 nëndetëse të tjera, të tipit Projekti 613 klasi "Whiskey", Flota jonë detare nuk ka pasur më një investim, blerje apo dhurim të nëndetëseve. Emrat e katër nëndetëseve më të rëndësishme ishin "Tufani", "Vetëtima", "Rrufeja" dhe e katërta ajo e famshme, "Nëndetësja 196" ose siç njihet ndryshe "Nëndetësja 105". Personi i cili drejtoi nënde-



tonome. Koha e qëndrimit në det arriti në 100-120 ditë. Shpejtësia maksimale mbi ujë arrinte 15-22 nje, duke luajtur kështu një rol të madh në marinë.

Brigada e nëndetëseve në Shqipëri kremton 63-vjetorin

Ditën e martë, më 21 shtator, Brigada e Nëndetëseve kremtoi 63-vjetorin e krijimit të saj. Që prej shtatorit të vitit 1958, kur

tësen në disa prej misioneve të saj ishte pikërisht komandant Aleko Pojani, një hero i heshtur i flotës detare shqiptare. Ai e ka drejtuar nëndetësen në misionet më të rëndësishme të saj, si në rastin e lëvizjes sekrete që ata realizuan në Mesdhe. Kohë më vonë, në intervistën publikuar në gazetën "Telegraf" "Heroi i heshtur i nëndetëses 105 të bazës

së Pashalimanit, ishte shprehur se vrojtuan kapacitetet e Flotës Detare Italiane dhe asaj Greke. Kishin kaluar rreth tre javë poshtë Mesdheut, 22 ditë pa e parë dritën e diellit, 22 ditë jetë në temperaturat +45 gradë brenda nëndetëses, ditë në të cilat komandanti bashkë me ekuipazhin e tij bënë më të mirën që misioni i tyre të ishte një sukses dhe ashtu rezultoi. Më 4 qershor 1961, pati një përplasje të ashpër, deri në prag të përdorimit të armëve mes ushtarakëve sovjetikë që kërkonin në ikje e sipër, të merrnin me forcë nëndetëset e Pashalimanit, detarëve e epronëve të tyre shqiptarë, këta të fundit të gatshëm për të luftuar për të mbrojtur atë që ishte tyrja. Për vite me radhë këto nëndetëse i shërbyen Flotës në misione të ndryshme, por më 1998, si rezultat i kohës së gjatë të përdorimit, dolën jashtë strukturave luftarake të

bënin motorët e fuqishëm ishte e madhe.

Në një orë, nëndetëset harxhohnin 175 litra karburant, ndërkohë rezerva ishte veçse me 119 tonë karburant. Ishin të gjata 76 metra dhe të gjera 6.3 metra. Pesha e tyre në gjendje për lundrim, shkonte 1045 tonë në ujë, ndërsa kur zhytej, pesha shkonte në 1298 tonë (pasi mbushej me 253 tonë ujë për t'u zhytur). Pesha e një baterie ishte 750 kilogramë dhe mbante gjithsej 224 bateri në 2 dhoma, secila nga 112 bateri. Nën ujë punohej me këto bateri vetëm 1 orë. Periskopi mund të nxirrej jashtë nga thellësia 9.5 metra, përmes një tubo-thithëse. Sistemi me naftë përbëhej nga 2 motorë, shpejtësia arrinte deri në 18 milje detare në orë. Nëndetësja kishte gjithsej 22 bombola ajri, secila me 410 litra ajër që të ngjeshur, si dhe katër rezervë, për të ngarkuar

shqiptarëve në filmin e suksesshëm të asaj kohe "Ballë për ballë", që e bëri atë, "Nëndetësen 105", të pavdekshme në botën e kinematografisë, një film bazuar në veprën "Dimri i Madh" i Kadaresë. Misioni për një kohë kaq të gjatë i nëndetëseve shqiptare përfundoi pa mundur dot më të gjejë rrugën e një fillimi të ri në Flotën Detare Shqiptare.

E ardhmja e nëndetëseve

Ndryshimet në politikën botërore dhe përshtatjet e mëtejshme të teknologjive të detit, tokës dhe hapësirës po krijojnë sfida të reja për nëndetëset në shekullin XXI. Nëndetëset janë efektive në ushtri, sepse lejojnë që në një mënyrë të fshehtë të hysh në ujërat e armikut, për të sulmuar. Por po bëhet gjithnjë e më e vështirë që nëndetëset të fshihen nën oqean pasi, sensorët nënujorë tani mund të kapin shtegun akustik të një nëndetëseje me një lehtësi më të madhe. Sensorët marrin profilin e zërit të pajisjes dhe dërgojnë informacionin në bazat përkatëse.

Zhvillimet nuk ndalen këtu, një klasë e re e nëndetëseve ruse, "Khabarovsk", do të jetë e pajisur për të transportuar një silur gjigant bërthamor autonom, super të shpejtë, "Poseidon", në fakt një dron nënujor me energji bërthamore, i aftë për shpejtësi deri në 180 km/orë. Gama e silurit është praktikisht e pakufizuar dhe është projektuar për të shkatërruar portet apo qytetet bregdetare. Por Rusia nuk është i vetmi vend që po përmirëson nëndetëset e saj. Franca, Britania e Madhe dhe SHBA-ja po zhvillojnë dhe ndërtojnë klasën e radhës të nëndetëseve. Kina dhe India po punojnë gjithashtu mbi planet për të dominuar në det. Ajo që mendohet është se në të ardhmen, disa nëndetëse mund të mos kenë fare ekuipazh, por thjesht teknologji kompjuterike që është e lidhur me satelitët dhe transferon informacion në bazat e largëta ushtarake për analiza.

Nëndetëset nuk janë vetëm mjet kërcënues me të cilin një shtet mund t'i tregojë dhembët shtetit tjetër, në dekadat e fundit janë përdorur shumë shpesh dhe si një mjet kërkimi shkencor. Ato i lejojnë shkencëtarët të udhëtojnë për të parë dhe studiuar jetën e detit. Jo shumë kohë më parë, thellësitë e oqeanëve ishin një mister, por me ndihmën e nëndetëseve shumë pyetje morën përgjigje.

Punoi: Hajrie Dedaj



Forcave Detare, pas një veprimtarie 40-vjeçare. Në vitet e periudhës së komunizmit në Shqipëri ishte shumë e vështirë të merrje një informacion për këto nëndetëse, pasi konsideroheshin sekret ushtarak, gjë që i bëri të paarritshme për shumë dekada. Por pas viteve 1990 marrja e informacionit për to u bë më e lehtë, kështu publiku u njoh me strukturat, hapësirën mënyrën e funksionimit të këtyre përbindëshave nënujorë. Ja si i përshkruan këto "krijesa", lindje e mendjes dhe dorës së njeriut, Edmond Prifti në shkrimin e tij: "Te fshehtat e projektit që solli në Shqipëri nëndetëset ruse":

Mjediset e brendshme dhe hapësirat për të lëvizur ishin tepër të ngushta, ndërkohë që zhurma që

200 atmosferë ajër. Kishte 2 tualete dhe një 1 dush.

Si kapacitet lundruës ato mund të qëndronin 30 ditë nën ujë. Ashtu siç e përmenda dhe më sipër dihet se kanë lundruar 20 ditë rresht, në vitin 1971. Bateritë e nëndetëseve kushtonin shumë, marr shkas nga kjo gjë në 1997 kur vendi ishte duke përjetuar një nga trazirat e tij më të mëdha nëndetëset u vodhën, pajisjet dhe aparaturat, duke u shkatërruar kështu përfundimisht. Ajo që mbeti më pas nga kjo gjendje, në 2011 u dërgua drejt Elbasanit në uzinën e shkrirjes. E vetmja gjë e mbetur nga këto nëndetëse, të cilat për vite me radhë qëndruan në Bazën e Pashalimanit, janë momentet që do të mbesin gjithmonë në kujtesën e

64 vjet... Shërbimi ynë Hidrografik {SHHSH} dhe rëndësia e tij për transportin tonë detar

Intervistë me z. Shefqet Kërçelli, ish-shef i Degës së Bashkepunimit Civilo-Ushtarake në Distriktin Detar, Durrës

INTERVISTOI ANJEZA MUSOLLARI

Tradita e zhvilluar detare dhe rritja e transportit detar, kanë kërkuar dhe përdorimin e mjeteve të sinjalizimit në vendin tonë. Për këtë, në lashtësi detarët tanë përdornin zjarre dhe mjete të thjeshta ndriçuese në vende të dukshme të bregdetit. Në një dokument të hershëm thuhet se, "kur një mjet lundrimi i huaj hynte në Adriatik, skelat e vogla në anë të grykës së Otrantos, ndiznin zjarre në vende më të ngritura për të lajmëruar skelat e tjera më në brëndësi, për rrezikun që afrohej. Duke lajmëruar njëri-tjetrin, jepej kushtrimi nga Karaburuni në Vjosë dhe të gjithë zinin grykën e Otrantos. Kështu veprohej dhe për mjete detar të kohës, të cilat ishin në skela ose lundronin pranë bregut.

Në shekullin e kaluar, numëri i fenerëve ishte i pakët dhe shërbimi i kufizuar. Ata për shkak të teknologjisë dhe mungesës së personelit shpesh fikeshin.

Feneri më i vjetër është ndërtuar në VP të Sazanit më 1871, pastaj në 1884, feneri i Shëngjinit.

Në vitin 1932, u ndërtuan fenerët e hyrjes së portit të Durrësit, i kalasë së Vlorës më 1937, i Cukës dhe Qefalit në Sarandë më 1938 dhe bova ndriçuese e vaporit të



mbytur më 1939.

Në vitet 1945-1946, u rivedosën fenerët detarë me gazometër e karbit në portin e Durrësit dhe më 1947, filloi përdorimi i fenerëve me gaz acetilen, me vezullime.

Në vitin 1948, për mirëmbajtjen e fenerevë u caktua personel i veçantë, u vendosën fenerë me bateri dhe vazhdoi ndërtimi i bazamenteve për ta.

Deri në vitin 1956, u ndërtuan

fenerë të rinj në Karavasta, në portin e Vlorës, në Orikum, Shëngjin, etj.

Ngjarje me rëndësi ishte krijimi i SHHSH më 27 shtator 1957, si strukturë e veçantë për sigurimin hidrolundrimor, brenda Komandës së Flotës Luftarake Detare.

Cilët ishn drejtuesit e parë të saj?

Shefi i parë i këtij shërbimi ishte zoti Arqile Papadhimitri, Koco Lati,

Zv. për punë politike, Mersin Shqy-pi, shef i seksionit të Hidrografisë, Teofik Digli, shef i fenerëve dhe Seit Berisha, shef i sinoptikës.

Mbas këtij organizimi, u intensifikua puna për përmirësimin e teknologjisë së fenerëve. Krahas vënies në punë të fenerëve me gaz acetilen, u rikonstruktuan mjaft prej tyre dhe u pajisën me aparatura të reja. Filloi një epokë e re për SHSH.

Shërbimi Hidrografik Shqiptar SHSH}, është një komponent i rëndësishëm i Forcës Detare dhe aset i vecantë për shtetin shqiptar.

Çfarë roli ka luajtur ky shërbim?

Ai ka një rol të rëndësishëm në sigurimin e kushteve lundrimore dhe të sinjalistikës detare për lundrim të parrezikshëm në hapësirën detare të Republikës së Shqipërisë.

Një hidrografi dhe një sinjalistikë efikase janë domosdoshmëri në zhvillimin e transportit detar, si dhe turizmit në vendin tonë.

Për një vend në zhvillim e sipër që dëshiron uljen e diferencave të krijuara nga një izolim ndër vite, tregtia nëpërmjet detit, është një pjesë e rëndësishme e zhvillimit të vendit për një integrim sa më të shpejtë të tij.

Deti, si një autostradë e asfaltuar, përfaqëson një rrugë komunikimi të gatshme, pa investime infrastrukturale dhe me një impakt ambiental të ulët.

Në këtë drejtim, ky shërbim ka një rol të rëndësishëm, duke bërë të mundur sigurimin hidrolundrimor të bregdetit tonë, nëpërmjet vendosjes së fenerëve detarë e bregdetarë, shenja detare për shfrytëzimin pa rrezik, jo vetëm të bregdetit, por dhe të porteve, bazave, ujërave të brendshme, etj.

SHSH, ka kryer e kryen studime të karakterit hidrografik dhe hidrologjik të bregdetit, relievit dhe fundit të detit, për vendosjen e fenerëve, të shenjave detare dhe të elementëve nënujorë. Në vijimësi, drejton, organizon dhe përpunon botimin e hartave detare, vjetarëve, udhëzuesve të lundrimit dhe të fenerëve, siguron

dhe mban në gatishmëri të plotë sistemin e faro-fenerëve përgjatë gjithë bregdetit të RSH, përpiçon dhe përgatit për botim, duke bashkëpunuar me IGJU si dhe pajis me dokumentacionin e nevojshëm detar të gjitha mjetet lundruese të RSH, bashkëvepron me institucione hidrografike të shteteve të huaja për qëllime studimi apo bashkërendimi të veprimtarive të ndryshme.

Në këtë kuptim SHSH, është jo vetëm një institucion tekniko-shkencor ushtarak, por tepër dobiprurës për transportin detar dhe ekonominë e vendit tonë.

Zhvillimi dhe përmirësimi i tyre teknologjik kaloi në disa etapa.

Cilat ishin ato?

Po, psh. në v. 1958-1960, u ndërtuan kulla fenerësh prej betoni dhe guri me lartësi nga 8 deri 14 m.

Në v. 1958-1961, u vendosën në shtylla metalike [tralice], fenerët e Kepit të Rodonit, të derdhjes së Vjosës e Kepit Shëngjin.

Në v. 1984-1986, u ndërtuan me arkitekturën e kohës, dy kulla të reja fenerësh, më 1985 u bë pajisja e disa fenerëve me aparatura elektronike automatike.

Më 1985, në bregdetin shqiptar numëroheshin 40 fenerë, që mbulonin me rrezet e tyre ujërat tona bregdetare me një brez nga 6 deri 13 milje detare.

Për zbatimin e detyrave të institucioneve përkatëse ndaj sistemit sinjalistik në vendin tonë, ka një VKM, nr 1, datë 9.02.1985. Ku midis të tjerave thuhet se 2% e të ardhurave të taksës së fenerëve i kalon SHSH. Po sa realizohet kjo?

Sistemi i sinjalistikës detare në vitin 2009, pati zhvillimet dhe problematikat e saj ,kush ishin disa prej tyre?

Nga eksperiencia dhe ligjet ndërkombëtare, portet e pa pajisura me sinjalistikë detare janë një "njollë e zezë" në bregdet për lundruesit dhe, si të tilla, nuk mund të njihen nga autoritetet ndërkombëtare si porte të sigurta dhe të përshtatshëm për transport e turizëm.

Ndaj krijimi i standardeve nacionale të sinjalistikës me sim-

bolet dhe ngjyrat e njohura në nivel ndërkombëtar sipas sistemit IALA, përbën një element të rëndësishëm që krijojnë lehtësim dhe mbështetje të nevojshme në zhvillimin e akuaturizmit.

Në bregdetin shqiptar ka gjithsej 64 fenerë, 39 fenerë në tokë, 8 kulla guri/ betoni të një lartësie 6 deri në 14 m, 10 kulla plastike të një lartësie rreth 5 m, 10 tralice të një lartësie deri në 12 m, 4 shtylla hekuri, të një lartësie rreth 7 m, 7 impiante mbi objekte, 25 fenerë në det, 17 bova, 7 meda, 1 platforme.

Sipas zonave.

Shëngjin $2+2+4+1=9$

Durrës $1+5+15+4+1=26$

Vlorë

$3+1+2+2+4+4+2+1+2=22$

Sarandë $1+3+2+1=7$

Ndër vite SHSH ka bashkëpunuar me palën italiane, greke e turke, në fushën e ndërtimit dhe të mirëmbajtjes së sistemit të sinjalistikës detare, po ashtu ka marrëveshje bashkëpunimi me zyrën hidrografike të Mbretërisë së Bashkuar për realizimin e hartave hidrografike|përfshirë dhe ato elektronike|, udhëzues lundrimi dhe produkte të tjera hidrolundrimore, ndërkohë ka paraqitur kërkesën për tu anëtarësuar në Shoqatën Ndërkombëtare të Hidrografisë, [IHO], me qendër në Monako të Francës.

Ngjarje me rëndësi për SHSH ishte vendosja më 25 qershor 2010, e një feneri të fuqishëm në kalanë e Lëkurësit, Sarandë me ndihmën e palës italiane.

Përmirësime në teknologjinë e fenerëve...?

Vitet e fundit me investimet e qeverive shqiptare dhe ndihmën e partnereve janë bërë përmirësime të teknologjisë së fenerëve

Teknologjia e përdorur sot në vendet e zhvilluara është orientuar drejt përdorimit të fenerëve me llampa të tipit LED, që kanë dhe avantazhe të shumta si, kërkesë më të vogël në mirëmbajtje dhe riparime të shpeshta [jetëgjatësi e lartë], tepër ekonomike në energji, më të mbrojtura nga dëmtimet, si dhe pashmëri më të madhe. Llampat LED, vetushqyese nëpërmjet paneleve diellore dhe të pajisura

me sistem telemonitorimi, shihen si e ardhmja e sinjalistikës portuale, ashtu si ato të tipit PEL [Port entry Light, fenerë me drejtim], të cilët janë shumë të rëndësishme për hyrjen në porte, duke eliminuar në këtë mynyrë fenerët me mbulom.

Kjo teknologji ka mundësuar edhe telemonitorimin e bazuar në GSM/GPRS/ UMTS, me dërgimin e një mesazhi ose e-maili me informacionin e nevojshëm për skuadrën e riparimit.

Nevojat për të ecur në të ardhmen... ?

Për të bërë të mundur realizmin e detyrave të shërbimit hidrografik është vlerësuar e nevojshme pajisja me një anije hidrografike e aftë të zgjidhë detyrat e dhëna në kushtet klimaterike të vështira si dhe matjet hidrografike afër dhe larg bregut, psh.

-matjet e zonave të hyrjes së porteve, rreziqeve të ndryshme për lundrim dhe pengesave natyrore.

-matjet meteorologjike-oqeanografike në lidhje me parametrat kimiko-fizike të ujrave në fund të detit.

-integrimin dhe shkëmbimin e të dhënave të mundshme me aktivitetet hidrografike të vendeve fqinj, në stërvitje apo misione të përbashkëta.

Porsa i përket funksionimit hidrografik dhe të kërkimit, është i nevojshëm programimi i mjeteve detare me kapacitete hidrografike të disponueshme për të bërë standardizimin dhe ndërveprimin operacional të mjeteve dhe të personelit, për të mundësuar përdorimin sa më mirë të fondeve dhe uljen e shpenzimeve.

Aktualisht Shërbimi Hidrografik në bashkëpunim me Institutin e Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake prodhon harta detare me standarde ndërkombëtare. Hartat Shqiptare janë në dispozicion të lundëtarëve në formë elektronike. Ky shërbim ofrohet në bashkëpunim me Kompaninë Norvegjeze Primar e cila është kompani lider në këtë fushë dhe mbulon rreth 90% të tregut të hartave detare elektronike.

Zhvillimi i sektorit turistik ndër të tjera kërkon mbështetjen e

lundëtarëve me Shërbime Hidrografike. Dy format më klasike të kontributit të këtij shërbimi për rritjen e sigurisë lundimore në brigjet e Adriatikut dhe Jonit, janë hartat detare si dhe sistemi i sinjalistikës lundimore. Bregdeti Shqiptar po bëhet gjithmonë e më tepër një nga destinacionet më të frekuentuara nga anijet turistike. Për të mbështetur një lundrimin për këtë kategori lundëtarësh, Shërbimi Hidrografik Shqiptar është drejt finalizimit të një marrëveshje me një Kompani të huaj, e cila mundëson mbështetjen e lundrimit me aplikacione lundrimi të thjeshta për tu përdorur.

Që nga viti 2018 në bregdetin shqiptar janë montuar katër sisteme moderne për monitorimin e

Lidhur me ecurinë e këtij shërbimi në vitet e fundit në faqen zyrtare të Shërbimit Hidrografik Norvegjez shkruhet: "Shqipëria përmbush detyrimet e saj ndërkombëtare në përputhje me Kapitullin 5 (Siguria Lundimore), rregulloren Nr.9 (Shërbimi Hidrografik) të Konventës Ndërkombëtare për Sigurinë e Jetës në Det (SOLAS)}.

Nga viti 1957 e aktualisht, drejtues të SHSH kanë qenë, Arqile Papadhimtri, Mersin Shypi, Capajev File, Bashkim Kryeziu, Nikolla Tole, Ilirjan Hoxha, Gëzim Koci, Lulëzim Kryeziu, Blerim Hoxha, Artan Malo, Alfred Velaj dhe Emrush Bejdo. Në këtë sektor të rëndësishëm shërbenin kadro e specialistë të aftë, me



baticë-zbaticës, të cilët kanë një rol kyç në pasqyrimin e të dhënave të sakta në prodhimin e hartave detare. Një nga projektet më ambicioze që po zhvillohet është dhe kompletimi i këtij shërbimi me një anije të re Hidrografike. Në drejtim të hartografisë është në proces dhe do të dalë shumë shpejt harta e gjirin e Porto Romano-s, e cila prodhohet për herë të parë, përditësimi i hartës për portet e Durrësit dhe Vlorës dhe Sarandës.

Sot SHSH mirëmban 74 fenerë, nga të cilët 47 në tokë dhe 27 në det. {bova}.

nivel, profesionistë jo vetëm si detarë, por dhe si inxhinjerë re teknikë. Bazuar në këtë histori të pasur me arritje konkrete në dobi të transportit detar në vendin tonë, arrijmë në konkluzionin se, Shërbimi Hidrografik Shqiptar është një sektor i rëndësishëm i cili përmirësohet cdo ditë për të siguruar lundrimin në ujërat tona.

'Antologjia e Detarisë shqiptare' është një botim brenda të cilit gjendet e plotë puna e kryer nga SHSH, në dobi të transportit të vendit dhe specialistët që kanë shërbyer në këtë shërbim .



Giacobbe: Sovraniteti i Republikës së Kosovës është i pacenueshëm

Ngarkuari me punë në Ambasadën e SHBA-së në Kosovë, Nicholas J. Giacobbe, është prituri në një takim nga presidentja Vjosa Osmani me të cilin diskutuan për zhvillimet e fundit në vend pas vendimit për reciprocitet të targave me Serbinë.

Diplomati amerikan theksoi se për SHBA-të, sovraniteti i Republikës së Kosovës është i pacenueshëm, duke shtuar se dialogu është mënyra e duhur për të vazhduar tutje. Ndërsa, presidentja Osmani akuzoi edhe një herë Serbinë se po tenton ta destabilizojë situatën, në vazhden e përpjekjeve ruso-serbe për zhbërjen e arritjeve të SHBA-së, BE-së, dhe NATO-së në Kosovë dhe rajon.

Në këtë kontekst, Osmani tha se vendimi i institucioneve



të Kosovës për zbatimin e reciprocitetit me targa është i ligjshëm. Ajo vuri theksin te fakti se zbatimi i kësaj mase nga institucionet tona është në përputhje të plotë me marrëveshjen e Brukselit, e cila nuk është zbatuar nga ana e Serbisë.

Presidentja Osmani e bëri të qartë po ashtu që Kosova në asnjë moment nuk ka qëllim të përshkallëzojë situatën. Në veçanti, ajo

potençoi se përkushtimi kryesor i institucioneve të vendit është mirëmbajtja e rendit dhe ligjit si dhe mbrojtja e secilit qytetarë në Republikën tonë. Duke folur për procesin e dialogut, presidentja Osmani konfirmoi se Kosova mbetet e përkushtuar për vazhdimin e tij dhe ritheksoi rëndësinë e trajtimit të barabartë të palëve të përfshira në të.

TAKIMI

Presidentja e Komisionit Evropian (KE), Ursula von der Leyen, takon Osmanin dhe Kurtin

Presidentja e Komisionit Evropian (KE), Ursula von der Leyen, në vazhdim të vizitës në Ballkanin Perëndimor, nga Tirana turin e saj e vazhdoi në Kosovë, ku u takua me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, dhe me kryeministrin Albin Kurti. Në konferencën për media që pati me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, Von der Leyen tha se situata në veri të Kosovës është shqetësuese dhe se të dyja palët, Kosova dhe Serbia, duhet të ulin tensionet dhe t'i rikthehen dialogut. Në anën tjetër pritet të mbahet takimi i radhës mes delegacioneve në Bruksel, ku Kosova do të përfaqësohet



nga zëvendëskryeministri Besnik Bislimi. Në takimin me Komisioneren znj. Ursula von der Leyen, presidentja Osmani do shprehej diskutime të

frytshme për të ardhmen europiane të vendit tonë. Takimi me kryeministrin Kurti u mbajt i mbyllur për mediat.

Simpoziumi i Parë Ndërkombëtar me temën "Teknologjia dhe sfidat për materialet e integruara balistike"

Ministri Mehaj: Ky simpozium ofron mundësi unike për përfaqësuesit e institucioneve të sigurisë në Kosovë

Mbahet Simpoziumi i Parë Ndërkombëtar me temën "Teknologjia dhe sfidat për materialet e integruara balistike", organizuar nga Asociacioni Ndërkombëtar për Operacione të Stabilitetit

Në Prishtinë, nën organizimin e Asociacionit Ndërkombëtar për Operacione të Stabilitetit (ISOA), me seli në Washington, u mbajtë Simpoziumi i Parë Ndërkombëtar me temën "Teknologjia dhe sfidat për materialet e integruara balistike".

Në fjalën e tij të hapjes, Presidenti i ISOA-s për Evropë, Lindje e Mesme dhe Afrikë, z. Mac McClelland, falënderoi Ministrin Mehaj për mundësinë unike për të filluar bashkëpunimin, duke synuar në zgjerimin e këtij bashkëpunimi fillestar në gjithë rajonin.

Ndërkaq, nga ana e tij, Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, në fjalën e tij, theksoi rëndësinë e organizimit të këtij simpoziumi, i pari në një format të tillë, në Kosovë dhe në rajon. Në vazhdim, ai vlerësoi se, simpoziumi i sotëm ofron një mundësi unike për përfaqësuesit e institucioneve të sigurisë në Kosovë, që të mësojnë më shumë rreth teknologjisë dhe të dëgjojnë nga përvojat më të avancuara për materialet e integruara balistike. Gjithashtu, ministri Mehaj, theksoi se, kjo është edhe mundësi për të mësuar më shumë për teknologjitë më të reja, performancën e materialeve mbrojtëse balistike në kushte ekstreme mjedisore, si dhe materialet dhe automjetet e blinduara. "Diskutimet për zhvillimet e ardhshme, metodologjitë e fundit të testimit dhe proceset e matjes së cilësisë për materialet dhe pajisjet e sigurisë, janë mundësi tjetër si dhe vlerë e shtuar e simpoziumit të sotëm" tha ndër tjera ai.

Më tej, Ministri Mehaj paraqiti



perspektivën e Kosovës kundrejt zhvillimeve të fundit ndaj akteve që e sfidojnë demokracinë, prandaj qasja e integruar nga këndvështrimi rajonal është si një përgjigje për të reaguar në mënyrë efektive në secilën situatë. Në mbyllje, Ministri shtoi se përvoja, diskutimet profesionale, njohuritë që ndahen nga ekspertët më të njohur të fushës, janë të një rëndësie të lartë për të pasur një qasje konkrete sa i përket pajisjeve teknologjike dhe materialeve të sofistikuara ushtarake, drejt realizimit të qëllimeve të përbashkëta në çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë, për të krijuar një ambient të sigurt për të gjithë.

Nga panelistët tjerë, simpoziumi i sotëm, po ashtu u vlerësua si një mundësi e shkëlqyeshme për të diskutuar azhurnimet e industrisë dhe sfidat që lidhen edhe për shkak të pandemisë COVID-19.

Misioni dhe angazhimet e Asoc-

acionit Ndërkombëtar të Operacioneve të Stabilitetit (ISOA), konsistojnë në promovimin e standardeve më të larta operationale dhe etike të kompanive aktive në industrinë e operacioneve të paqes dhe stabilitetit si dhe avokimit me politikë-bërësit për kontributin pozitiv të këtyre kompanive në rritjen e paqes ndërkombëtare, zhvillimit dhe sigurisë njerëzore. ISOA angazhohet për ngritjen e standardeve të industrisë së operacioneve të stabilitetit, për të siguruar profesionalizëm dhe transparencë të shëndoshë dhe etike në kryerjen e operacioneve paqeruajtëse, të rindërtimit pas konfliktit dhe të ndihmës në rast të katastrofave.

Ministri Mehaj është ftuar dhe pritët të marrë pjesë në Samitin vjetor të organizuara nga ISOA në muajin e ardhshëm në Washington.



Drejtori i Politikave të Mbrojtjes, Faruk Geci, në takim vjetor të organizatës SHBA-Karta e Adriatikut (A5)

Në kuadër të takimit vjetor dyditor në nivel të drejtorëve të politikave të mbrojtjes, të organizatës SHBA-Karta e Adriatikut (A5), që u organizua në Zagreb, mori pjesë drejtori i Politikave të Mbrojtjes së Ministrisë së Mbrojtjes, Faruk Geci. Përgjatë dy sesioneve, pjesëmarrësit nga vendet anëtare dhe vëzhguese trajtuan misionin në proces të BE-së dhe NATO-s dhe sfidat e integritimit evropian dhe euroatlantik të vendeve të Evropës Juglindore; sfidat e menaxhimit në aspektin diplomatik të pandemisë COVID-19; kërcënimet, rreziqet dhe sfidat hibride në Ballkanin Perëndimor; reflektimin e krizave globale aktuale në rajon si dhe mundësitë për angazhimin e ardhshëm të përbashkët A-5



në misionet dhe operacionet e drejtuara nga NATO. Në ekspozenë e tij, drejtori Geci prezantoi politikat, qëllimet strategjike dhe vizionin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Republikës së Kosovës në përgjithësi lidhur me temat e ngritura, duke shprehur vullnetin dhe gatishmërinë e plotë për ofrimin e kontributit të kapaciteteve institucionale të Republikës së Kosovës në përgjithësi, si dhe Ministrisë së Mbrojtjes në veçanti,

për menaxhimin dhe tejkalimin e përbashkët të të gjitha sfidave rajonale dhe më gjerë. Gjithashtu, Drejtori Geci, duke pasur parasysh stadin e zhvillimit dhe avancimit të kapaciteteve shtetërore dhe institucionale, si dhe interesin e përbashkët rajonal, theksoi edhe njëherë nevojën për pranimin e Republikës së Kosovës si anëtare me status të plotë në këtë organizatë.

Ministri Mehaj priti në takim ambasadorin e Zvicrës në Kosovë, Thomas Kolly

Në vazhden e takimeve të rregullta me ambasadorët e vendeve mike, ministri Mehaj priti në takim ambasadorin e Zvicrës në Kosovë, Thomas Kolly. Në këtë takim u diskutua që përveç bashkëpunimit bilateral në fusha tjera, të vendoset edhe bashkëpunimi në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, me fokus të ofrimit të mbështetjes së forcave të armatosura të Zvicrës në fushat specialistike të tyre. Me këtë rast, amba-



sadori Kolly shprehu interesimin për zhvillimet aktuale në Ministrinë e Mbrojtjes, si dhe rikonfirmoi zotimin se Zvicra do të vazhdojë të përkrahë Qeverinë e Republikës së Kosovës, përveç fushave tjera, edhe në atë të sigurisë dhe mbrojtjes. Nga ana e tij, ministri Mehaj i shprehu falënderimin dhe mirënjohjen e thellë ambasadorit Kolly në angazhimin e tij për intensifikimin e bashkëpunimit të ndërsjellë.

Ministri Mehaj vizitoi Akademinë Ushtarake Mbretërore Sandhurst

Me ftesë zyrtare, Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj udhëtoi për vizitë treditore në Mbretërinë e Bashkuar. Vizita e Ministrit Mehaj në Mbretërinë e Bashkuar është shumë e rëndësishme në procesin e ngritjes së aftësive dhe kapaciteteve operacionale ushtarake të FSK-së dhe dëshmon fuqishëm partneritetin shumë të fortë me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Mbretërisë së Bashkuar që do të intensifikohet edhe më shumë me Memorandumin e ri.

Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, gjatë vizitës së tij që zhvilloi në Mbretërinë e Bashkuar, më 15 shtator, vizitoi Akademinë Ushtarake Mbretërore Sandhurst, e cila është një ndër akademitë ushtarake më të njohura në Botë. Në këtë Qendër, përveç oficerëve të ushtrisë britanike dhe shumë vendeve të botës, studimet i realizojnë edhe oficerët e FSK-së. Me këtë rast, Ministri Mehaj u prit edhe nga komandanti i Akademisë Ushtarake Mbretërore



Sandhurst, gjeneralmajor Duncan Francis Capps. Gjithashtu, gjatë kësaj vizite, ministri takoi edhe studentë-oficerët e FSK-së, të cilët studiojnë aktualisht në këtë Akademi. Ministri Mehaj me këtë rast theksoi se pritja e ngrohtë

Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, gjatë vizitës së tij që zhvilloi në Mbretërinë e Bashkuar, më 15 shtator, vizitoi Akademinë Ushtarake Mbretërore Sandhurst, e cila është një ndër akademitë ushtarake më të njohura në Botë.

miqësore nga gjeneral Capps dhe përshtypjet e ndërsjella mes studentë-oficerëve dhe stafit të Akademisë ishin dëshmi e fuqishme për zgjerimin e mëtejme të bashkëpunimit me akademinë Sandhurst.



Takim Shekerinska-Taner në Austri:

Maqedonia e Veriut ka bërë përparim të madh, të cilin BE duhet ta vlerësojë

Gjatë konferencës së 14 shtatorit, të ministrave të Mbrojtjes të Ballkanit Perëndimor dhe Austrisë, ministrja Radmilla Shekerinska pati një takim joformal me homologen e saj austriake, Claudia Tanner. Takimi u përqendrua në bashkëpunimin në mbrojtje dhe mbështetjen e Austrisë për integrimin evropian të Maqedonisë së Veriut.

“Austria është një nga mbështetësit e zëshëm të rajonit dhe Maqedonisë së Veriut, gjë që është vërtetë për respekt. Dy vendet tona gjithashtu bashkëpunojnë në fushën e mbrojtjes, për të cilën shpresoj se në të ardhmen do të kemi më shumë aktivitete që do të rrisin bashkëpunimin tonë dypalësh. “Është gjë e shkëlqyeshme që Austria vazhdimisht dërgon sinjale inkurajimi në rajon dhe në vendin tonë, për të cilat ne jemi veçanërisht mirënjohës”, -tha Shekerinska.

Ministrja theksoi se mbështetja nga Austria në situatën e zjarreve dhe gjatë pandemisë dha një konfirmim tjetër se të dy vendet mbajnë marrëdhënie të shkëlqyera dhe se Austria vlerëson arritjet e Maqedonisë së Veriut.

Të dy ministret deklaruan se vendi ynë ka bërë përparim, të cilin BE duhet ta vlerësojë duke hapur negociatat për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në BE.

“Austria do të vazhdojë të mbështesë Maqedoninë e Veriut. Kjo është e rëndësishme, jo vetëm për stabilitetin e rajonit, por edhe për të ardhmen e Unionit në përgjithësi. “Marrëdhëniet tona do të vazhdojnë të zhvillohen përmes dialogut dhe mirëkuptimit reciprok”, -tha ministrja Taner. Në konferencën e djeshme të Ministrave të Mbrojtjes të Ballkanit Perëndimor dhe Austrisë, u nënshkrua një Deklaratë e përbashkët për të forcuar rezistencën e vendeve në rajon dhe për të forcuar dialogun strategjik në marrëdhëniet reciproke dhe marrëdhëniet me BE-në, me theks në krijimin e leadershipit rajonal modern. Konferenca u mbajt



në të ashtuquajturin “formatin e Grazit”, të krijuar në takimin në Graz, në vitin 2018 midis vendit tonë, Shqipërisë, Serbisë, Malit të Zi dhe Bosnje-Hercegovinës, si dhe Austrisë në emër të BE-së.

“Pandemia e koronavirusit ka treguar se bota mund të jetë shumë kreative dhe shumë e shpejtë në përshtatjen dhe bashkëpunimin në kohë krize ekzistenciale. Ne kemi nevojë për të njëjtin kreativitet dhe bashkëpunim për të qenë në gjendje të përballojmë sfidat e të ashtuquajturës bota pas COVID-it”, -tha ministrja e Mbrojtjes, Radmilla Shekerinska në datën 7 shtator 2021, në panelin kushtuar sfidave globale dhe rajonale dhe perspektivës për rimëkëmbjen dhe rritjen, e cila ishte pjesë e Konferencës së Parë Vjetore mbi “Rimëkëmbjen dhe Rritjen Ekonomike pas Covid-it”, organizuar nga Ministria e Financave.

Ministrja Shekerinska tha se ky është momenti kur shumica e ekonomistëve dhe politikanëve bien dakord se kthimi në normalitet nuk është një opsion kur bëhet fjalë për politikën shtetërore, politikën në përgjithësi dhe ekonominë në veçanti.

“Ne duhet të krijojmë një botë më të barabartë, të krijojmë një ekonomi e cila do të jetë më pak e varur nga qymyri, të ndërtojmë infrastrukturë moderne, kujdes shëndetësor universal, të krijojmë rregulla të koordinuara për epokën dixhitale dhe, pavarësisht qëllimit tonë kryesor për të luftuar ndryshimet klimatike, ne duhet të planifikojmë se si do të merremi me efektet e ndryshimit të klimës me të cilat tashmë po përballemi, si zjarret dhe përmbytjet. Kjo kërkon një rishikim të përgjithshëm të të gjitha sistemeve tona, duke filluar me sigurinë, por që mbulon shumë fusha të tjera. “Veprimi në mënyrën e vjetër nuk është më një opsion,” -tha ministrja.

“Anëtarësimi në NATO është kurora e 30 viteve tona të pavarësisë”, -tha më 3 shtator ministrja Radmilla Shekerinska në konferencën në Ohër, kushtuar agjendës së NATO 2030 dhe 30-vjetorit të pavarësisë.

Shekerinska u ndal edhe në skepticizmin në disa qarqe, kur 30 vjet më parë Maqedonia në atë kohë shpalli pavarësinë e saj.

“Na u dhanë pak shanse për sukses, vlerësimi kryesor ishte se konfliktet e shumta në të gjithë Jugosllavinë nuk do të na kalonin, dhe ky mund të jetë fundi i vendit. Dhe kjo është arsyeja pse unë mendoj se arritja është më e madhe me të gjitha momentet e gëzimit dhe pikëlinit, sepse në 30 vitet e fundit ne kemi formuar institucione pothuajse nga e para, kemi ndërtuar shtet dhe jemi më të fortë”, -tha ministrja.

Shekerinska tha gjithashtu se anëtarësimi në NATO e forcon atë sovranitet dhe shton ambicien tonë në aspekt të shtetit që duam ta krijojmë.

Sa i përket Afganistanit, ministrja nënvizoi se si vend kemi vendosur të jemi në krah të vlerave demokratike, mbështetjen e normave që ne i konsiderojmë si civilizuese, të cilat prekën veçanërisht gratë dhe fëmijët në Afganistan.

“Ne jemi të gatshëm të soli-

Shekerinska në konferencën e NATO 2030 dhe 30-vjetorin e pavarësisë: Ne ndërtuam një vend me të gjitha atributet që u bë anëtar i NATO-s



darizohemi dhe të pranojmë një numër të caktuar të qytetarëve të evakuuar të Afganistanit, jo për shkak të anëtarësimit tonë në NATO, por edhe sepse kemi qenë atje për një kohë të gjatë, kemi qenë të angazhuar dhe nuk duam ta harrojmë të gjithë këtë në momentin kur ndodh një krizë e vërtetë. “Ne mendojmë se kjo është një situatë që kërkon humanizëm, dhe jo të injorojmë vuajtjet e njerëzve të cilët kanë

ndodhur vetëm dhe do të jenë nën sulmin e qeverisë talebane,” -tha Shekerinska. Konferenca dy-ditore e mbajtur sot dhe nesër në Ohër me pjesëmarrës të shumtë nga jeta politike dhe publike, ekspertë dhe mysafirë të huaj, është një hyrje në festimin e 30-vjetorit të pavarësisë së vendit tonë, e cila do të pasohet nga një sërë ngjarjesh të tjera në periudhën deri në Ditën e Pavarësisë, 8 Shtator.

KONFERENCA “RIMËKËMBJA DHE RITJIA EKONOMIKE PAS COVID-19”

Shekerinska: Të luftojmë pabarazinë dhe korrupsionin dhe të jemi inovativ në politikat tona

Si shembull i ndryshimeve të nevojshme, Shekerinska vuri në dukje subvencionet për ekonominë, të cilat duhet të sigurojnë një dukshmëri më të madhe të prioritetëve tona politike dhe qytetëruese.

“Unë besoj se do të kemi një mundësi të humbur nëse nuk kombinojmë subvencionet e forta që kemi dhënë dhe ua japim kompanive me përgjegjësi më të madhe shoqërore në lidhje me mjedisin, modele më të mira sociale, një sistem që do ta përdorim si pjesë e buxhetit që sërish të rishikojmë sistemet tona tatimore, politikat e të ardhurave dhe politikat që do të çojnë në përmirësimin e standardit,” -tha ministrja Shekerinska.

Anëtarësimi i vendit tonë në NATO, i cili ishte një sukses i madh historik, ishte gjithashtu i mirëpritur për ekonominë, edhe në kohë krize,” -tha ajo, duke shtuar se aty ku duhet të përqendrohemi tani është rritja e rezistencës së shoqërisë.

“Shoqëritë tona përballen me rritjen e liberalizmit, paqëndrueshmërinë e identitetit perëndimor, dhe kjo është arsyeja pse ne duhet t'i bëjmë shoqëritë dhe institucionet më rezistente, sepse përndryshe gjithçka që bëhet në sektorin e mbrojtjes nuk do të jetë e mjaftueshme,” -tha ministrija dhe përmbylli me “po” për të luftuar pabarazinë, “po” për të luftuar korrupsionin, “po” për të analizuar të gjitha rregullat që ishin tipike për sistemin tonë dy vjet më parë. Le të jemi më kreativ dhe të shikojmë fotografinë e madhe gjatë gjithë kohës.

Në diskutim në panel u drejtuan gjithashtu edhe Anna Bjerde, nënkryetare e Bankës Botërore për Evropën dhe Azinë Qendrore, Kate Mary Burns, ambasadorja amerikane, Andrew White nga Universiteti i Oksfordit, Artan Grubi, zëvendëskryeministër, Majlinda Bregu, Sekretare e Përgjithshme e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RSS), si dhe Haoliang Hu i UNDP.

NATO e angazhuar për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare

MSC. MIMOZA GOLIKJA

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg u bashkua me udhëheqësit e tjerë botërorë në hapjen e Sesionit të 76-të të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, më 21 shtator 2021. Asambleja e Përgjithshme e këtij viti shënon të gjashtin sesion që zoti Stoltenberg ka marrë pjesë në krye të Aleancës.

Ndërsa ishte në Nju Jork, Sekretari i Përgjithshëm u takua gjithashtu me Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së, António Guterres, si dhe udhëheqës dhe zyrtarë nga aleatët e NATO-s, përfshirë kryeministrin Spanjoll Pedro Sánchez, ministrin e Jashtëm Italian, Luigi Di Maio, Sekretaren e Jashtëm të Britanisë së Madhe, Liz Truss dhe Këshilltari e Sigurisë Kombëtare amerikane, Jake Sullivan. Ai u takua me udhëheqës dhe zyrtarë të tjerë përfshirë kryeministrin australian Scott Morrison, presidentin kolumbian Iván Duque, presidenten e Ganës Nana Akufo-Addo, presidentin ukrainas Volodymyr Zelenskyy, ministrin e Jashtëm rus Sergey Lavrov dhe presidenten e Kosovës Vjosa Osmani.

NATO dhe Kombet e Bashkuara ndajnë një angazhim për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, dhe të dy organizatat kanë zgjeruar bashkëpunimin gjatë dekadës së fundit. Fushat prioritare për punë të përbashkët përfshijnë mbështetjen e NATO-s për operacionet paqësore të OKB-së, luftimin e terrorizmit, mbrojtjen e

civilëve dhe axhendën e Grave, Paqes dhe Sigurisë. NATO ka kontribuar në zhvillimin e standardeve të OKB-së për të luftuar pajisjet shpërthyesë të improvizuara dhe ka siguruar ekspertë për t'u bashkuar me përpjekjet e OKB-së për trajnimin e personelit paqeruatës. Në vitin 2020, transporti ajror aleat mbështeti Programin Botëror të Ushqimit me dërgimin e një spitali fushor në Gana, si pjesë e përgjigjes ndaj COVID-19.

Sekretari i Përgjithshëm përfundoi vizitën e tij në Shtetet e Bashkuara më 23 shtator, duke marrë pjesë gjithashtu në ndryshimin e Komandës në Komandën Aleate të Transformimit në Norfolk, Virxhinia. Gjenerali Philippe Lavigne i Forcave Ajrore dhe Hapësinore Franceze do të pasojë gjeneralin André Lanata si Komandant Suprem i Aleancës së Transformimit, një nga dy komandantët strategjikë të NATO-s.

Fushat prioritare për punë të përbashkët midis NATO-s dhe OKB-së

NATO dhe Kombet e Bashkuara (OKB) ndajnë një angazhim për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Ato kanë bashkëpunuar në këtë fushë që nga fillimi i viteve 1990, në mbështetje të operacioneve të mbështetjes së paqes dhe menaxhimit të krizave. Kompleksiteti i sfidave të sotme të sigurisë ka kërkuar një dialog më të gjerë midis NATO-s dhe OKB-së. Kjo ka çuar në forcimin e bashkëpunimit dhe aranzhimeve ndërlidhëse midis stafit të dy organizatave, si dhe agjencive të specializuara të OKB-së.

Nga ana tjetër Koncepti Strategjik i NATO-s 2010 angazhon Aleancën për parandalimin e krizave, menaxhimin e konflikteve dhe stabilizimin e situatave pas konfliktit, duke përfshirë bashkëpunimin e ngushtë me OKB-në dhe Bashkimin Evropian (BE) përmes një "qasjeje gjithëpërfshirëse" për menaxhimin dhe operacionet e krizave.

Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së kanë dhënë mandatin për operacionet e NATO-s në BP, Afganistan dhe Libi, si dhe për misionin e parë stërvitor të NATO-s në Irak. Në shtator 2008, bazuar në përvojën e mbi një dekade të punës së bashku, Sekretarët e Përgjithshëm të NATO-s dhe Kombeve të Bashkuara (OKB) ranë dakord të krijojnë një kornizë për konsultime dhe bashkëpunim të zgjeruar. Që nga nënshkrimi i kuadrit të vitit 2008, bashkëpunimi ka vazhduar të zhvillohet në mënyrë praktike, duke marrë parasysh mandatin, ekspertizën, procedurat dhe aftësitë specifike të secilës organizatë. Shkëmbimet e rregullta dhe dialogu në nivelet e larta dhe të punës mbi çështjet politike dhe operacionale janë bërë një tipar standard i marrëdhënieve ndërinsticionale. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s i raporton rregullisht Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së mbi përparimin në operacionet e udhëhequra nga NATO të mandatuara nga OKB dhe mbi vendimet e tjera kryesore të Këshillit të Atlantikut të Veriut, përfshirë në fushën e menaxhimit të krizave dhe në luftën kundër terrorizmit. OKB-ja shpesh ftohet të marrë pjesë në takimet dhe samitet ministrorë të NATO-s; Sekretari i

Përgjithshëm i NATO-s merr pjesë në Asambleshën e Përgjithshme të OKB-së; dhe takimet në nivel stafi, që mbulojnë gamën e gjerë të bashkëpunimit dhe dialogut, zhvillohen në baza vjetore midis sekretariateve të NATO-s dhe OKB-së. Në vitin 2018, Sekretarët e Përgjithshëm ranë dakord të rinovojnë këtë angazhim për zgjerimin e bashkëpunimit dhe dialogut në fushat me interes të përbashkët, përfshirë edhe luftimin e kërcënimit të paraqitur nga mjetet shpërthyesë të improvizuara; ngritja e kapaciteteve dhe reformat në sektorin e mbrojtjes; mbrojtjen e civilëve; fëmijët dhe konflikti i armatosur; Gratë, Paqja dhe Siguria; agjenda e Rinisë, Paqes dhe Sigurisë; dhe mbrojtjen kibernetike. Kurse në vitin 2010, NATO përforcoi aranzhimet ekzistuese të ndërlidhjes duke vendosur postin e Oficerit Ndërlidhës Civil të NATO-s në Kombet e Bashkuara, përveç atij të një Oficeri Ndërlidhës Ushtarak, të krijuar në 1999.

Cilat janë fushat kryesore të bashkëpunimit

Operacionet e paqes: Aftësitë dhe përvoja unike e NATO-s mund të jenë një burim i vlefshëm mbështetjeje për OKB-në, paqeruajtësit e së cilës veprojnë në mjedise gjithnjë e më sfiduese dhe të rrezikshme. Stafi i NATO-s dhe OKB-së kanë punuar për të ndërtuar bashkëpunim praktik në këtë fushë. Në Samitin e liderëve të vitit 2015 mbi Ruajtjen e Paqes, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s u zotua të rrisë mbështetjen për OKB-në, veçanërisht në fushat e luftimit të mjeteve shpërthyesë të improvizuara (IED), trajnimit dhe gatishmërisë, duke mbështetur përpjekjet e OKB-së për t'u vendosur më shpejt dhe duke punuar më shumë ngushtë për ngritjen e kapaciteteve në vendet në rrezik, si me OKB-në ashtu edhe me BE-në. Në vitin 2020, NATO nisi një iniciativë për ngritjen e kapaciteteve mbrojtëse, e cila ofron ekspertizë aleate për mbështetjen e trajnimit të paqeruajtësve në fusha të ndryshme, duke përfshirë kundërvënien ndaj IED-ve, kujdesit mjekësor, TIK/komunikimit dhe vlerësimin e performancës. Paketa synon të forcojë aftësinë e OKB-së për të ngritur dhe mbështetur operacionet paqeruajtëse duke rritur per-

formancën operacionale, sigurinë dhe sigurinë e paqeruajtësve të OKB-së. Ndërsa OKB-ja reformon qasjen e saj ndaj operacioneve paqësore, NATO do të vazhdojë të kërkojë se ku mund të bëjë ndryshim mbështetja e saj.

Kundër terrorizmit: Strategjia Globale Kundër Terrorizmit e OKB-së, konventat dhe protokollet ndërkombëtare kundër terrorizmit, së bashku me Rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të OKB-së sigurojnë kuadrin për përpjekjet e NATO-s për të luftuar terrorizmin. NATO punon ngushtë në nivelet e stafit dhe komiteteve me Komitetin e OKB-së kundër Terrorizmit (OKB CTC) dhe Drejtorinë e tij Ekzekutive, si dhe me Task Forcën e zbatimit të Antiterrorizmit dhe shumë organizata përbërëse të tij. Dega e Parandalimit të Terrorizmit e Organi-



zatës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin është gjithashtu një partner i rëndësishëm për NATO-n.

Mos-përhapja: NATO po punon ngushtë me OKB-në dhe organizatat e tjera ndërkombëtare për të luftuar përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë (WMD) dhe për të mbrojtur kundër kërcënimeve kimike, biologjike, radiologjike dhe bërthamore. Gjithashtu NATO kontribuon në punën e Komitetit të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, të krijuar pas miratimit të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (UNSCR) 1540 (2004), e cila adreson kërcënimin për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare të paraqitur nga përhapja e armëve bërthamore, kimike dhe biologjike dhe mjetet e tyre të dorëzimit. Që nga viti 2004, Aleanca ka organizuar Konfer-

encën Vjetore mbi Armët e Shkatërrimit në Masë (WMD), Kontrollin e Armëve, Çarmatimin dhe Mos-Përhapjen me pjesëmarrjen aktive të vendeve partnere dhe organizatave ndërkombëtare. Aktiviteti i fundit i mbajtur në nëntor 2020 dhe i ndjekur nga Nën-Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së dhe Përfaqësuesi i Lartë për Çështjet e Çarmatimit, Izumi Nakamitsu, eksplori se si aleatët dhe partnerët e NATO-s mund të mbështesin dhe forcojnë Traktatin e Mospërhapjes (NPT), veçanërisht në funksion të tij. NATO gjithashtu ka adresuar zbatimin e Rezolutës së Kombeve të Bashkuara 1540 në nivelet rajonale dhe nën-rajonale, përfshirë përmes Programit të saj Shkenca për Paqen dhe Sigurinë, dhe "do të vazhdojë të trajtojë nevojën për ndihmë të vendeve partnere sipas

kërkesës."

Gratë, Paqja dhe Siguria: NATO mbetet e angazhuar në zbatimin e plotë të Rezolutës 1325 të OKB-së për Gratë, Paqen dhe Sigurinë dhe Rezolutat e ndërlidhura, të cilat synojnë të promovojnë të drejtat e grave, të rrisin pjesëmarrjen e grave në parandalimin dhe përfundimin e konflikteve dhe të mbrojnë gratë dhe vajzat nga dhuna seksuale e lidhur me konfliktin. Në përputhje me politikën e zhvilluar nga aleatët e NATO-s, së bashku me partnerët në Këshillin e Partneritetit Euro-Atlantik (EAPC), është bërë përparim i rëndësishëm në zbatimin e qëllimeve të përcaktuara në këto Rezoluta. Përfaqësuesja Speciale e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s për Gratë, Paqen dhe Sigurinë i drejtohet rregullisht Këshillit të Sigurimit

të OKB-së me rastin e Debatit të Hapur mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë, dhe mbi dhunën seksuale të lidhur me konfliktin, duke theksuar punën e ndërmarrë nga NATO për zbatimin e rezolutave. Nga ana tjetër, duke u bazuar në kuadrin e Rezolutës 1325 të KS të OKB-së, NATO rishikoi politikën e saj për Gratë, Paqen dhe Sigurinë në vitin 2018, duke prezantuar parimet e politikave të integritetit, gjithë përfshirjes dhe integritetit. NATO është angazhuar rregullisht me OKB-në në një numër nismash, përfshirë Politikën e parë të NATO-s për Parandalimin dhe Përgjigjen ndaj Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual, e cila u miratua nga Udhëheqësit e NATO-s në Samitin e Brukselit në 2021. Të dy organizatat gjithashtu kanë bashkuar përpjekjet për të hartuar Politikën e NATO-s për Luftimin e Dhunës Seksuale të Konfliktuar, për të mbështetur mësimet e nxjerra dhe praktikën e mira dhe për të promovuar zhvillimin e planeve kombëtare të veprimit për vendet anëtare të NATO-s.

Mbrojtja e fëmijëve në konflikte të armatosura: NATO është e angazhuar për zbatimin e Rezolutës 1612 të KS të OKB-së dhe Rezolutave të ndërlidhura për mbrojtjen e fëmijëve të prekur nga konflikti i armatosur. Në Samitin e NATO-s në 2014 në Uells, Udhëheqësit e NATO-s vendosën se mund të bëhej më shumë për të siguruar që Aleanca të jetë e përgatitur sa duhet kurdo dhe kudo që çështja e Fëmijëve dhe Konfliktëve të Armatosura ka të ngjarë të haset. Rezultati ishte dokumenti i politikave të NATO-s, "Mbrojtja e fëmijëve në konfliktet e armatosura - Rruga përpara". E përgatitur në bashkëpunim me OKB-në, politika synon të thellojë zbatimin e Rezolutës 1612 të OKB-së në operacionet dhe misionet e NATO-s. Këto përpjekje përfshijnë trajnimin e trupave të dislokuara të Aleancës për të njohur, monitoruar dhe raportuar shkeljet kundër fëmijëve dhe për të përfshirë çështjet e mbrojtjes së fëmijëve në skenarët e stërvitjeve të NATO-s. Kur ftohet të trajnojnë forcat lokale, NATO thekson gjithashtu rëndësinë e mbrojtjes së fëmijëve në konfliktet e armatosura.

Armë të vogla dhe të lehta: NATO mbështet zbatimin e Programit të Kombeve të Bashkuara për Veprim

për Parandalimin, Luftimin dhe Çrënjosjen e Tregtisë Ilegale të Armëve të Vogla dhe të Lehta (SALW), miratuar në korrik 2001 nga gati 150 vende, përfshirë të gjitha shtetet anëtare të NATO-s. Aleanca gjithashtu merr pjesë në takimet e ekspertëve të OKB-së dhe konferencat e rishikimit. Grupi i Punës i NATO/EAPC Ad Hoc për SALW dhe Veprimin ndaj Minave siguron një forum kryesor për shkëmbimin e informacionit me organizata të tilla si OKB, për të rritur koordinimin dhe për të shmangur dyfishimin e punës. Gjithashtu Mekanizmi i Fondit të Mirëbesimit të NATO-s u krijua në 1999 për të mbështetur vendet partnere në zbatimin e dispozitave të Konventës së Otavës (e njohur edhe si Konventa e Ndalimit të Minave kundër Personelit) dhe tani shtrihet në zonat përfshirë deponimin e municioneve, armëve të vogla dhe reformën e mbrojtjes. Për më tepër, NATO mbështet kombet në zbatimin e Traktatit të Tregtisë së Armëve që hyri në fuqi në dhjetor 2014 përmes trajnimit dhe zbatimit të standardeve. Por NATO ka punuar ngushtë edhe me agjencitë e OKB-së për të zhvilluar standardet ndërkombëtare për menaxhimin e ciklit jetësor të municioneve, siç janë Udhëzimet Teknike Ndërkombëtare të Municioneve. NATO ka publikuar udhëzime mbi integrimin gjinor në fushën e SALW, bazuar në standardet e zhvilluara nga OKB sipas Stan-

dardeve Ndërkombëtare të Kontrollit të Armëve të Vogla dhe Rezolutës 1325 të OKB-së. Aleanca gjithashtu përpjeket të mbështesë përpjekjet rajonale dhe nën-rajonale me OKB-në dhe partnerët përtej EAPC zona në menaxhimin e AVL -ve, municionit dhe mbetjeve shpërthyes të luftës. Në këtë kontekst, NATO zhvilloi disa kapacitete përmes Programit të saj Shkenca për Paqen dhe Sigurinë.

Ndihmave në raste fatkeqësish: NATO gjithashtu bashkëpunon me OKB-në në mbështetje të operacioneve të ndihmës nga fatkeqësitë. Përmes Qendrës Euro-Atlantike të Koordinimit të Reagimit ndaj Fatkeqësive (EADRCC), NATO koordinon përpjekjet për menaxhimin e pasojave me OKB-në dhe organet e tjera dhe ndan informacion mbi ndihmën ndaj katastrofave. Të gjitha detyrat e EADRCC kryhen në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e OKB-së për Koordinimin e Çështjeve Humanitare (OKB OCHA), e cila ruan rolin parësor në koordinimin e operacioneve ndërkombëtare të ndihmës nga fatkeqësitë. EADRCC është një mekanizëm koordinues rajonal, që mbështet dhe plotëson përpjekjet e OKB-së. Në rast të një fatkeqësie që kërkon ndihmë ndërkombëtare, i takon vendeve anëtare të NATO-s dhe vendeve partnere të vendosin nëse do të ofrojnë ndihmë, bazuar në informacionin e marrë nga EADRCC.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s mirëpret bashkëpunimin me Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë

Sekretari i Përgjithshëm i NATO -s Jens Stoltenberg, më 28 shtator 2021 priti Drejtorin Ekzekutiv të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë (IEA) Dr Fatih Birol në Selinë e NATO -s, për të diskutuar tema me interes reciprok për të dyja organizatat. Këto tema përfshinin ndryshimin dhe sigurinë klimatike, sigurinë e energjisë dhe tranzicionin e energjisë së pastër, si dhe forcimin e bashkëpunimit midis NATO-s dhe IEA.

Këtë vit, si NATO ashtu edhe IEA kanë ndërmarrë hapa të mëdhenj për të adresuar ndryshimet klimatike. Në Samitin e Aleancës në qershor, udhëheqësit e NATO -s ranë dakord për Planin e parë të Veprimit të Aleancës për Ndryshimin e Klimës dhe Sigurinë, përfshirë ndryshimet klimatike në spektrin e plotë të punës së NATO-s. Në të njëjtën kohë, IEA mori orientimin në drejtimin e rrugës përpara në politikën e energjisë, të cilat mund të çojnë në emetime zero të karbonit.

Sekretari i Përgjithshëm përshëndeti rritjen e bashkëpunimit midis NATO-s dhe IEA. Kalimi global drejt energjisë së pastër i bën lidhjet më të ngushta edhe më të rëndësishme.

Ndryshohet Komanda Aleate e Transformimit në Norfolk, Virxhinia në SHBA

MSC. MIMOZA GOLIKJA

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg mori pjesë në Ndryshimin e Komandës në Komandën Aleate të Transformimit në Shtetet e Bashkuara më 23 shtator 2021. Në ceremoninë e zhvilluar në Norfolk, Virxhinia, gjenerali Philippe Lavigne i Forcave Ajrore dhe Hapësinore Franceze mori detyrën si Komandant Suprem i Komandës Aleate të Transformimit, një nga dy komandantët strategjikë të NATO-s. Detyra u dorëzua nga gjenerali francez André Lanata.

Komandanti Suprem i Transformimit Aleat udhëheq transformimin e strukturave, forcave, aftësive dhe doktrinave ushtarake të NATO-s në mënyrë që të përmirësojë efektivitetin ushtarak të Aleancës dhe u bën rekomandime autoriteteve politike dhe ushtarake të NATO-s.

Sekretari i Përgjithshëm tha se: "Franca është një aleate e fortë dhe shumë e vlerësuar e NATO-s, me aftësi të përparuara dhe forca shumë profesionale. Për më shumë se një dekadë, Franca ka emëruar oficerët e saj më të mirë që kanë marrë këtë komandë". Ai vlerësoi gjeneralin Lanata dhe gjeneralin Lavigne si "udhëheqës të mëdhenj të përkushtuar ndaj Aleancës sonë transatlantike". Zoti Stoltenberg theksoi punën e rëndësishme të Komandës Aleate të Transformimit në ndihmën për të përshtatur NATO-n me sfidat dhe teknologjitë e reja shkatërruese. "Që NATO të jetë provë

e së ardhmes, ne duhet të vazhdojmë me ritmin e shpejtë të ndryshimit teknologjik. Përshpejtoni inovacionin, në mënyrë që të mbetemi konkurrues dhe të ruajmë avantazhin tonë.", -tha ai.

Në njohje të kontributit të gjeneral Lanata në Aleancë, Sekretari i Përgjithshëm i dhuroi atij Medaljen e Shërbimit Meritor të NATO-s.

Dy gjeneralët francezë, ceremonia dhe sfidat e reja të NATO-s

"Eshtë vërtetë një kënaqësi e madhe për mua të kthehem në Norfolk dhe më vjen mirë që të gjithë mund të mbliidemi këtu, për të nderuar dy burra, të cilët nuk janë vetëm pilotë dhe komandantë me përvojë, por edhe udhëheqës të mëdhenj të përkushtuar ndaj Aleancës sonë transatlantike", -tha Jens Stoltenberg në fjalën e tij në ceremoninë e ndryshimit të Komandës në Komandën Aleate të Transformimit në Norfolk, Virxhinia, SHBA. Duke ju drejtuar dy gjeneralëve francezë, gjeneral Lanata dhe gjeneral Lavigne, Stoltenberg tha se: "Franca është një aleate e fortë dhe shumë e vlerësuar e NATO-s, me aftësi të përparuara dhe forca shumë profesionale" dhe se për më shumë se një dekadë, "Franca ka emëruar oficerët e saj më të mirë" për të marrë këtë komandë. "Gjeneral Lavigne, ju jeni pjesë e asaj tradite të shkëlqyer, ju filluat karrierën tuaj si pilot luftarak, në misionë luftarake fluturuese në ish Republikën e Jugosllavisë dhe Irakut, kontribuat me përvojën tuaj dhe ekspertizën tuaj për të trajnuar

dhe mësuar shokët dhe pilotët për të ndihmuar në planifikimin dhe kryerjen e operacioneve, veçanërisht në Haiti, dhe në Azinë Jugore pas cunamit. Ju keni qenë gjithashtu në Afganistan, ku keni komanduar aeroportin në Kabul", -tha Stoltenberg në vlerësim të gjeneralit Lavigne i cili vjen në krye të ACT me një karrierë të jashtëzakonshme edhe si Shef i Shtabit të Forcave Ajrore dhe Hapësinore të Francës. "Përvoja dhe profesionalizmi juaj ju bëjnë personin e përsosur për të marrë përsipër detyrën e Komandantit Suprem të Aleancës së Transformimit", -tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s. "Ju bashkoheni në një moment vendimtar për Aleancën tonë, ndërsa ne tani po përgatitim NATO-n për dekadën e ardhshme dhe më gjerë", -tha Jens Stoltenberg duke uruar në emër të të gjithëve në NATO një mirëseardhje të ngrohtë. "Mezi pres të punoj me ju!", -tha ai. Duke vlerësuar stafin e ACT, Stoltenberg i tha gjeneralit se ai ishte i sigurtë që shpejt do të zbulonte ngrohtësinë dhe miqësinë e jashtëzakonshme të komunitetit lokal në Norfolk. "Njerëzit këtu kanë mirëpritur dhe mbështetur burrat dhe gratë e NATO-s për shumë dekada dhe do të doja t'i falënderoja për gjithçka që bëjnë për ata që janë vendosur këtu, pavarësisht se nga janë, njerëzit e Norfolk e bëjnë këtë të ndjehen si në shtëpi".

Në Samitin e NATO-s në qershor, "udhëheqësit tanë ranë dakord me NATO 2030, një axhendë ambicioze për sigurinë tonë të ardhshme, një e ardhme që tashmë është formuar nga njeriu të cilit i themi lamtumirë



sot, mikut tonë të mirë, gjeneral Lanata. Që NATO të jetë dëshmi e së ardhmes, ne duhet të vazhdojmë me ritmin e shpejtë të ndryshimit teknologjik, përshejtimin e inovacionit, në mënyrë që të mbetemi konkurrues dhe të ruajmë avantazhin tonë”, -tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, në vlerësimin e gjeneralit Lanata. Jens Stoltenberg nënvizoi gjithashtu kontributin domethënës të gjeneralit Lanata në zhvillimin e konceptit të gurthemelit të luftës të NATO-s, e cila do të udhëheqë zhvillimin e aftësive të Aleancës deri në vitin 2040. “Puna juaj ka lënë gjurmë në këtë Aleancë dhe kjo punë do të çohet përpara nga pasardhësi juaj, ndërsa ne vazhdojmë të përshtatemi. André, kur të kthehesh në Francë, e di që do të të mungojnë miqtë e shumtë që ke bërë këtu në ACT. Por dijeni që atyre do ju mungoni ju po aq shumë. Ata do të kujtojnë vizionin tuaj të jashtëzakonshëm, veçanërisht në lidhje me zhvillimin e aftësive. Ata do të kujtojnë krenarinë dhe pasionin tuaj për ishullin tuaj të lindjes të Korsikës”, - tha Stoltenberg. “Gjeneral Lanata, ka qenë privilegj i NATO-s që ju shërbyet si Komandant Suprem i Aleancës së Transformimit”, - falënderoi Sekretari i Përgjithshëm në emër të të gjithë aleatëve dhe të gjithë shtabeve të NATO-s, komandantin në largim të ACT-së, për kontributin e jashtëzakonshëm në Aleancën, duke e nderuar atë me Medaljen e Shërbimit të

Merituar të NATO-s.

ACT përcakton kontekstin e ardhshëm ushtarak

Konfliktet e së nesërme nuk mund të fitohen me aftësitë, proceset, teknologjinë e sotme ose të djeshme. Komanda e Transformimit të Komandës Aleate (ACT), është ajo që përcakton kontekstin e ardhshëm ushtarak, duke identifikuar sfidat dhe mundësitë në mënyrë që të përtërijmë dhe mbajmë avantazhin e luftës. ACT siguron ndërveprim maksimal; u jep strukturë dhe përparësi forcave të NATO-s përmes planifikimit të mbrojtjes dhe zhvillimit të aftësive; zbaton novacionin për të shfrytëzuar idetë, procedurat dhe teknologjitë në dobi të zhvillimit të luftës së NATO-s; dhe, në të gjitha këto, shfrytëzon fuqinë intelektuale të një rrjeti të madh të industrisë, akademisë, ekspertizës ushtarake dhe civile në kombe, në agjencitë e NATO-s dhe Qendrat e Përsosmërisë të NATO-s.

ACT është një nga dy Komandat Strategjike në krye të strukturës komanduese ushtarake të NATO-s. Tjetra, Operacionet e Komandës Aleate (ACO), e cila është përgjegjëse për planifikimin dhe ekzekutimin e të gjitha operacioneve ushtarake të NATO-s. ACT drejton përshtatjen ushtarake të Aleancës, duke koordinuar përpjekjet kombëtare për të siguruar koherencën dhe ndërveprimin, për tu

siguruar që NATO ka Instrumentin e duhur Ushtarak të Fuqisë për të ndihmuar në garantimin e lirisë dhe sigurisë së anëtarëve të saj. ACT përmirëson gatishmërinë dhe besueshmërinë e qëndrimit të NATO-s dhe ndihmon Strukturën e Komandës së NATO -s (NCS) për të komanduar, kontrolluar dhe mbështetur në mënyrë efikase operacionet ushtarake aktuale dhe të ardhshme, duke siguruar një kalim të sigurt dhe të qëndrueshëm ndaj krizave dhe konflikteve, nëse është e nevojshme. ACT drejtohet nga Komandanti Suprem Aleat i Transformimit (SACT), i cili ushtron përgjegjësitë e tij nga selia në Norfolk, Virginia, Shtetet e Bashkuara. Dhe ndërkohë SACT është përgjegjës para Komitetit Ushtarak për transformimin dhe zhvillimin e Aleancës për të siguruar që është e aftë të përballojë sfidat e sotme dhe të nesërme. Komiteti Ushtarak është autoriteti i lartë ushtarak në NATO dhe është nën autoritetin e përgjithshëm politik të Këshillit të Atlantikut të Veriut. Kjo Komandë Strategjike drejton Komanda të ndryshme vartëse të Përbashkëta dhe ka lidhje të forta me objektet e arsimit dhe trajnimit, si dhe me Ministrinë e Mbrojtjes. ACT është gjithashtu e lidhur ngushtë me Strukturën e Forcave të NATO -s (NFS) në përgjithësi, e cila përbëhet nga forca të vendosura në dispozicion të Aleancës nga vendet anëtare, së bashku me strukturat e tyre komanduese dhe të kontrollit.


Ushtarak, poet dhe personalitet i Labërisë

PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

Zequir Cama – ushtaraku poet dhe tregimtar lab

Zequir Cama është lindur në prill të vitit 1949 në Fushëbardhë. Arsimimin fillor e ka kryer në Fushëvërrin dhe Fushëbardhë ndërsa shtatëvjeçar në Zhulat. Në vitet 1963-1967, ka kryer Teknikumi veterinar në Shkodër, ndërsa gjatë viteve 1967-1969, kreu Shkollën e lartë ushtarake të aviacionit, në Vlorë, në specialitetin “armatim aviacioni”. Në vitet 1973-1977 kryen studimet pa shkëputje nga puna në Fakultetin Gjuhë-Letërsi në Universitetin Shtetëror të Tiranës. Ka shërbyer si oficer nga 29.11.1969, deri në Janar 1995, dhe nga prill 1998 deri në Janar 2007, pra rreth 34 vjet. Më 4.4.2004 u krijuar SHKA “Fushëbardha”, e cila krijoi dhe gazetën e saj. Zequir Cama pjesë e grupit themelues me dëshirë mori përsipër përgatitjen e gazetës “Fushëbardha”, organ i SHKA “Fushëbardha”. Dallgët e jetës e çuan larg në emigracionin përtej Atlantikut. Kështu në Prill të 2008, 59 vjeçar, emigroi familjarisht në Kanada, ku punoi në një kompani ushqimore për dhjetë vjet, 2008-2018. Aktualisht pensionist, që këtë periudhë e ka ndarë midis Kanadasë dhe mëmëdheut Shqipërisë. Emri “pensionist” nuk përputhet me vetitë energjite dhe freskinë njerëzore dhe freskinë në krijimtari të Zeqir Camës. Pasioni për krijimtarinë artistike e ka shoqëruar përgjatë gjithë jetës. Poetët nuk janë mbretër, por mbahen dhe mbeten në kujtesën e brezave sikur të ishin mbretër. I tillë është mesazhi që përcjell poezia dhe proza, forca e fjalës. Për Zeqirin, Fushëbardha dhe Labëria janë truallit ku lindi poezia e tij, ishte burimi i parë i frymëzimit dhe muzës poetike. Bujarinë e peizazhit poetik Zeqiri e gjeti në jetën njerëzore

Për ish-ushtarakun, poetin dhe shkrimtarin e spikatur, gdhendësin e poezive, poemave e tregimit Zeqir Cama, i cili ka krijuar fizionominë e tij artistike të letrave të ngritur kryesisht mbi realitetin lab dhe jo vetëm, hartuesit të qindra biografive në gjerdanin e “Yjeve të pushuar” të LANÇ-it, aristokratit të fjalës së përzgjedhur të dhjetra personazheve pilotë ushtarakë, që fluturuan mbi qiejt e Shqipërisë dhe shkruan histori trimërie në roje të kaltërsive të At-dheut; në kuadrin e vlerësimit me titullin e lartë “Personalitet i shquar i Labërisë” nga SHKA “Labëria”, “Nderi i kombit”. Zeqir Sadik Cama ka kryer arsimin e lartë ushtarak dhe më pas Fakultetin Gjuhë-Letërsi në Universitetin e Tiranës. Ai bën pjesë në grupin e krijuesve letrarë që për vite të tëra kontribuan si ushtarakë profesionistë në Komandën e Forcës Ajrore në Rinas, në Ministri të Mbrojtjes, në organet e shtypit dhe propagandës, në stafin e hartimit të serisë së veprave për dëshmorët e At-dheut “Yje të pushuar”. Ai ka lëvruar poezinë dhe prozën e shkurtër, por dhe monografinë; librin e parë me poezi me titull “Shtigje të gurta” (1972), ndërsa përmbledhja e fundit e krijimeve të tij letrare titullohet “Ftesë nga Fushëbardha”, edhe pse gjithmonë ka në dorë krijimtari të spikatur që nuk rresht asnjëherë sikurse është libri “Kronikë në aerodrom” me tregime nga jeta në Bazat Ajrore Ushtarake të vendit.



në natyrën e ashpër, por të dashur me male, kodrina, lëndina, burime, korigje, fëshërimë ere, me katër stinë të veçanta dhe të dashura për krijimtarinë poetike. Vetë jeta e Labërisë ka qenë një burim i fuqishëm i muzës poetike të poetëve e shkrimtarëve të Labërisë, ku një prej tyre padyshim i spikatur është Zeqir Cama. Aktivitetin letrar e ka nisur në shkollën

e mesme në Shkodër, sepse Shkodra i ofronte të tëra, edhe pse delli poetik rrinte i fshehur në damarët e poetit. Fakt është se krijimtaria merr vlerë kur bëhet pronë e të gjithëve dhe shikon dritën e botimit dhe dritën e botimeve në të gjitha organet e shtypit, për Zeqo Camën ishte çelur që në vitin 1967, në moshën 18 vjeçare. Të publikojë në Revistën “Nën-

tori” (“Në udhën tuaj”, poemë sintezë për nënat labe dhe “Dritë e pleqërisë së bardhë”), në gazetën “Zëri i Popullit”, (nëntor 1971) gazetën, që botonte shumë rrallë poema, që u kushtojë komisarëve. Poema “Komisarët..” bëri kureshtar dhe zv/kryeministrin e kohës burrin e urtë të Fushëbardhës Adil Çarçani, që kishte qenë edhe vet komisar. Ndërkohë Zeqirit krijimtaria e tij e bëri të njohur. Kështu Ai vetë e çeli rrugën për vijimin e studimeve në degën Gjuhë Letërsi në Universitetin e Tiranës. Viti 1972, nis me botimin e vëllimit poetik “Shtigje të gurta”, të Labërisë, që në fakt ishte një monument poetik për Labërinë e më gjerë.

Në udhën e krijimtarisë së begatë artistike: poet e tregimtar i besueshëm

Krijimtaria poetike e Zeqirit kishte fituar individualitetin e tij dhe ishte bërë e njohur dhe e konfirmuar edhe në qarqet e larta të poetëve dhe të shkrimtarëve. Edhe pse ishte në Tiranë fshati Fushëbardhë ngelej fshat i ëndërrave në krijimtarinë poetike. Treva labe ishte bërë ëndërra të pafundme për vende të bukura, të ashpra dhe të shenjtëruara që vinin tek poeti krejt natyrshëm. Udhëtimi poetik në dy dekada njohi vetëm rritje, fitoi mjaft çmime poetike në rang kombëtar për “Netë aerodromesh”, “Shkallët e Labërisë”, për skenarin filmik me metrazh të gjatë nga jeta në aviacion “Shqiponjat marrin lartësi”. Botoi “Udhë e rritjes” dhe më tej në të gjitha organet e kohës veçanërisht në ato të shtypit ushtarak, publicistikë si një emër shumë i njohur, i përfshirë edhe në grupin e shkrimtarëve për Heronjtë e luftës Nacionalçlirimtare; shkroi librin “Endërra që çelën nga lufta” për heroinën e popullit, pionieren Nimete Progonati; më 2006, botoi biografinë e letrarizuar “Jetë pa hije” për figurën e një ish-ushtaraku dhe ish-partizani të luftës, nga Kolonja e Labërisë, oficerin Hasim Çeli. Në 2013, publikon librin poetik, me njëqind poezi, “Nën diellin e Karaibeve”; në 2017, librin “Ftesë nga Fushëbardha”, një përmbledhje e gjerë me tematikë e frymë nga treva e Labërisë, pjesa e parë e të cilit përfshinë gjashtëdhjetë poezi, pjesa e dytë, njëmbëdhjetë tregime dhe pjesa e tretë, publicistikë, ese e tregime të jetuara. Aktualisht edhe pse që nga viti 2008 Zeqiri jeton në Toronto të Kanadasë ka në proces botimi, “Kronikë në aerodrom” me tregime nga jeta në bazat ajrore si dhe dy libra, një me poezi “Eshhtë koha të heshtë” dhe një me tregime, “Enigma Suri”. Zeqir Cama vlerësohet poet e tregimtar i besueshëm, i mbështetur në tabanin popullor, me shkrime të spikatura; me

poezi dhe shkrime biografike, por dhe një tregimtar i thekur, një personazh i dashur i letrave, me prurje të pashtrurra e të maturuara, një gurgullimë e pastër labe, me prurje plot larmitet dhe kolorit. Edhe pse përtej oqeanit, zemrën e ka lënë në Fushëbardhë e Labëri, atje ku është ruan gjuhën e bukur tradicionale, theksin e ëmbëlsuar të labërishtes, traditat dhe zakonet, gjithçka të mirë të trevës labe me histori trimash. Ai lexohet për freskinë dhe vërtetësinë, për muzën poetike, frymëzimin. Zemra e poetit është tek “vallja e shkronjave”, “Shkallët e Labërisë”, “Deputetja labe” e dhjetra të tjera. Zeqiri ka krijuar “ngrehinën” e vet poetike, përkushtimin ndaj mozaikut të Labërisë, krijimtarinë plot fantazi, figura magjepsëse. Ai ka qenë serioz në udhëtimin poetik, i veshur me veti njerëzore e artistike, mësues për mënyrën e të shkruarit, këshillues e redaktor, krijues plot freski, gjallëri e vërtetësi. Përkufizimi i Kadarese për poetin e Zeqir Cama si konte-poran në poezi dhe publicistikë nuk duan koment. Poeti Agim Shehu jep esencën e krijimtarisë poetike të Zeqo Camës: “Një antologji ndjenjash që të mbeten në mendje dhe bëhen pasuri kujtuese, një pasuri e veçantë poetike. Një thjeshtësi e çiltërsi tërë bukuri figurash thënë lirshëm si frymëmarrje shpirti..”. Publicistët Sefedin Çela, Luan Malaj e Beqir Skreli për Zeqir Camën: “..detajet fine të gdhëndura si me dorë, mjediset reale e të preksme, të vizatuar me një mozaik ngjyrash e kombinacionesh..”. Agim Golemi shkruan: “Ti qendis me penë pasazhe të veçantë, shpirtin dhe dashurinë e thellë njerëzore, me një gjuhë tërheqëse e të lexueshme për këdo”. Zeqiri është adhures i truallit që lanë trashëgim të parët: “Borërat një mbi një kanë ngrirë në emrin tënd,/jelekbardha jetëgjatë, eshtëzëna argjend,..”, poezi e gdhëndur në gazetën “Fushëbardha” dhe në fakt këto gërma kanë ngrirë pikërisht në titullin e gazetës.

Pjesë e poetëve me kontribut në kulturën kombëtare shqiptare

Zeqir Cama i është ngjitur “malit” të poezisë si alpinist i rregjur dhe i paepur, duke lëshuar hijen e tij në këtë “mal”, në kulturën e letrave shqipe, prandaj edhe meriton të lexohet e përhapet për vlerat që zotëron. Zeqiri ka mbushur një “thes” me poezi dhe prozë të lezuëshme dhe të adhureshme në çdo kohë, prandaj kur shkruan poezi për Kadarenë: “Kadarese”, që gjen “midis shenjtorëve të artit,/një gur i çmuar, në kalldrëm”, “Nën diellin e Karaibeve”, “E sotmja”, “Katarakti i Niagarës”, vërtetojnë plotësisht se poeti original dhe aristokrat i fjalës e ka gjetur korsinë e duhur poetike.

Por në këtë krijimtari për Labërinë dhe Fushëbardhën poeti ka vendin e nderit, prandaj edhe e meriton vlerësimin më të lartë të Labërisë “Personalitet i shquar i Labërisë”. Poeti Zeqir Cama është penë e njohur në poezinë shqipe që ecën i sigurtë në gjurmët e maleve të poezisë shqipe: Naim Frashëri, Dritëro Agolli, Andon Zako Çajupi, Ali Asllani, Gjergj Fishta, Asdreni, Migjeni, Ismail Kadare, Lasgush Poradeci, Jorgo Bllaci, Fatos Arapi, Agim Shehu, Moikom Zeqo, Petrit Ruka, etj, por është në një llogore me poetë që i bëjnë nder vendit si: Sulejman Mato, Ndoc Gjetja, Ymer Nurka, Agim Hila, Sinan Kërpaçi, Nexhip Onjea, etj. Që të gjithë janë male poezie, që guides sëhartsë shqiptare i duhen shtuar edhe njëzet e ca male të tjerë. Motivi i poetit nuk ka qenë kurrë vlerësimi, por dy shoqata në cilësinë si organizma shoqërorë kolegiale vendosën njëzëri që zotit Zeqir Sadik Cama, t’i jepet titulli “Personalitet i shquar i Labërisë”: “Për kontribut të shquar në fushën e letrave shqipe, një individualitet krijues me karrierë të spikatur; si publicist, poet e prozator i pëlqyer, tematika dhe tiparet e kësaj krijimtarie (siç ka vënë në dukje dhe kritika letrare), kryesisht burojnë nga treva e Labërisë, ku ka mbetur “peng” zemra e tij; si ish-kryeredaktor i Gazetës “Fushëbardha”; si një ndër ruajtësit dhe mbrojtësit e vlerave labe në Tiranë, por dhe në emigracion në Kanada, ku krijimtaria e tij fitoi një dimension dhe frymëmarrje më të gjërë, por edhe si një individualitet aktiv në një periudhë të gjatë në shoqatën Atdhetare Kulturorë “Labëria”, “Nderi i Kombit”. Viti 1972, nis me botimin e vëllimit poetik “Shtigje të gurta”. Nga ky libër të poetit të njohur jo vetëm të Fushëbardhës por mjaft i njohur në Labëri e në shkallë vendi kemi sjellë vargjet e Zeqir Camës për figurën labe të Xhaxho Nekiut të Fushëbardhës, që janë një monument i spikatur për njerëzit e thjeshtë e punëtor në poezinë “Motiv baritor”: “Me një krrabë të dredhur mirë,/Me një krrabë piksi të dredhur thane,/Nisesh pas dhenëve pa gdhirë,/Festebardhi me llabane,(gjysëm gunë),/Shkove kohë e theve vite,/Nëpër gërxhe, nëpër pllaja,/Nga stani në stan u ngjite,/Me llaja çoban me llaja,/Ndërrove mal, e ndërrove bar,/Ndërrove vendet e nomeve./Por prapë me feste të bardhë,/Mbetë çoban i kopeve,/Kapedan që s’plakesh kurrë,/Zdreng-zdreng dhenëve mbrapa,/Pas tyre u bëre burrë,/Me poture të shajakta”. Vargje që janë marrë sipas origjinalit nga libri “Shtigje të gurta”, autorit Zeqir Cama, publikuar para gjysëm shekulli më 1972. Ndërkohë që krijimtaria poetike e Zeqir Camës ka fituar individualitetin e tij dhe ishte bërë e njohur dhe e konfirmuar edhe në qarqet e larta të poetëve dhe të shkrimtarëve.

**Vlerësime për poetin,
që figuracionin magjepsës
e përzgjedh nga Labëria**


Si në çdo shkollë e punë Zeqiri është serioz në udhën e dijeve, në udhën e jetës, me dëshirë dhe vullnet përmbush detyrimet familjare e shoqërore, është nder ta kesh shok e mik dhe gjithmonë ke çfarë mëson nga i mësuari dhe i dituri. Ndoshta janë edhe veti njerëzore që është armatosur që i ringa prejardhja labe. Në fushën e artit të të shkruarit tashmë është mësues, këshillues e redaktor i spikatur dhe kushdo bashkëpunon me poetin lab një gjë është e sigurtë se do të rritë dukshëm vlerat shkrimeve dhe publikimeve dhe do ta mbushë veprën me freski, gjallëri dhe vërtetësi. I tillë është gatuar si për poezi, tregime dhe publicistikë. Kush lexon “Peisazh mbrëmje nga Fushëbardha” dhe nuk i ngelet mendja aty për ëmbëlsinë dhe bukurinë e vargut, për stanet e blegërimat, galeri minierash, livadhe, kodra e pyje, barinj, kope delesh e dhish, zogj, burime uji, frymëzuar nga e ëmbëla dhe e sërta, Fushëbardhë: “Nëpër plepa pikon hëna,/Sërë sërë si hoje mjalti,/llamburit e ndizet mbrëmja,/sikur nata nis së prapthi..”. Vështrimi i poetit shkon mbi Fushëbardhë, Zhulat e gjithë Labërinë por dy të parat janë të “një zjarri e një vatre”. Poeti i njohur Agim Shehu jep esencën e krijimtarisë poetike të Zeqo Camës: “Një antologji ndjenjash që të mbeten në mendje dhe bëhen pasuri kujtese. Një pasuri e veçantë poetike. Një thjeshtësi e çiltër tërë bukuri figurash thënë lirshëm si frymëmarrje shpirti..”. Publicistët Sefedin Çela, Luan Malaj e Beqir Skreli pëlqejnë përshkrimet nga vendlindja, “...detajet fine të gdhëndura si me dorë, mjediset reale e të prekshme, të vizatuara me një mozaik ngjyrash e kombinacionesh..”. Poeti fushëbardhas Agim Golemi shkruan: “Ti qendis me penë pasazhe të veçantë, shpirtin dhe dashurinë e thellë të gjysheve.. Duke portretizuar gjyshen tende ti ke tipizuar të gjitha gjyshet, me një gjuhë tërheqëse dhe të lexueshme për këdo,..nuk ke lënë mënjantë pa përshkruar bukur edhe ambientin rrethues..”.

**“Personalitet i Labërisë”
- vlerësim i lartë për poetin
e Fushëbardhës dhe Labërisë**

Poeti i Fushëbardhës parapëlqen të jetë origjinal në krijimtari. Poezia e tij vjen erë trëndelinë dhe lule akthi, bardhësia e qengjave, deleve e shelegëve ka “lyer” jo vetëm diellin që lind në Fushëbardhë, por dhe në blegërima,

fëshfërimet gjethesh, cicërima zogjsh, këmborë e zile, fyejsh e longarë. Poeti nuk ka perëndi dhe nuk respekton kllishe, sepse është rritur e mëkuar në një trevë rrebele, të pabindur dhe që ka qenë gjithmonë e lirë, në pavarësinë e saj relative. Ai është më shumë se vetvetja, ku edhe kur i meriton të gjitha nderimet i quan të tepërta ato, sepse i flet zemra e shpirti, i çlirët dhe i dliër, shpirt që rron edhe në virtualitet në livadhet e kodrinat e gjelbëra të Fushëbardhës, në gurgullimat e burimeve të Labërisë dhe që nuk shterrin kurrë dhe nuk kanë limite e kufizime. Vargëzimi poetik i Zeqir Camës dhe krijimtaria në skica e tregime, është një gurgullimë e pandalur labe, që e ka meritur plotësisht që të rrjedhë e tillë si gurgullima e kristalë dhe e dëbortë e burimeve të Labërisë. Por poeti ynë është edhe “xanxar”, edhe pse ka qenë ish-ushtarak, bile madhor ish-nënkolonel, “nuk vihet dot në rresht”. I kërkuam të

Kazo, T. Golemi, A. Cama, T. Resuli, ju drejtuan Shoqatës “Labëria” “Nderi i Kombit”, organit më të lartë autoritar që e akordon titullin. Poeti Zeqir Cama na shkruante: “..ju falenderoj për kujtesën dhe vlerësimin. Kur ishim të rinj dhe merrnim ato dekoratat e asokohe (3 nga Presidiumi i KP), nuk i vlerësonim siç duhet sepse na dukej sikur mburreshim, ruanim modestinë e shtirur. Por modestia e tepëruar thonë që është budallallëk, aq më tepër sot. Megjithatë njeriu s’flet dhe s’kërkon dot për vete. Kështu ka qenë dhe kështu do ngelet.Motivi i tij nuk ka qenë kurrë vlerësimi, por dy shoqata në cilësinë si organizma shoqërore kolegjiale vendosën njëzëri që zotit Zeqir Cama, t’i jepet titulli “Personalitet i shquar i Labërisë”: “Për kontribut të shquar në fushën e letrave shqipe, një individualitet krijues me karrierë të spikatur; si publicist, poet e prozator



na bënte një foto me kostum, standard, xhakëtë e zezë, këmishë të bardhë dhe kullaro të kuqe, për kombinim me ngjyrat e flamurit. Po nuk vonoi përgjigjia: “E kam bezdi të ve kullaro sepse tani jemi bere si plaku Mere...!, jemi bërë si të kenër”, dhe më tej në thotë: “...qenka me shume ickëla protokollare kjo punë e “personalitetit” o vëllezër, me biografi e fotografi me kullaro, me veshjet protokollare e simbolikë ngjyrash të flamurit tonë kombëtar. Pashë mos gjeja ndonjë me kullaro por s’gjeta, kam vetëm një me xhakëtë e bluzë sportive, mbase s’u prish gjë, sepse juve në Shqipëri dhe kryeministrin që u votua përsëri për mandatin e tretë e kini sportiv, madje dhe në takime zyrtare”. Ju bindëm e lamë poetin rebel, të vishej si të donte, dhe që në fakt kishte marrë nga huqet e Agim Shehut e Petro Markos, që nuk e njihnin “rreshtin”. Për vlerësimin propozues të SHKA “Fushëbardha”, kryesia e së cilës e përbërë nga: P.Bello, N. Onjea, Z. Golemi, A.

i pëlqyer, tematika dhe tiparet e kësaj krijimtarie (siç ka vënë në dukje dhe kritika letrare), kryesisht burojnë nga treva e Labërisë, ku ka mbetur “peng” zemra e tij; si ish-kryeredaktor i Gazetës “Fushëbardha”; si një ndër ruajtësit dhe mbrojtësit e vlerave labe në Tiranë, por dhe në emigracion në Kanada, ku krijimtaria e tij fitoi një dimension dhe frymëmarrje më të gjërë, por edhe si një individualitet aktiv në një periudhë të gjatë në shoqatën Atdhetare Kulturore “Labëria”, “Nderi i Kombit”. Për ta finalizuar këtë vlerësim më datën 14 shtator 2021 edhe me pjesëmarrjen e Sekretarit Organizativ të SHKA “Labëria” Bashkim Qeli, Kryetarit të Degës së Tiranës Prof. Assoc. Dr. Bernard Zotaj, kryesisht së SHKA “Fushëbardha” si dhe shkrimtarë e poetë miq e të ftuar u bë dorëzimi i titullit të nderit. Ushtaraku dhe poeti lab Zeqir Cama falënderoi me mese poetike uniteti dhe origjinaliteti.

Njeriu tre-dimensional

Si ka qenë për ju të rriteni dhe të ngjisni shkallët e karrierës në një nga frontet më të vështira të shoqërisë shqiptare?

Karrierën ushtarake e kam filluar që në vitin 1975, kur nisa studimet në Shkollën e Bashkuar. Ishte një nisje e re për mua. Studiova dhe mësova me dëshirë, duke dalë një nga studentët e dalluar të kohës. Puna dhe studimi kanë qenë dy bashkudhëtarët e mi në jetën ushtarake. Ishte tepër e vështirë në atë kohë të ngjisje shkallët e karrierës ushtarake, por unë ia dola vetëm me punë këmbëngulëse dhe me disiplinë.

Cili është definicioni juaj dhe sa ndikues kanë qenë në formimin dhe zhvillimin social ndër breza?

Unë u formova si profesionist në dy sisteme politike diametralisht të ndryshëm nga njëri-tjetri. Punova shumë me organizatën e rinisë, e cila më dha një formim dhe edukim të gjithanshëm. Ndërsa në sistemin e demokracisë u mora shumë me studime historike dhe ushtarake. Kam studiuar në biblioteka dhe në arkiva për mjaft probleme të historisë ushtarake dhe të luftës.

Duke punuar me rininë për shumë vite njoha nga afër “skënderbegasit”, studentët ushtarakë të cilët kanë punuar fort dhe u bënë bërthama e ushtrisë shqiptare dhe shtresa më vitale e shoqërisë sonë. Nga shkollat ushtarake kanë dalë njerëz elitare që janë edhe krenari e arsimit ushtarak, kanë dalë komandues të denjë, ku si nga “skënderbegasit” dhe studentët ushtarakë ndër vite kanë arritur të bëhen, ministra, deputetët, presidentë, shkencëtarë, profesorë, artistë dhe sportistë edhe të arenës ndërkombëtare.

Sa vlerësuese kanë qenë sistemet



politike në Shqipëri për këtë elitë të shoqërisë, me vlera dhe kontribute të veçanta?

Duke punuar 15 vite në sistemin monist dhe 30 vite në sistemin e demokracisë, pata një përvojë të dendur pune, pasi mu dha mundësia të punoj në shkollat ushtarake të Shqipërisë për shumë vite. Kontributi im ka qenë në fushën e historisë ushtarake, të mbrojtjes dhe të sigurisë, por jam marrë dhe me publicistikë. Duke e parë nga lartësia e viteve në rrafshin tre-dimensional në karrierën ushtarake kam lënë gjurmë si historian, si shkrimtar dhe bashkautor veprash letrare dhe të historisë ushtarake.

Sa sfiduese kanë qenë për njëra-tjetrën?

Kam botuar mjaft monografi që i bëjnë jehonë ngjarjeve historike të Lumit të Vlorës, por dhe të trevave të tjera të vendit, të tilla si “Oxhaku i Zote në

Smokthinë”, “Konaku i Habil Laçes në Tragjas”, “Njeriu i bukur”, “Yjet e Ramicës”, “Antifashisti në xhandarmëri”, “Epopeja e fitimtarëve”, si dhe studimin monografik për historinë “Zona e Parë Operative Vlorë-Gjirokastër-Mallakastër 1943-1944”, “Figurat kryesore të Luftës së Dytë Botërore” etj. Çdo libër dhe monografi ka pasur prurje të reja dhe është mirëpritur nga lexuesi. Me bashkautorësi kemi bërë dhe Historinë e Shqipërisë, për klasat 9 dhe 12, të miratuara nga Ministria e Arsimit. Të gjitha librat dhe monografitë e botuara gjenden në Bibliotekën Kombëtare, si dhe në disa biblioteka lokale dhe familjare.

Nga buron muza juaj krijuese dhe cili është personazhi historik që ju ka frymëzuar në veprat tuaja?

Skënderbeu është figura legjendare e historisë të popullit shqiptar, të cilin e kam studiuar dhe kam shkruar shpesh

për të në shtypin ushtarak. Skënderbeun e kam trajtuar nga pikëpamja studimore duke nxjerrë cilësitë e tij prej ushtaraku të formuar, të një drejtuesi dhe udhëheqësi, por dhe të dimensionit të një strategu me famë europiane.

Më ka tërhequr shumë dhe Klauzeviçi, i cili ka shkruar shumë për luftën dhe ka dhënë mjaft leksione të vlefshme të cilat kur i studion dhe mëson, arrin të kuptosh thelbin e luftës, por dhe të historisë ushtarake.

Cili është ndryshimi midis artit ushtarak të Skënderbeut dhe atij të strategëve ushtarakë në ditët tona?

Arti ushtarak i Skënderbeut është një përvojë mjaft shekullore dhe luftërat e popullit tonë patën për bazë këtë përvojë të madhe. Skënderbeu jetoi dhe luftoi në luftëra, pothuajse çdo vit do të kishte beteja të cilat më shkathtësinë dhe zgjuarsinë e me formimin e tij ushtarak i fitoi të gjitha. Ndryshimi për strategët sot, është se ka evoluar shumë mendimi ushtarak dhe është përsosur shumë armatimi dhe teknika luftarake. Strategët ushtarakë sot nuk i marrin menjëherë benefitet, ka ndryshuar shumë njeriu, arma dhe terreni.

Nga pikëpamja profesionale, komandantët e ushtrisë sot janë strategë?

Është një përgjigje e vështirë. Komandantët e ushtrisë janë tepër të përgatitur nga ana profesionale, por nuk mund të jenë strategë, pasi luftën e fillon dhe e përfundon politika. Që të arrijnë formatin e strategut, komandantët duhet të shquhen edhe në fushën e mendimit ushtarak, por dhe të përsosjes së armatimit bashkëkohor.

A është ky një kusht për të pasur një ushtri të fortë?

Si studiues dhe bashkautor i tekstit të historisë së Shqipërisë dhe si njohës i thellë i përpjekjeve të popullit shqiptar për liri dhe pavarësi, unë mendoj që komandantët ushtarakë të rangjeve të larta, duhet të jenë në radhë të parë ushtarë, të njohin në përsosmëri armatimin dhe teknikën, terrenin si dhe forcën që do të drejtojnë.

Cilat janë vlerat e LANÇ-it dhe a janë nderuar pjesëtarët e kësaj lëvizjeje?

LANÇ-i është vlera më e madhe kombëtare në historinë e popullit shqiptar. Në

këtë luftë Shqipëria u rreshtua në krahun e duhur, por dhe organizoi një masivizim të madh të popullsisë për luftë. Ende nuk janë nderuar dhe vlerësuar pjesëtarët e kësaj lëvizjeje të madhe kombëtare. Shumë komandantë dhe komisarë të kësaj lufte dhe sot kanë ngelur të pavlerësuar për tërë ato sakrifica dhe privime që krijoi kjo luftë. Shoqëria shqiptare, por dhe Ministria e Mbrojtjes duhet të jenë promotorët e vlerësimit të luftëtarëve. Jemi ende shumë prapa në këtë drejtim...

Cili ishte roli i intelektualëve dhe patriotëve brenda vendit?

Lufta u organizua dhe u zhvillua nga intelektualë që kishin studiuar në Lindje dhe në Perëndim. U aktivizuan shumë dhe patriotë të mëdhenj e figura kombëtare, të cilët nga reputacioni dhe patriotizmi i treguar, masa e popullit i vlerësoi dhe ndoqi rrugën e tyre të lirisë. Kështu LANÇ-i për mua kishte dy shtylla kryesore, intelektualët dhe patriotët që u vunë në krye të kësaj lëvizjeje. Pati intelektualë dhe patriotë që u bënë antifashistë si frymë e kohës, por dhe komunistë të cilët në atë kohë ishin për luftë të vendosur kundër fashizmit.

Kush ishte roli i rretheve patriotike shqiptare jashtë vendit?

Në çdo kohë rrethet patriotike shqiptare kanë luajtur një rol të madh në zgjimin e ndërgjegjes kombëtare shqiptare. Kështu kujtojmë periudhën e Rilindjes Kombëtare, periudhën e Pavarësisë, gjatë Luftës së Parë Botërore, të Luftës së Vlorës, të Dibrës dhe të Koplikut të vitit 1920, por dhe në kohën e regjimit të Zogut. Vatra të zjarra u bënë shqiptarët në Bukuresht, në Sofje, në Stamboll, në Selanik, në Austri, deri në SHBA.

A ka një ligj të mirëfilltë për të ruajtur vlerat dhe figurat historike pavarësisht ndryshimeve politike?

Nuk ka ligje për të ruajtur figurat historike, doli një ligj në kohën e pluralizmit në vitet 1991-1992, por u shua shpejt. Ndërsa për dëshmorët të cilët ranë në luftë, dhe jo pak, por mbi 28 mijë, bijtë dhe bijat më të mirë të atdheut, pjesa më e ndritur e historisë të popullit tonë. Ngjyrimet politike e kanë zbehur shkëlqimin e tyre dhe njëkohësisht luftojnë ta deformatojnë. Ka një ligj për statusin e dëshmorit, dhe bëhen përpjekje për të lartësuar vlerat e tyre nga Organizata e Dëshmorëve dhe Organizata e Veteranëve.

Po tek ne ndodhet një pavijon i tillë, i cili sjell në vëmendjen e brezave historinë e të parëve të tyre pa deformime politike?

Janë bërë dhe bëhen përpjekje për historinë e LANÇ-it. Shumë objekte dhe materiale të tjera janë dëmtuar në muzetë historikë në Tiranë, por dhe në qarqet kryesore të vendit. Në Luftën e Dytë Botërore edhe në Shqipëri pati fitues dhe humbës. Tani humbësit janë kthyer në fitimtarë dhe luftojnë të ndryshojnë historinë. Ndërsa për historinë e sistemit socialist ende nuk po bëhet për t'u ruajtur sa e si duhet...

A mbetet ajo, pjesë e historisë së marshimit njerëzor?

Historianët, edhe historianët ushtarakë kanë një meritë të madhe në përjetësimin e vlerave dhe heroizmave të popullit. Ata janë pjesë e armatës, duhet të hedhim më shumë dritë mbi të vërtetat e patjetërsueshme të së kaluarës sonë dhe të ndihmojnë brezat e rinj të ndërtojnë të ardhmen e tyre në mesazhe frymëzuese që vijnë nga historia.

Hulumtimet dhe studimet tuaja kanë ndriçuar epopenë e Luftës së Vlorës të vitit 1920. Nëse do veçonit 1 datë, 1 ngjarje dhe 1 personazh si do ta vendosnit atë në panteonin e madh të vlerave historike?

Kam shkruar së bashku me Prof. Shahun Lekën monografinë "Arti ushtarak në Luftën e Vlorës të vitit 1920" dhe në kuadrin e 100-vjetorit të Luftës së Vlorës shkrova dhe botova librin "Epopeja e Fitimtarëve". Për kontributin e dhënë në studimet ushtarake Presidenti i Republikës më ka dhënë titullin "Mjeshtër i Madh".

Si datë do të veçoj 5 qershorin 1920, kur nisi Lufta e Vlorës, ishte një datë që mund të ishte ditë kombëtare përkujtimore, pasi me një sulm të rrufeshëm në të njëjtën kohë u morën 5 garnizone italiane brenda ditës.

Si ngjarje veçoj 15 gushtin 1943, kur krijohet Brigada I Sulmuese, formacion i madh ushtarak. Ndërsa si personazh do të veçoj Isa Boletinin, një udhëheqës popullor dhe strateg ushtarak.

Në përpjekje për të marrë sa më shumë informacion për lexuesin mbi një enciklopedi historike të pakompromis me të vërtetat e saj, ju falënderoj!

*Intervistoi:
Anjeza MUSOLLARI*

STËRVITJA "MNELA 21" / BATALIONI I KËMBËSORISË (BIK)

Ministri Peleshi: Ushtria jonë e denjë ta përfaqësojë vendin në misione ndërkombëtare

